Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M2-2019

**MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 21, DATË 1.4.2020 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË.*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

PARATHËNIE		*7*
SHËNIME		*8*
DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2019		*10*
1.	*VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR*	*18*
1.1	*Harta e stabilitetit financiar*	*18*
2.	*ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE SEKTORIALE*	*21*
2.1	*Mjedisi makroekonomik i jashtëm*	*21*
2.2	*Mjedisi makroekonomik në vend*	*24*
2.3	*Zhvillimet në sektorë të veçantë të ekonomisë*	*25*
3.	*TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE*	*35*
3.1	*Tregjet*	*35*
3.2	*Sistemet e pagesave*	*42*
4.	*SISTEMI FINANCIAR*	*44*
4.1	*Sektori bankar*	*45*
4.2	*Sektori jobankar*	*88*
5.	*POLITIKAT MAKROPRUDENCIALE DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE*	*93*
5.1	*Vlerësimi i rreziqeve dhe masat makroprudenciale në vendet e BE-së dhe rajon*	*93*
5.2	*Vlerësimi i rreziqeve dhe masat makroprudenciale në Shqipëri*	*95*
SHTOJCË. TREGUESIT KRYESORË TË SHËNDETIT FINANCIAR		*102*

HAPËSIRAINFORMUESE

Hapësirë informuese 1.	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve*	*27*
Hapësirë informuese 2.	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve*	*31*
Hapësirë informuese 3.	*Ecuria e numrit të aplikimeve për kredi dhe analiza e normës së refuzimit nga bankat në vend, gjatë 6MII-2019*	*32*
Hapësirë informuese 4.	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për 6M II-2019*	*41*
Hapësirë informuese 5.	*Aktiviteti i bankave në lekë dhe valutë*	*52*
Hapësirë informuese 6.	*Struktura dhe eficienca e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë*	*58*
Hapësirë informuese 7.	*Sektori bankar dhe kredia e pambrojtur në valutë*	*63*
Hapësirë informuese 8.	*Tregues të përqendrimit për sektorin bankar*	*80*

PËRMBAJTJAETABELAVE

2.	*Zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale*	
Tabelë 1.	*Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare*	*23*
Tabelë 2.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor*	*23*
Tabelë 3.	*Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar*	*26*
Tabelë 4.	*Pesha e ndërmarrjeve me vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali sipas sektorëve*	*29*
4	*Sistemi financiar*	
Tabelë 5.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite*	*44*
Tabelë 6.	*Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, dhjetor 2019*	*45*
Tabelë 7.	*Të ardhurat dhe shpenzimet kryesore të sektorit bankar sipas valutave për vitet 2018-2019*	*52*
Tabelë 8.	*Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*54*
Tabelë 9.	*Ecuria e kredisë për bizneset dhe treguesit ekonomikë sipas sektorëve të prodhimit*	*60*
Tabelë 10.	*Të dhëna mbi ecurinë e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*66*
Tabelë 11.	*Tregues të përqendrimit dhe lidhjes midis madhësisë së bankave dhe fitimit*	*81*
5.	*Politikat makroprudenciale dhe vlerësimi i rreziqeve*	
Tabela 12.	*Objektivat e ndërmjetëm dhe disa prej treguesve kryesorë*	*96*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1.	*Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve kryesore të stabilitetit financiar*	
Grafik 1.	*Harta e stabilitetit financiar*	*19*
Grafik 2.	*Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik*	*20*
Grafik 3.	*Indeksi i Stresit Financiar*	*20*
Grafik 4.	*Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike në vend*	*20*
2.	*Zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale*	
Grafik 5.	*Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve*	*22*
Grafik 6.	*Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera*	*22*
Grafik 7.	*Pozicioni financiar sektorial (miliardë lekë)*	*26*
Grafik 8.	*Ecuria e huamarrjes së familjeve (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)*	*28*
Grafik 9.	*Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse (2010=100)*	*28*
Grafik 10.	*Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm*	*29*
Grafik 11.	*Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm*	*29*
Grafik 12.	*Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave*	*30*
Grafik 13.	*Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës*	*30*
Grafik 14.	*Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të kredimarrjes në 6 muajt e ardhshëm*	*30*
Grafik 15.	*Indeksi i planifikimit të kredimarrjes bankare në 6 muajt e ardhshëm*	*30*
Grafik 16.	*Ecuria e numrit të aplikimeve të shqyrtuara dhe norma e refuzimit të kredive*	*33*
Grafik 17.	*Norma e refuzimit të kredive*	*33*
3	*Tregjet dhe sistemet e pagesave*	
Grafik 18.	*Ecuria e normës mesatare të interesit të letrave me vlerë të borxhit, në %*	*35*
Grafik 19.	*Përbërja e borxhit të brendshëm të emetuar gjatë periudhës 2015-2019*	*35*
Grafik 20.	*Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar*	*36*
Grafik 21.	*Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6MII-2019*	*36*
Grafik 22.	*Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar*	*36*
Grafik 23.	*Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6MII-2019*	*36*
Grafik 24.	*Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar*	*37*
Grafik 25.	*Numri i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar*	*37*
Grafik 26.	*Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar sipas titujve të tregtueshëm*	*38*
Grafik 27.	*Nivelet e yield-it (YTM) në datën 31.12.2019*	*38*
Grafik 28.	*Normat e interesit në tregun ndërbankar*	*39*
Grafik 29.	*Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor*	*39*
Grafik 30.	*Ecuria e Indeksit Fischer të Çmimit të Banesave në rang vendi dhe për Tiranën*	*40*
Grafik 31.	*Cilësia e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme*	*40*
Grafik 32.	*Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH gjatë vitit 2019*	*43*
Grafik 33.	*Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë (6M II 2014-2019)*	*43*
4	*Sistemi financiar*	
Grafik 34.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2019*	*44*
Grafik 35.	*Efekti i kursit të këmbimit në ecurinë e zërave kryesorë të aktivit (majtas) dhe pasivit (djathtas), kundërvlera në lekë*	*46*
Grafik 36.	*Struktura e detyrimeve jorezidente*	*46*
Grafik 37.	*Pozicioni neto me jorezidentët*	*46*
Grafik 38.	*Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*47*
Grafik 39.	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit*	*47*
Grafik 40.	*Kontributi i zërave të mjaftueshmërisë së kapitalit (në pp)*	*48*
Grafik 41.	*Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit sipas instrumenteve përbërëse (në pp)*	*48*
Grafik 42.	*Shpërndarja e aktiveve të sektorit bankar sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*49*
Grafik 43.	*Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, dhjetor 2019*	*49*
Grafik 44.	*Ecuria e levës financiare sipas përbërësve*	*49*
Grafik 45.	*Shpërndarja e levës financiare në nivel banke*	*49*
Grafik 46.	*Përbërësit e rezultatit financiar*	*50*
Grafik 47.	*ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit*	*50*
Grafik 48.	*Marzhi neto nga interesi*	*51*
Grafik 49.	*Treguesit e përfitueshmërisë*	*51*
Grafik 50.	*Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë*	*52*
Grafik 51.	*Shpërndarja e bankave sipas raportit shpenzime/të ardhura (% ndaj totalit të aktiveve)*	*52*
Grafik 52.	*Struktura e të ardhurave në lekë dhe valutë sipas zërave kryesorë (viti 2019)*	*53*
Grafik 53.	*Të ardhurat dhe shpenzimet totale dhe për interesat sipas valutave (viti 2019)*	*54*

Grafik 54.	*Ndryshimi 6-mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse*	*55*
Grafik 55.	*Ecuria e kredisë sipas sektorëve, kontribut në pp, ndryshime gjashtëmujore*	*55*
Grafik 56.	*Ecuria e kredisë totale pa efektin e kursit dhe fshirjeve (majtas) dhe e kredisë në valutë pa efektin e kursit (djathtas), ndryshime vjetore, në %*	*55*
Grafik 57.	*Ecuria e kredisë për bizneset rezidente*	*56*
Grafik 58.	*Ecuria vjetore e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës, (në %)*	*57*
Grafik 59.	*Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë*	*57*
Grafik 60.	*Ecuria vjetore e kredisë për bizneset vendase*	*58*
Grafik 61.	*Kredia për bizneset vendase 2002-2019*	*58*
Grafik 62.	*Ecuria e kredisë për individët rezidentë sipas qëllimit të përdorimit*	*61*
Grafik 63.	*Kredia për rezidentët dhe jorezidentët (majtas) dhe kredia për jorezidentët sipas afatit (djathtas)*	*62*
Grafik 64.	*Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë*	*63*
Grafik 65.	*Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas qëllimit të përdorimit, në %*	*63*
Grafik 66.	*Ecuria gjashtëmujore e kredisë së pambrojtur në valutë (kontributi sipas sektorëve)*	*64*
Grafik 67.	*Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj*	*64*
Grafik 68.	*Kredia e re për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit*	*65*
Grafik 69.	*Ecuria e normës së peshuar të interesit për kreditë e reja*	*65*
Grafik 70.	*Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas monedhës*	*66*
Grafik 71.	*Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas subjektit*	*66*
Grafik 72.	*Ecuria e depozitave sipas afatit (në mld lekë, majtas) dhe kontributi në ndryshimin vjetor (në pp, djathtas)*	*67*
Grafik 73.	*Depozita në lekë dhe valutë*	*67*
Grafik 74.	*Ndryshimi vjetor i kursit të këmbimit dhe i depozitave në lekë, në Euro dhe në valuta të tjera*	*67*
Grafik 75.	*Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës*	*68*
Grafik 76.	*Përbërja e rritjes së depozitave sipas afatit, sektorëve dhe valutës*	*68*
Grafik 77.	*Flukset dhe norma mesatare e interesit për depozitat e reja me afat në lekë*	*69*
Grafik 78.	*Flukset dhe norma mesatare e interesit për depozitat e reja me afat në Euro*	*69*
Grafik 79.	*Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione*	*70*
Grafik 80.	*Kontributi në ndryshimin vjetor të stokut të kredive me probleme*	*70*
Grafik 81.	*Struktura e kredive me probleme*	*70*
Grafik 82.	*Raporti i kredive me probleme sipas sektorit, monedhës dhe afatit*	*71*
Grafik 83.	*RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas monedhave*	*71*
Grafik 84.	*RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit*	*71*
Grafik 85.	*Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit*	*72*
Grafik 86.	*Ndryshimi vjetor i stokut të kredive me probleme dhe RKP për subjektet jorezidente*	*72*
Grafik 87.	*Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme, sipas llojit të kolateralit*	*73*
Grafik 88.	*Tregues të likuiditetit*	*74*
Grafik 89.	*Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*	*74*
Grafik 90.	*Maturimi mesatar i mbetur*	*75*
Grafik 91.	*Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin dhe grupet*	*76*
Grafik 92.	*Ecuria e komponentëve të indeksit për sektorin bankar*	*76*
Grafik 93.	*Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore sipas monedhave*	*76*
Grafik 94.	*Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave*	*77*
Grafik 95.	*Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare*	*77*
Grafik 96.	*Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %*	*78*
Grafik 97.	*Ecuria sipas grupeve e pozicionit neto të peshuar ndaj kapitalit rregullator, në %*	*78*
Grafik 98.	*Hendeku sipas grupeve dhe monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %*	*79*
Grafik 99.	*Pozicioni neto i peshuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %*	*79*
Grafik 100.	*Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave me afat dhe spread-i i normave të interesit, në %*	*80*
Grafik 101.	*Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në pp*	*80*
Grafik 102.	*Treguesi i përqendrimit (HHI) për aktivitetet kryesore të sektorit bankar*	*80*
Grafik 103.	*Lidhja midis madhësisë së bankave (aktivi i bankës/aktivet e sektorit, %) dhe të ardhurave neto nga interesat (të ardhura neto nga interesat për bankën/të ardhurat neto nga interesat për sektorin, %)*	*81*
Grafik 104.	*Ekspozimet e mëdha dhe ato ndërbankare, 2019*	*84*
Grafik 105.	*Analiza e makro-rrjetit të ekspozimeve dhe procesi i gjurmimit të goditjeve/dështimit*	*85*
Grafik 106.	*Analiza e përcjelljes së rrezikut (efekti 'kaskadë')*	*86*
Grafik 107.	*Struktura e IFJB-ve sipas llojit të aktivitetit që kryejnë, dhjetor 2019*	*89*
Grafik 108.	*Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, dhjetor 2019*	*89*
Grafik 109.	*Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit*	*90*
Grafik 110.	*Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, dhjetor 2019*	*90*
Grafik 111.	*Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve, dhjetor 2019*	*91*
Grafik 112.	*Pesha në treg e fondeve të investimeve sipas vlerës neto të aktiveve, dhjetor 2019*	*91*
Grafik 113.	*Investimet e sektorit jobankar në banka dhe letrat me vlerë të qeverisë në raport me totalin e aktiveve të sektorit jobankar, pesha në %*	*92*
Grafik 114.	*Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në sektorin bankar ndaj totalit të aktiveve të tyre (në %)*	*92*
5.	*Politikat makroprudenciale dhe vlerësimi i rreziqeve*	
Grafik 115.	*Masat kryesore të ndërmarra në vendet e BE-së, sipas llojit*	*94*
Grafik 116.	*Numri i masave të ndërmarra nga vendet anëtare të BE-së*	*94*
Grafik 117.	*Instrumentet makroprudenciale me bazë kapitalin sipas vendeve të rajonit*	*95*
Grafik 118.	*Disa tregues të kredisë konsumatore*	*99*
Grafik 119.	*Kontributi i komponentëve në rritjen e kredisë konsumatore për rezidentët, sipas qëllimit të përdorimit (në pp)*	*100*
Grafik 120.	*Norma mesatare e interesit për kredinë e re dhënë individëve (majtas) dhe struktura e periudhave të fiksimit fillestar të normës së interesit për kreditë e reja për konsum (djathtas)*	*100*
Grafik 121.	*Përbërja e kredisë konsumatore sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe pesha e komponentëve në tre momente kohore , (djathtas)*	*101*

PARATHËNIE

Raporti i Stabilitetit Financiar (më tej "raporti") publikohet dy herë në vit dhe ky është numri i 23-të i tij. Në hyrje të tij është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila sipas kërkesës së ligjit duhet të publikohet çdo gjashtë muaj. Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e tij, si dhe vlerëson aftësinë e sistemit financiar për t'i përthithur këto rreziqe. Dokumenti në fjalë iu mundëson autoriteteve publike identifikimin në kohë të masave përkatëse për korrigjimet e nevojshme.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Analiza në vijim përfshin kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohore deri në 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe të rreziqeve që burojnë nga ndërveprimi me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin e pagesave, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve specifike, është vlerësuar gjendja financiare e sektorit të bizneseve/ndërmarrjeve dhe të individëve/familjeve si edhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Në raport janë përfshirë, edhe rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës, i cili vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj goditjeve makroekonomike dhe financiare, e shprehur kjo në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit. Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës përfshijnë në mënyrë të përmbledhur edhe skenarë të stresit të likuiditetit.

Raporti i Stabilitetit Financiar përgatitet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

SHËNIME

Në fund të muajit dhjetor 2019, klasifikimi i bankave në sektorin bankar shqiptar është si në vijim:

I. Sipas kontributit marzhinal të secilit institucion në rrezikun sistemik në vend[1], bankat grupohen në "Banka me Rëndësi Sistemike" (BARS) dhe "Banka të tjera" (josistemike).

II. Sipas origjinës së kapitalit, bankat grupohen në banka me kapital të huaj[2] dhe banka me kapital shqiptar:

- Banka me kapital të huaj janë: Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (Itali); Banka Alpha Albania sh.a. (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka OTP Albania sh.a. (Hungari); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari); Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (Arabia Saudite); Këto banka zotërojnë rreth 71% të totalit të aktiveve të sektorit.

- Banka me kapital shqiptar janë: Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a, Banka Amerikane e Investimeve sh.a., dhe Banka Tirana sh.a, Këto banka zotërojnë rreth 29% të totalit të aktiveve të sektorit.

III. Sipas shtrirjes së aktivitetit jashtë vendit:

Shtrirje të rrjetit bankar jashtë vendit kanë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. me filialin e saj në Kosovë, dhe Banka Credins sh.a, me degën e saj në Kosovë[3].

Për analizën e kryer në raport, duhet të konsiderohet që:

(1) Termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit; në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje" dhe "biznese" apo dhe "individë" dhe "familje";

---

[1] *Kontributi marzhinal individual matet nga "Indeksi i Fortësisë Financiare". Për më shumë informacion mbi indeksin dhe mbi përcaktimin e BARS, lutem konsultoni dokumentin: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_miratuara/*

[2] *Një bankë klasifikohet si bankë me kapital të huaj, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

[3] *Ndonëse Banka Credins sh.a., ka marrë miratimin nga organet përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë bankare në Republikën e Kosovës, aktiviteti operacional pritet të fillojë së afërmi.*

(2) Në këtë raport, "teprica e kredisë" i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç është raportuar nga bankat në bilancet e periudhave që analizohen. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga largimi i kredive me probleme nga bilancet e bankave gjatë periudhës që analizohet. Për këtë arsye, teprica e kredisë që analizohet në Raportin e Stabilitetit Financiar është një koncept i ndryshëm nga ai i "kredisë për ekonominë", që trajtohet në raportet e politikës monetare. Në kredinë për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobanka. Gjithashtu, në vlerën e kësaj kredie përfshihet vetëm kredia për sektorin privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirjet e kredive me probleme nga bilancet e bankave duke qenë se këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën ekonomike të tyre; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt. Dallimi në këto koncepte të kredisë, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

(3) Transformimi në "filial" i degës së BKT-së në Kosovë gjatë vitit 2018, përfaqësoi një thyerje strukturore në serinë e të dhënave të raportuara të periudhës, e cila preku statistikisht treguesit e analizuar të sektorit bankar në tërësi. Në raport, efekti statistikor mbi treguesit kryesorë të veprimtarisë së sektorit bankar është i pranishëm vetëm në kuadër të analizës vjetore të ecurisë së sektorit bankar.

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2019

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me zhvillimet ekonomike, të jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si edhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë e tij. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 (më tej, 'periudha'), sektori bankar tregoi zhvillime pozitive në veprimtarinë e tij, mbështetur në ecurinë e treguesve të performancës financiare dhe të ekspozimit ndaj rreziqeve. Me përmirësimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar, sektori bankar kontribuoi në rritjen ekonomike të vendit. Treguesit e kapitalizimit dhe ushtrimet e provës së rezistencës, dëshmojnë qëndrueshmërinë e veprimtarisë së sektorit bankar. Kjo qëndrueshmëri do të ruhet pavarësisht sfidës serioze dhe të paprecedentë me të cilën po përballet gjendja e shëndetit publik dhe zhvillimi i ekonomisë si rezultat i pandemisë së Koronavirusit SARS-COV-2 (Covid-19). Me këtë objektiv dhe për të kontribuuar më gjerësisht në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim të ngushtë me industrinë bankare dhe në harmonizim të plotë me autoritetet e tjera shtetërore, do të përdorë të gjitha instrumentet e nevojshme që i njeh ligji në mënyrë proaktive dhe transparente.

Ky raport, si rregull, analizon zhvillimet në sistemin financiar deri në fund të vitit 2019. Në përgjithësi, këto zhvillime, përpara ndikimit të pandemisë, konfirmonin:

- *Një kuadër të qëndrueshëm të zhvillimeve ekonomike brenda dhe jashtë vendit.* Megjithëse i ndjeu efektet e tërmetit të nëntorit 2019 në tremujorin e fundit të vitit, rritja ekonomike vjetore e vendit për vitin 2019 mbeti pozitive dhe vlerësohet me bazë të gjerë, duke mundësuar rënien e mëtejshme të normës së papunësisë dhe duke mbështetur zhvillime përgjithësisht pozitive në bilancin e pagesave në kushtet e performancës së mirë të sektorit të turizmit dhe të qëndrueshmërisë së remitancave. Prirja konsoliduese e politikës fiskale rezultoi e dobishme për të siguruar një korrektim të nevojshëm për përballimin e efekteve afatshkurtra të tërmetit. Në rang botëror, zhvillimet ekonomike nuk patën ndryshime të dukshme nga periudha e mëparshme; ato u përcaktuan nga lufta tregtare mes ekonomive më të mëdha, konfliktet rajonale dhe vijimi i politikave akomoduese monetare në kushtet e presioneve të përmbajtura inflacioniste.

- *Ecurinë normale të tregjeve financiare në vend.* Gjatë periudhës u evidentua rritje e normave të interesit në tregun parësor të titujve të qeverisë, si për emetimet afatshkurtra ashtu edhe për ato afatgjata. Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar shënoi rënie dhe u përqendrua kryesisht në emetimet afatshkurtra, duke reflektuar preferencën e investitorëve për zotërimin e titujve të borxhit deri në maturim. Rënie e vëllimit të transaksioneve ditore dhe javore u vu re edhe në tregun ndërbankar, por normat e interesit mbetën pranë nivelit të normës bazë të interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Kursi i këmbimit të lekut tregoi luhatshmëri të ulët gjatë periudhës. Në tregun e pasurive të paluajtshme, treguesit e marrë nga vrojtimet tregojnë për rritje të çmimit, në kushtet e rritjes së kërkesës dhe të ofertës. Gjatë periudhës, funksionimi i sistemeve të pagesave ka qenë optimal, duke njohur rritje të vëllimit dhe numrit të pagesave të procesuara.

- *Kushte më të përshtatshme financimi për individët dhe bizneset.* Si individët ashtu edhe bizneset rritën financimin e tyre nga sektori bankar gjatë periudhës, por kjo rritje ishte më e shpejtë tek bizneset. Edhe depozitat e të dy sektorëve në banka njohën rritje, por zgjerimi i depozitave të individëve ishte rreth 6 herë më i lartë se ai i bizneseve. Rritja e depozitave të individëve, e cila ishte kryesisht në valutë, reflektoi edhe rënien e investimeve të tyre në tituj. Sipas vrojtimit që kryen rregullisht Banka e Shqipërisë, pesha e familjeve që kanë një borxh për të paguar është relativisht e ulët (24%), dhe ngarkesa e borxhit vlerësohet e përballueshme. Për periudhën e ardhshme, familjet shprehen më të gatshme për të rritur nivelin e huamarrjes. Edhe për ndërmarrjet, ngarkesa me borxh vlerësohet e përshtatshme, në kushtet kur vlera e borxhit zë gjysmën e vlerës së kapitalit për 78% të ndërmarrjeve, dhe gati 67% e tyre deklarojnë se pagesa e borxhit nuk kalon 20% të të ardhurave të veprimtarisë. Megjithatë, barra e pagesës së borxhit shfaqet më e lartë tek ndërmarrjet e vogla. Edhe tek ndërmarrjet është vënë re një gatishmëri më e madhe për të rritur nivelet e huamarrjes në periudhën e ardhshme.

- *Performancën e mirë të sistemit financiar.* Gjatë periudhës, aktiviteti i sistemit financiar u zgjerua me gati 2.6 pikë përqindje, duke u ngjitur në 107% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Në këtë rritje, kontributin kryesor e dha zgjerimi i veprimtarisë së sektorit bankar, me gati 4% gjatë periudhës. Kontribut pozitiv në këtë ecuri dha aktiviteti i kreditimit dhe i vendosjeve, por më kryesori ishte aktiviteti i investimeve në tituj. Kredia shënoi rritje gjatë periudhës dhe për vitin 2019 ajo u zgjerua me 4.8%. Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë kredia për bizneset, ajo në lekë dhe ajo afatgjatë. Depozitat u rritën me 5.4% gjatë vitit, ku kontributin kryesor e dhanë depozitat e individëve, ato pa afat dhe ato në valutë. Sektori bankar e mbylli vitin me fitim më të lartë se një vit më parë, me një normë kthimi mbi aktivet dhe mbi kapitalin, përkatësisht në nivelet 1.4% dhe 13.5%. Rezultati financiar u ndikua dukshëm nga zgjerimi i fitimit prej instrumenteve financiare, ndërsa të ardhurat neto nga interesat, të cilat mbizotërojnë në të ardhurat e veprimtarisë bankare, shënuan rënie me 4.8%. Si rezultat, marzhi neto nga interesat ka zbritur në 3.4% në fund të periudhës, nga 3.7% një vit më parë. Ndonëse raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti me 0.2 pikë përqindje gjatë periudhës, niveli i tij prej 18.3% vlerësohet mjaft i mirë.

- *Ekspozimin e kontrolluar të sektorit bankar ndaj rreziqeve.* Gjatë periudhës, cilësia e portofolit të kredisë vijoi përmirësimin. Si rezultat, raporti i kredive me probleme zbriti në 8.4%, për herë të parë në nivel njëshifror gjatë dekadës së fundit. Kontributin në rënien e kredive me probleme gjatë periudhës e dhanë fshirjet, ristrukturimet dhe shlyerjet. Fshirjet e kredive me probleme kanë rinisur pas ndryshimeve rregullative të Bankës së Shqipërisë për shkurtimin në dy vjet të kohës së klasifikimit të kredisë si "e humbur", përtej së cilës banka duhet ta largojë kredinë nga bilanci. Përmirësimi në cilësinë e kredisë është vërejtur kryesisht në portofolin e kredisë për biznese, kredisë në valutë dhe kredisë me afate më të gjata maturimi. Në përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së kredisë, bankat administruan në mënyrë proaktive situatën e krijuar pas tërmetit të nëntorit 2019, që sidoqoftë ishte një goditje e kufizuar në kohë dhe në dëme. Një sfidë shumë më komplekse është përpara dhe lidhet me efektet që do të sjellë situata aktuale e pandemisë shëndetësore në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjendja e likuiditetit të sektorit bankar paraqitet mjaft e mirë dhe ka paraqitur pak ndryshime gjatë vitit 2019. Tek rreziqet e tregut, sektori bankar është i ndjeshëm ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes segmentit të kredisë së pambrojtur në valutë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit mbetet i pranishëm, por është relativisht i kufizuar.

  Rreziqet e veprimtarisë bankare reflektojnë dhe ndërthuren me zhvillime të natyrës strukturore. E tillë është ekzistenca për një kohë të gjatë e mjedisit me norma të ulëta interesi, i cili ruan presionin mbi rezultatin financiar të bankave, nxit ndryshimin e strukturës së financimit të tij

drejt burimeve më afatshkurtra dhe nevojës për aktive likuide të larta, si dhe ruan potencialin për rritje të stresit të veprimtarisë në rastin e një korrigjimi të fortë e të papritur. Përdorimi i lartë i valutës në sektorin bankar shoqërohet me rreziqe për administrimin e rrezikut të likuiditetit në valutë.

Banka e Shqipërisë është përpjekur t'i adresojë këto rreziqe nëpërmjet veprimeve rregullative të natyrës mikroprudenciale dhe instrumenteve të politikës makroprudenciale. Disa akte të reja rregullative që janë futur në zbatim - ku përfshihen ai për raportin e mbulimit të likuiditetit, paketa e masave për deeuroizimin, si edhe rregullorja për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, - synojnë zbutjen e rreziqeve dhe forcimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj tyre.

Vlerësim mbi ndikimin e pandemisë COVID-19

Kur vlerësohet gjendja dhe stabiliteti i sistemit financiar, si edhe kapacitetet e tij për përballimin e rreziqeve, vështrimi duhet të jetë nga e ardhmja. Në këtë proces, nevojitet një vlerësim i përgjithshëm mbi efektet që pandemia aktuale e koronavirusit mund të ketë mbi ekonominë dhe stabilitetin e sistemit financiar. Kjo pandemi dhe masat e marra nga Qeveria për mbrojtjen e jetës së shtetasve dhe eliminimin në një kohë sa më të shkurtër të emergjencës së koronavirusit, shoqërohen pashmangshmërisht me ndryshime të aktiviteteve që kryejmë në jetën e përditshme. Këto ndryshime përfshijnë edhe aktivitetet ekonomike ku ndikimi, ndonëse i përkohshëm, do të jetë i ndjeshëm. Më konkretisht, ndërmarrjet private dhe publike (me përjashtim ndoshta të atyre që ofrojnë shërbime jetike bazë), në varësi të aftësisë së tyre për t'u përshtatur qoftë edhe pjesërisht, mund të pësojnë dëmtim të zinxhirit të marrëdhënieve tregtare dhe do të ndjejnë mesatarisht një rënie të theksuar të shitjeve të mallrave e të shërbimeve. Kjo do të sjellë rënie të të ardhurave dhe vështirësi për të përballuar detyrimet financiare të veprimtarisë që lidhen me shpenzimet fikse dhe ato variabël. Kjo situatë do të ndikojë edhe mbi punëmarrësit dhe në tërësi mbi të ardhurat e familjeve, pasi rënia e aktivitetit të ndërmarrjeve mund të sjellë reduktim të të ardhurave apo ndërprerje të pagës. Në një efekt zinxhir dhe për aq sa nuk kompensohet nga kursimet e familjeve dhe masat shtetërore mbrojtëse, kjo edhe më tej mund të ndikojë në dobësimin e konsumit të tyre dhe në vijim, edhe në vështirësi për të përmbushur detyrimet financiare. Këto të fundit, mund të përfshijnë edhe vështirësi në shlyerjen e kredive të marra në institucionet financiare, duke sjellë rënie të cilësisë së kredisë në këto institucione dhe ndikim negativ në rezultatin financiar.

Është e nevojshme që, për aq sa është e mundur, autoritetet publike të ndërmarrin veprime të shpejta dhe të rëndësishme për të ndërprerë rrjedhën e lirë të skenarëve të mësipërm dhe për të mbështetur ndërmarrjet, familjet dhe sistemin financiar në zbutjen dhe përballimin e efekteve negative që i shoqërojnë këta skenarë.

Ky është edhe qëndrimi i institucioneve financiare ndërkombëtare dhe strukturave të Bashkimit Evropian, ndaj një situate që vlerësohet e paprecedentë. Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore kanë vendosur në dispozicion fonde financiare dhe instrumente të posaçme për shfrytëzimin e tyre, me qëllim huamarrjen e shpejtë të vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Komisioni Evropian shpalli paketën e posaçme financiare prej 37 miliardë eurosh për përballimin e efekteve ekonomike dhe financiare, që shoqërojnë shpërthimin e epidemisë në vendet anëtare. Fokusi është tek familjet dhe bizneset e vogla e të mesme, të cilat mund të përballen me nevoja të ngutshme për likuiditet. Së fundi, Komisioni Evropian deklaroi se do të mbështesë pezullimin e kërkesave të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes për përgjegjësinë fiskale, duke u mundësuar qeverive të vendeve anëtare të rrisin shpenzimet e nevojshme për përballimin e situatës. Në sferën monetare, Banka Qendrore Evropiane, në mbledhjen e datës 12 mars, ruajti kushtet monetare akomoduese dhe rriti në 120 miliardë euro paketën mujore të injektimit të likuiditetit përmes blerjes së titujve, duke synuar edhe zbutjen e luhatshmërisë së normave të interesit. Pak ditë më vonë, kjo u pasua nga një paketë e dytë në vlerën 750 miliardë euro. Më parë, edhe simotrat e saj në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar kishin marrë masa të ngjashme. Këto veprime të shpejta, ofruan shpresë dhe ndihmuan në ndalimin dhe korrektimin e pjesshëm të humbjeve të thella që kishin pësuar tregjet më të rëndësishme financiare. Nga këndvështrimi i mbikëqyrjes bankare në Bashkimin Evropian, Banka Qendrore Evropiane dhe Autoriteti Bankar Evropian kanë mbështetur nevojën për fleksibilitet në trajtimin rregullativ nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse, për të bërë të mundur që bankat të shndërrohen në një kanal më efektiv të përcjelljes së likuiditetit në ekonomi në situatën aktuale.

Në Shqipëri, autoritetet publike kanë ndërmarrë disa masa që synojnë zbutjen e ndikimit të pandemisë në ekonomi, duke shprehur nevojën për një qasje proporcionale dhe dinamike ndaj zhvillimeve të situatës dhe të panjohurave që e shoqërojnë atë.

Paketa fillestare financiare e prezantuar nga Qeveria, synon që krahas mbështetjes financiare për fuqizimin e kapaciteteve të strukturave të shëndetësisë, të zbusë pasojat financiare që kjo situatë mund të sjellë për agjentët realë të ekonomisë, pra edhe për rritjen ekonomike të vendit. Paketa ofron mbështetje për shtresat e popullsisë në nevojë dhe sigurimin e të ardhurave bazë për punëmarrësit në bizneset e vogla dhe ata të vetëpunësuar, në rastet kur veprimtaria ekonomike e tyre është ndërprerë për shkak të vendimeve të Qeverisë. Paralelisht, Qeveria ka ofruar garanci shtetërore për huamarrjen e re të bizneseve nga sektori bankar me qëllim plotësimin e nevojave të tyre afatshkurtra për likuiditet. Kjo e fundit, ofron mundësi për sipërmarrësit që të ruajnë fuqinë punëtore në afat të shkurtër, por edhe të përgatiten paraprakisht për një rifillim të veprimtarisë në mënyrën më të përshtatshme kur situata ta mundësojë. Më tej, janë bërë publike edhe disa lehtësime në përmbushjen e afateve të raportimeve tatimore. Së fundi, shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga ana e Qeverisë e kthen trajtimin e situatës së pandemisë në një përparësi absolute për strukturat e shtetit, përshpejton zgjerimin, detajimin

dhe fokusimin e politikave ndihmuese dhe ofron mekanizmat që sigurojnë një sinergji më të madhe mes entiteteve publike e private, e nevojshme për përballimin e situatës.

Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë veprimet e saja në drejtimet e administrimit institucional, komunikimit me subjektet e mbikëqyrura e posaçërisht me bankat, dhe në kuadër të politikave që zbaton.

Si institucion, Banka e Shqipërisë ka aktivizuar planin e saj të emergjencës nga strukturat e përcaktuara, ku në qendër janë vendosur siguria shëndetësore e personelit dhe vijimi pa ndërprerje i funksioneve kritike të bankës qendrore. Për të parën, është vepruar në përputhje me udhëzimet e Institutit të Shëndetit Publik dhe të Qeverisë, duke kufizuar ndërveprimin me personat e jashtëm, duke ndërtuar kuadrin e identifikimit dhe trajtimit të personelit potencialisht të infektuar, duke kërkuar zbatimin maksimal të kushteve të higjienës dhe të distancimit fizik, si edhe duke përmirësuar kapacitetet e higjienizimit dhe të dezinfektimit në mjediset e institucionit. Për të përmirësuar kushtet e distancimit fizik dhe ulur mundësinë e infektimit, një pjesë e personelit është autorizuar të punojë nga shtëpia. Paralelisht, është siguruar vijimi i funksioneve kritike të institucionit, për të përmbushur detyrimet ligjore dhe kontraktuale. Në qendër të vëmendjes kanë qenë veprimet e bankës qendrore në tregun e hapur, transaksionet e furnizimit të bankave tregtare me para fizike, mirëfunksionimi i sistemeve të pagesave dhe marrëdhëniet me kontraktorët.

Edhe në drejtim të komunikimit me bankat, fokusi fillestar ka qenë i njëjtë: aktivizimi i planeve të emergjencës me qëllim mbrojtjen shëndetësore të personelit dhe vijimin e veprimeve kritike të institucioneve financiare. Duke qenë se situata e pandemisë është e paprecedentë, Banka e Shqipërisë ndau me bankat një Udhëzim të posaçëm lidhur me veprimet e një organizate në këtë rast. Paralelisht, komunikimi me bankat ka vijuar për të detajuar mënyrën e organizimit të punës prej tyre dhe dakorduar mënyrën e bashkëpunimit në dhënien nga Banka e Shqipërisë të funksioneve mbështetëse. Deri në momentin e hartimit dhe miratimit të këtij raporti, vëllimet e punës i janë përshtatur orareve më të kufizuara të veprimtarisë dhe, brenda këtyre kushteve, proceset janë zhvilluar normalisht.

Në kuadër të politikave të saj, veprimet e Bankës së Shqipërisë mund të ndahen në dy grupe: 1) në lëmin e politikës monetare, dhe 2) në atë të mbikëqyrjes bankare e të stabilitetit financiar. Grupi i parë i veprimeve synon mbështetjen e gjendjes së likuiditetit të sistemit financiar dhe mirëfunksionimin e tregjeve të parasë. Grupi i dytë i masave synon që në këtë periudhë të ndalimit të një pjese të konsiderueshme të veprimtarisë ekonomike në vend, të zbutet ndikimi i situatës mbi cilësinë e portofolit të kredisë, të lirohen burimet e bankave nga veprimtari që mund të shtyhen në kohë dhe të ruhet gjendja e mirë e likuiditetit dhe e kapitalizimit të bankave, në mënyrë që baza për një rigjallërim të aktivitetit në përfundim të pandemisë të jetë solide.

Në kuadër të politikës monetare, Këshilli Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 25.3.2020, vendosi:

a) uljen e normës bazë të interesit me 0.50 pikë përqindjeje, në nivelin 0.5%. Në këtë mënyrë, bankat mund të marrin hua nga Banka e Shqipërisë me një kosto më të ulët dhe mund ta reflektojnë këtë kosto më të ulët në likuiditetin që përcjellin në ekonomi. Ky është niveli më i ulët historik i normës bazë të interesit të politikës monetare;
b) ngushtimin e diferencës mes normës së interesit të kredisë njëditore dhe të depozitës njëditore, duke ulur normën e interesit të kredisë njëditore në nivelin 0.9%. Përsëri, në këtë mënyrë, bankat që mund të kenë nevoja likuiditeti afatshkurtra, mund t'i përmbushin këto nevoja me instrumentin e posaçëm të Bankës së Shqipërisë.

Më parë, Banka e Shqipërisë kishte vendosur ndryshimin e formës së ankandit javor të injektimit të likuiditetit, për të mundësuar dhënien e likuiditetit të bankave në mënyrë të pakufizuar dhe me normën bazë të interesit.

Në kuadër të veprimeve në sferën e mbikëqyrjes dhe të stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë është fokusuar në nevojën për të ndihmuar huamarrësit në lehtësimin e përkohshëm të detyrimeve të tyre ndaj bankave dhe subjekteve të tjera kredidhënëse, në rastet kur huamarrësit ndeshen me vështirësi në kryerjen e veprimtarisë për shkak të masave për kufizimin e përhapjes së pandemisë. Për këtë qëllim, Guvernatori dhe Kryeministri i Shqipërisë, dolën me një urdhër të përbashkët, ku iu kërkojnë institucioneve të kreditimit të trajtojnë sa më shpejt kërkesat që vijnë nga huamarrësit e dëmtuar (biznese dhe individë) dhe të shtyjnë kështet e kredive të tyre deri në datën 31 maj 2020. Në vijim, Banka e Shqipërisë pret që bankat dhe institucionet e tjera të kredititi të ndjekin një qasje proaktive, përmes së cilës, në konsultim me huamarrësit, të përdorin forma të tjera të njohura veçanërisht nga përvoja e viteve të fundit, për të ulur probabilitetin e dështimit të huamarrësit. Gjithashtu është e nevojshme të vlerësohet dhe të mbështetet nevoja e agjentëve realë të ekonomisë për financim të ri, gjatë dhe në vijim të pandemisë.

Për të lehtësuar veprimtarinë e bankave dhe të subjekteve të tjera të mbikëqyrura në kushtet kur punojnë me numër të pakësuar personeli, Banka e Shqipërisë ka ndërprerë përkohësisht inspektimet në vend pranë tyre. Gjithashtu, janë shtyrë afatet për konsultime të projektakteve të ndryshme, që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të mbikëqyrura.

Ndonëse pandemia do të jetë e përkohshme, mbetet e panjohur se kur dhe me ç'ritëm do të dalë ekonomia nga efektet e saj. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë, në konsultim me bankat dhe subjektet e tjera të mbikëqyrura, do të punojë për të konceptuar veprime të tjera të natyrës rregullative që do t'i përgjigjen zhvillimeve. Duhet theksuar se të gjitha veprimet që janë ndërmarrë dhe do të ndërmerren, do të orientohen gjithmonë nga objektivi kryesor, ai i ruajtjes së qëndrueshmërisë së sektorit bankar. Në këtë proces, kapacitetet e

sektorit bankar do të vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe për këtë qëllim do të përdoren edhe ushtrimet e provës së rezistencës.

Për fundin e vitit 2019 dhe në raport me rreziqet konvencionale, rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës për gjendjen e kapitalizimit dhe të likuiditetit, tregonin gjendjen mjaft të mirë të këtyre kapaciteteve. Por situata e pandemisë, për efektet dinamike që po sjell në ekonominë e vendit, duket se përfaqëson një natyrë rreziku jokonvencional. Përballja me një situatë të tillë përmban të panjohura, të cilat kanë nevojë të kapen në mënyrë të përshtatshme nga modelet aktuale të vlerësimit të kapaciteteve të sistemit financiar dhe të sektorit bankar. Për këto arsye, është e nevojshme që bankat:

- të rrisin përparësinë dhe frekuencën e realizimit të këtyre ushtrimeve, duke përshtatur natyrën, ashpërsinë dhe kompleksitetin e skenarëve;
- të vlerësojnë përshtatshmërinë e kapaciteteve që zotërojnë, për të përballuar goditjet eventuale që prodhojnë ata skenarë, jo vetëm në afatin e shkurtër por edhe në një afat më të gjatë;
- të sigurojnë një proces vendimmarrjeje sa më të shpejtë dhe efektiv, për t'i fuqizuar këto kapacitete. Fokusi duhet të jetë tek ndërmarrja e veprimeve që jo vetëm ruajnë por edhe përmirësojnë më tej gjendjen e rezervave të kapitalit dhe të likuiditetit;
- të forcojnë komunikimin me Bankën e Shqipërisë, për analizimin e zhvillimeve dhe të rezultateve.

Megjithëse ky raport i kushtohet analizës së zhvillimeve deri në fund të vitit 2019, ai konfirmon se pandemia e ka gjetur sistemin financiar dhe sektorin bankar në një gjendje shumë të mirë financiare. Kjo gjendje financiare do t'i lejojë sektorit bankar të përthithë goditjet e mundshme nga efektet që pandemia do të ketë mbi ekonominë e vendit.

Në kuadër të rolit dhe të politikave të saj, dhe në koordinim me autoritetet e tjera shtetërore, Banka e Shqipërisë do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që sektori bankar dhe tregjet financiare, të veprojnë në këtë periudhë në kushte sa më të përshtatshme dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Në vijim, gjeni të detajuar përmbajtjen e raportit të stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019.

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

1.1 HARTA E STABILITETIT FINANCIAR

Treguesit makroekonomikë dhe realë reflektojnë një kuadër të qëndrueshëm zhvillimesh, ndërsa veprimtaria bankare paraqitet më e larmishme.

Në tërësi, rreziqet paraqiten në nivele të kontrolluara.

Mbështetur në të dhënat e fundit të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019, harta e stabilitetit financiar tregon përgjithësisht një nivel të pandryshuar të rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm makroekonomik dhe në agjentët e ekonomisë reale, dhe evidenton zhvillime të ndryshme në rreziqet që lidhen me veprimtarinë e sektorit bankar. Në mënyrë të përmbledhur, vlerësohet se:

A. në mjedisin e përgjithshëm ekonomik:

I. Rreziku që buron nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe i pandryshuar përgjatë harkut kohor të një viti. Në kushtet kur stoku i borxhit të jashtëm në raport me PBB-në dhe nevojat për financim të jashtëm kanë shënuar rënie, ngushtimi i hendekut të prodhimit ka dhënë kontributin kryesor në këtë zhvillim.

II. Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" mbetet në nivelin "mesatar", por regjistron rënie përgjatë vitit, duke reflektuar kryesisht rënien e çmimeve të naftës në tregjet ndërkombëtare. Në një masë më të vogël, kontribut në zbutjen e këtij rreziku dha edhe ecuria ekonomike e partnerëve kryesorë tregtarë dhe rënia e papunësisë në vendet me peshën më të lartë në dërgesat nga emigrantët.

B. Në sektorët kryesorë të ekonomisë reale:

I. Rreziku nga "bizneset" vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe ruan nivelin e një viti më parë. Pavarësisht përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë së bizneseve dhe "indeksit të gjendjes financiare", vërehet një përkeqësim i pritshmërive të sektorit privat, kryesisht në drejtim të punësimit.

II. Rreziku nga "individët" vlerësohet "mesatar" dhe në rënie ndaj një viti më parë. Nota e rrezikut për këtë kategori është ndikuar nga ritmi rritës i dërgesave të emigrantëve, nga përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë për individët dhe zhvillimet në tregun e banesave.

III. Rreziku nga "qeveria" vijon të vlerësohet "i ulët" dhe i pandryshuar përgjatë vitit të fundit. Megjithatë, zgjerimi i mëtejshëm i deficitit buxhetor sugjeron një vëmendje të shtuar për këtë sektor.

C. Në veprimtarinë e sektorit bankar, në fund të periudhës:

I. Rreziku nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria" mbetet në nivelin "mesatar", por shfaq prirje rritëse përgjatë vitit të fundit, ndikuar kryesisht nga rënia e të ardhurave nga interesat në aktivitetin bankar.

II. Rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" u ul në nivelin "mesatar" nga "i moderuar" në dhjetor 2018, duke reflektuar një mbështetje më të ulët në burimet e huaja të financimit.

III. Rreziku që lidhet me vetë "strukturën e sektorit bankar" vlerësohet në nivelin "mesatar" por disi në rritje ndaj një viti më parë, kryesisht si rezultat i rritjes së përqendrimeve në sektorin bankar.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar*



* Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 RREZIKU SISTEMIK[4]

1.2.1 TREGUESIT E AKUMULIMIT DHE TË MATERIALIZIMIT TË RREZIKUT SISTEMIK

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik vlerësohet mbi bazën e treguesve të akumulimit e të materializimit të rrezikut, si edhe të stresit financiar. Në këtë vlerësim përfshihet gjithashtu edhe perceptimi i sektorit bankar rreth këtyre rreziqeve[5].

Indekset e akumulimit, materializimit të rrezikut sistemik e të stresit financiar, konfirmojnë që nivelet e rrezikut sistemik mbeten të kontrolluara.

Indekset e materializimit të rrezikut sistemik dhe të stresit financiar reflektojnë zhvillime pozitive gjatë periudhës. Përmirësimi i cilësisë së kredisë, ulja e normës së papunësisë dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit, kontribuan në rënie të materializimit të rrezikut. Edhe treguesi i stresit financiar shfaq rënie duke reflektuar kryesisht përmirësim nga zgjerimi i bazës së depozitave.

Akumulimi i rrezikut sistemik nuk ka shfaqur lëvizje të forta gjatë vitit. Ai është ndikuar në rritje nga pesha më e lartë e kredive me normë të ndryshueshme interesi, nga rritja e çmimeve të banesave dhe nga rritja e kredisë për sektorin e bizneseve; dhe në rënie nga zvogëlimi i borxhit publik dhe i borxhit të jashtëm, në terma relativë.

[4] *Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".*

[5] *Perceptimi i sektorit bankar mbi rreziqet kryesore sistemike në vend përftohet nëpërmjet një vrojtimi ad hoc.*

Grafik 2. Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Indeksi i Stresit Financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2.2 PERCEPTIMI I RREZIKUT SISTEMIK NGA SEKTORI BANKAR

Ndonëse "rreziku politik në vend" dhe "përkeqësimi i ekonomisë së brendshme" mbeten dy rreziqet sistemike kryesore, tërmeti i muajit nëntor 2019 ka rritur pasigurinë për ecurinë e një pjese të portofolit të kredisë së bankave.

Sektori bankar vijon të evidentojë "rrezikun politik në vend" dhe "përkeqësimin e ekonomisë së brendshme", si dy ndër rreziqet sistemike kryesore. Gjithsesi, në ndryshim nga periudha paraardhëse, vlerësimi për këto rreziqe është zbutur, duke u ulur në nivelin "mesatar" nga "i lartë".

Nga ana tjetër, perceptimi i bankave mbi "rrezikun e kredisë nga të gjitha subjektet" dhe mbi "vështirësitë në procesin e ekzekutimit të kolateraleve" është rritur, duke reflektuar një lloj pasigurie të krijuar pas tërmetit të muajit nëntor 2019 dhe dëmit material e psikologjik të shkaktuar prej tij.

Grafik 4. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike në vend



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE SEKTORIALE

2.1 MJEDISI MAKROEKONOMIK I JASHTËM

Aktiviteti ekonomik botëror u zgjerua më ngadalë gjatë periudhës[6]. Zbutja e tensioneve tregtare mes SHBA-së dhe Kinës pas arritjes së një marrëveshjeje paraprake, vijimi i politikave lehtësuese monetare e fiskale në vendet e zhvilluara dhe në një pjesë të vendeve në zhvillim, si dhe rënia e shqetësimeve mbi administrimin e procesit të Brexit, ndikuan në stabilizimin e aktivitetit ekonomik dhe tregtar. Zhvillimet në tregjet financiare ishin përgjithësisht pozitive dhe të qëndrueshme, duke përfituar nga kushtet e lehtësuara të financimit. Si rezultat, tregjet e kapitalit shënuan rritje, flukset e financimit drejt vendeve në zhvillim u përmirësuan dhe normat e interesit të borxhit erdhën në rënie. Inflacioni shfaqi shenja rritjeje muajt e fundit të vitit, i ndikuar nga ecuria e çmimeve të naftës dhe të produkteve ushqimore. Gjithsesi, presionet inflacioniste afatgjata mbetën të ndrydhura si në rajonet e zhvilluara ashtu dhe në ato në zhvillim, duke reflektuar normat e moderuara të rritjes ekonomike.

Rimëkëmbja e brishtë e aktivitetit ekonomik botëror pritet të frenohet nga përshkallëzimi i tensioneve tregtare dhe nga efekti i pandemisë së koronavirusit "SARS-COV-2". Kjo e fundit ka sjellë tashmë ndërprerje në zinxhirin e prodhimit në rang botëror dhe vlerësohet se do ta ndikojë ekonominë botërore përmes rënies së konsumit, të investimeve, dhe tregtisë e turizmit.

Pritshmëritë e institucioneve financiare ndërkombëtare[7] flasin për një rritje modeste të aktivitetit ekonomik botëror gjatë dyvjeçarit të ardhshëm[8]. Kushtet e favorshme në tregjet financiare dhe vijimi i politikave akomoduese në vendet e zhvilluara dhe në një pjesë të vendeve në zhvillim, pritet të mbeten faktorë mbështetës në zgjerimin e tij. Nga ana tjetër, përshkallëzimi i konflikteve gjeopolitike dhe lëvizjet migratore mes shteteve, ringritja e shqetësimeve mbi barrierat tregtare dhe së fundi edhe pandemia e koronavirusit SARS-COV-2, konsiderohen rreziqet kryesore ndaj perspektivës ekonomike globale.

Ecuria e çmimeve në tregjet e këmbimit të monedhave dhe të lëndëve të para ka reflektuar zhvillimet ekonomike e politike globale dhe pritjet rreth tyre. Në tregjet e monedhave, euro u mbiçmua kundrejt monedhave kryesore si dollari amerikan dhe franga zvicerane, por u nënçmua kundrejt paundit britanik, ndikuar nga zbutja e tensioneve mbi daljen e Britanisë së Madhe nga BE-ja. Në tregjet e naftës, pas një periudhe rënieje deri në tetor 2019, çmimet shfaqën një prirje rritëse, duke arritur në rreth 70 usd për fuçi në fillim të janarit 2020. Kjo ecuri u ndikua nga tensionet gjeopolitike në Lindjen e Mesme dhe zbutja (e përkohshme) e mosmarrëveshjeve tregtare mes SHBA-së dhe Kinës.

---

6 *Përshkallëzimi i tensioneve gjeopolitike e tregtare, dhe problematikat e brendshme ekonomike e sociale, në disa prej vendeve në zhvillim, frenuan zgjerimin e tij.*

7 *Këto pritshmëri nuk përfshijnë reagimet më të fundit që lidhen me pandeminë e Koronavirusit (SARS-COV-2). Sipas këtyre reagimeve, efekti negativ i pandemisë në ekonominë botërore dhe veçanërisht në vendet e prekura më shumë, do të jetë i ndjeshëm ndonëse i përkohshëm.*

8 *FMN parashikon që ekonomia globale do të rritet me 3.3% gjatë vitit 2020 dhe me 3.4% gjatë vitit 2021 (World Economic Outlook, janar 2020).*

Grafik 5. Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 6. Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Ekonomia e Eurozonës vijoi të rritet gjatë periudhës, ndonëse me ritëm më të moderuar në T4-2019. Aktiviteti ekonomik u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme dhe rritja e investimeve, ndërsa eksportet neto dhanë kontribut negativ në reflektim të dobësimit të aktivitetit tregtar global dhe rënies së kërkesës së jashtme. Në tregun e punës, kushtet kanë vijuar të përmirësohen gradualisht dhe papunësia në nivel rajoni, në dhjetor 2019, ra në 7.4%, duke shënuar nivelin më të ulët të dekadës së fundit. Presionet inflacioniste mbeten të ndrydhura, ndonëse shfaqën një prirje të lehtë rritëse në fund të vitit, ndikuar kryesisht nga ecuria e çmimeve të naftës. Në këto kushte, Banka Qendrore Evropiane (BQE) konfirmoi angazhimin e saj në ruajtjen e kahut lehtësues të politikës monetare, në mbështetje të rritjes ekonomike të rajonit dhe arritjes së objektivit për normën e inflacionit pranë nivelit 2%.

Ekonomia e Eurozonës pritet të vijojë të zgjerohet me ritme të ngadalta. Forcimi i kërkesës së jashtme, kushtet e favorshme të financimit në tregjet ndërkombëtare dhe vijimi i politikave akomoduese monetare dhe fiskale pritet të mbështesin pozitivisht zgjerimin ekonomik të këtij rajoni. Pasiguritë lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare midis ekonomive të mëdha, dobësimin ekonomik të rajoneve në zhvillim, tensionet e papritura gjeopolitike, dhe, së fundi, pandemia e Koronavirusit SARS-Cov-2, mbeten faktorë rreziku ndaj perspektivës ekonomike të Eurozonës gjatë vitit në vijim.

Në sektorin bankar, kreditimi i sektorit privat vijon rikuperimin e qëndrueshëm. Në terma vjetorë, kreditimi për sektorin e bizneseve është moderuar në fund të vitit, ndërsa kreditimi ndaj sektorit të familjeve ka vijuar të konsolidohet gradualisht, mbështetur në kushtet e favorshme të financimit dhe zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme.

Tabelë 1. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	T3'19	T4'19	2019p	2020p	Qer'19	Dhj'19	Qer'19	Dhj'19	T2'19	T3'19
SHBA	2.1	2.3	2.3	2.0	1.6	2.3	3.7	3.3	103.2	105.4
Eurozonë	1.2	0.9	1.2	1.3	1.3	1.3	7.5	7.4	86.4	86.1
Gjermani	0.6	0.5	0.5	1.1	1.5	1.5	3.1	3.2	61.1	61.2
Francë	1.4	0.8	1.3	1.3	1.4	1.6	8.5	8.4	99.6	100.5
Itali	0.5	0.0	0.2	0.5	0.8	0.5	9.8	9.8	138.0	137.3
Greqi	2.3	:	:	:	0.2	1.1	17.1	:	179.6	178.2

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat,
P-parashikime (janar 2020) të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Zyra e Analizave Ekonomike (BEA –Bureau of Economic Analysis). Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labor Statistics).
": ": mungesë informacioni.

Aktiviteti ekonomik në rajonin e Ballkanit Perëndimor është rigjallëruar. Në tremujorin e tretë 2019, ekonomia e rajonit u rrit me 4.1% në nivel vjetor, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme dhe rritja e investimeve në disa prej vendeve të rajonit. Rritmi i rritjes është përshpejtuar krahasuar me tremujorin e kaluar, kur rezultoi 2.9%. Zgjerimi ekonomik ka ndihmuar në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve në tregun e punës dhe norma e papunësisë ka rezultuar në rënie në shumicën e vendeve të rajonit, ndonëse ndjeshëm më e lartë se në vendet e Evropës Perëndimore. Forcimi i kërkesës së brendshme solli një përmirësim të të ardhurave nga taksat, ndërsa borxhi publik është zvogëluar në raport me PBB-në në disa prej vendeve. Edhe deficiti tregtar është ngushtuar në shumicën e vendeve, por vijon të mbetet një ndër sfidat kryesore ekonomike të rajonit. Në kushtet e presioneve të dobëta inflacioniste, politikat monetare të bankave qendrore mbeten lehtësuese dhe, në disa raste, kanë ndërmarrë ulje të mëtejshme të normës bazë[9].

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (në %)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në %)	
	T2'19	T3'19	2020p	T2'19	T3'19	T3'19	T4'19*	T3'19	T4'19*
B&H	2.6	2.6	:	:	:	5.2	6.4	7.7	:
Maqedoni e Veriut	3.4	3.6	3.2	17.5	17.1	6.3	6.4	4.8	:
Mal i Zi	3.2	4.7	3.0	14.7	15.6	1.6	3.5	4.7	4.6
Kosovë	4.1	4.4	:	25.3	24.5	10.4	10.2	2.1	2.0
Serbi	2.9	4.8	3.8	10.3	9.5	4.9	4.8	4.7	4.6
Shqipëria	2.5	3.8	3.7	12.0	11.8	3.0	4.8	10.6	8.4
Turqi	-1.6	0.9	3.1	13.2	14.2	-1.6	10.4	5.0	5.2

Burimi: Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse.
'p'- parashikimi i muajit janar, 2020; ':' mungesë informacioni; "": të dhënat i referohen muajit nëntor 2019; "a": të dhënat i referohen T4-2019.*

Kredidhënia bankare reflekton një ritëm më të përshpejtuar rritjeje. Në disa nga vendet, si në Shqipëri dhe Serbi, rritja e kreditimit në favor të sektorit të biznesit ka tejkaluar atë të familjeve. Niveli i kredive me probleme ka vijuar të bjerë pothuaj në të gjitha vendet, duke sjellë përmirësim të bilancit të bankave dhe efekt pozitiv në kapacitetin kreditues të tyre.

[9] *Banka Kombëtare e Serbisë dhe Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut.*

2.2 MJEDISI MAKROEKONOMIK NË VEND

Ndërthurja e stimulit monetar dhe fiskal me ecurinë pozitive të mjedisit të brendshëm financiar, krijuan parakushtet për një ambient makroekonomik dhe financiar stimulues në vend.

Produkti i Brendshëm Bruto regjistroi një rritje vjetore negative prej 0.15% në tremujorin e katërt 2019[10]. Sidoqoftë, vlerësimet paraprake të INSTAT-it tregojnë për një rritje vjetore pranë nivelit 2.2%. Në tërësi, gjatë periudhës, aktiviteti ekonomik u mbështet në zgjerimin e konsumit dhe të eksporteve, ndërkohë që investimet private shënuan rënie. Analiza sipas sektorëve të ekonomisë evidenton se kontributi pozitiv dhe në rritje i degëve "industri", "tregti e transport" dhe "pasuri të paluajtshme", nuk mundi ta zhbënte kontributin negativ të aktivitetit të "ndërtimit", "artit, argëtimit dhe çlodhjes" dhe "bujqësisë". Ngushtimi i deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave ka përcaktuar kontributin pozitiv të sektorit të jashtëm të ekonomisë. Në tregun e punës, zhvillimet pozitive konfirmohen nga rënia e normës së papunësisë në nivelin më të ulët historik, 11.2%[11]. Gjithsesi, zhvillimet e pritshme në afatin e shkurtër për punësimin në sektorët kryesorë të ekonomisë rezultojnë në kahun rënës, ku situata e krijuar pas tërmetit të muajit nëntor 2019 duket se ka ndikuar në perceptimin e agjentëve në tërësi. Financimi i bollshëm i programit të rindërtimit, dukej se do ta përmirësonte këtë perceptim në mënyrë të dukshme. Por, prekja e vendit nga pandemia e koronavirusit SARS-Cov-2, në varësi të intensitetit të përhapjes, masave të marra dhe kohëzgjatjes së saj, me shumë gjasa do të shoqërohet me një efekt neto negativ mbi zhvillimet në ekonominë e vendit dhe në tregun e punës.

Politika monetare ka ruajtur kahun stimulues në kushtet e një niveli të ulët inflacioni, i cili shënoi 1.1% në dhjetor 2019[12]. Deri në fund të vitit, kushtet monetare vlerësoheshin si të përshtatshme për të mbështetur një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe për të rikthyer normën e inflacionit në objektiv në afatin e mesëm. Por ndikimi në ekonomi i situatës së pandemisë, kërkoi veprime shtesë për lehtësimin e mëtejshëm të kushteve monetare. Këto veprime, që udhëhiqen nga objektivat e Bankës së Shqipërisë, ndihmojnë në adresimin e vështirësive akute të agjentëve ekonomikë dhe në trajtimin e sfidave ekonomike që mund të ndeshen në një afat më të gjatë.

Në fund të vitit, vlera e deficitit buxhetor shënoi 31.5 miliardë lekë[13] me një rritje vjetore prej 5.3 miliardë lekësh. Gjatë vitit, të ardhurat buxhetore u rritën me 2.3%, por në nivel më të ulët se shpenzimet buxhetore që u rritën me 3.3%. Financimi i deficitit buxhetor është bërë tërësisht nga fondet e brendshme. Në terma relativë, deficiti buxhetor përbën rreth 2% të PBB-së, disi më i lartë se një vit më parë. Rritja e deficitit buxhetor, reflekton nevojën për shpenzime më të larta publike për përballimin e shpejtë të dëmeve që shkaktoi tërmeti i nëntorit 2019. Gjatë këtij viti, sfidat për politikën fiskale paraqiten më të mëdha, në kushtet e nevojës për përballimin financiar të shpenzimeve akute për ruajtjen e

[10] *Rritja reale vjetore e aktivitetit ekonomik në vend gjatë T3-2019 ishte 4.2%, ndërsa një vit më parë (T4-2018) ishte 3.05%.*

[11] *Norma e papunësisë shënonte nivelin 12.3% në T4-2018 dhe 11.5% në T2-2019.*

[12] *Inflacioni mesatar për T4-2019 ishte 1.3%, kundrejt 1.4% në T2-2019 dhe 1.8% një vit më parë (T4-2018).*

[13] *Një vit më parë (dhjetor 2018), deficiti buxhetor regjistronte vlerën prej rreth 26.2 miliardë lekësh.*

shëndetit publik në vijim të pandemisë dhe mbështetjes së një rigjallërimi sa më të shpejtë të ekonomisë në përfundim të saj.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me ngushtim të mjeteve valutore me rreth 73 milionë euro[14]. Deficiti i llogarisë korrente u ngushtua me rreth 7% në terma vjetorë, në nivelin 346 milionë euro. Ky zhvillim reflekton zgjerimin e ndjeshëm të suficitit në llogarinë e shërbimeve dhe në të ardhurat dytësore, pavarësisht thellimit të deficitit tregtar në mallra[15]. Prurjet valutore në formën e dërgesave të emigrantëve vlerësohen në rreth 182 milionë euro, të krahasueshme me periudhën paraardhëse por me një rritje të ndjeshme ndaj një viti më parë, rreth 8%. Në terma relativë, vlerësohet se deficiti i llogarisë korrente përbën rreth 8% të PBB-së, me prirje rritëse vjetore[16]. Në llogarinë financiare, flukset hyrëse shënuan nivelin prej rreth 77 milionë eurosh, ku spikat prirja rritëse e flukseve hyrëse në formën e investimeve direkte[17]. Në llogarinë kapitale, flukset neto pozitive shënuan vlerën prej rreth 26 milionë eurosh, ose 37% më pak në terma vjetorë. Së fundi, mjetet e rezervës valutore mbulojnë 6.5 muaj importe mesatare në mallra dhe shërbime.

Ngushtimi i deficitit korrent gjatë tremujorit të fundit të vitit u diktua kryesisht nga zgjerimi i suficitit të llogarisë së shërbimeve dhe të ardhurave dytësore.

2.3 ZHVILLIMET NË SEKTORË TË VEÇANTË TË EKONOMISË

2.3.1 POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE[18]

Gjatë periudhës, individët zgjeruan pozicionin e tyre kreditor, ndërsa bizneset zgjeruan pozicionin e tyre debitor.

Më konkretisht, individët dhe bizneset regjistruan një rritje të njëkohshme të bazës së depozitave dhe të tepricës së kredisë, me kontribut nga të gjitha monedhat. Për sektorin e individëve, bankat raportojnë një zgjerim të depozitave (në pjesën më të madhe në valutë) dhe të stokut të kredisë, respektivisht me rreth 38.2 miliardë lekë dhe 7.0 miliardë lekë. Për bizneset, rritja me rreth 9.7 miliardë lekë e kredisë (në pjesën më të madhe në Lek) u shoqërua me rritjen prej 6.9 miliardë lekësh të depozitave.

Zgjerimi i pozicionit financiar sipas sektorëve është kontribut i rritjes së depozitave në monedhë të huaj për individët dhe i kredisë në lekë për bizneset.

[14] *Zhvillimet i përkasin periudhës T4-2019.*

[15] *Deficiti tregtar në mallra u thellua me rreth 1.4% në terma vjetorë në vijim të rënies së shpenzimeve për importe me rreth 1.3% (kryesisht për lëndë djegëse dhe grupin "plastika dhe artikujt e tyre") dhe rënies së të ardhurave nga eksportet me rreth 10% (kryesisht në metalet bazë).*

[16] *Deficiti i llogarisë korrente përbënte rreth 7% të PBB-së në T4-2018.*

[17] *Flukset e investimeve të huaja direkte në formën e zgjerimit të kapitalit vlerësohen në 288 milionë euro, dhe janë të përqendruara kryesisht në sektorët e energjetikës, hidrokarbureve dhe të ndërmjetësimit financiar.*

[18] *Analiza i referohet zhvillimeve kryesore në pozicionin financiar të sektorit të individëve dhe të bizneseve. Për më shumë informacion mbi zhvillimet në sektorin bankar, lutem referojuni kapitullit përkatës.*

Kursimet e familjeve shqiptare mbeten qenësisht të orientuara drejt investimeve në sektorin bankar dhe më pak drejt formave të tjera të investimit që ofrojnë tregjet alternative.

Si rezultat, në fund të vitit 2019, pozicioni kreditor i sektorit të individëve u ngjit në nivelin e rreth 807 miliardë lekëve dhe pozicioni debitor i bizneseve u zgjerua në rreth 162 miliardë lekë.

2.3.2 INDIVIDËT/FAMILJET

Individët rezidentë rritën kursimet e tyre përgjatë periudhës me rreth 33 miliardë lekë. Rritja e depozitave dha kontributin kryesor në këtë zhvillim, përkundër tkurrjes së investimeve në titujt afatshkurtër të qeverisë dhe në fondet e investimeve. Edhe në terma vjetorë, kursimet e individëve u orientuan kryesisht drejt investimit në depozita dhe në të gjitha monedhat.

Grafik 7. Pozicioni financiar sektorial (miliardë lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 3. Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar

	2016, dhjetor		2017, qershor		2017, dhjetor		2018, qershor		2018, dhjetor		2019, qershor		2019, dhjetor	
	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %
Depozita në lekë	454.3	40.3	465.1	42.1	467.2	41.0	456.7	41.1	462.8	41.2	475.4	41.6	490.8	41.7
Depozita në valutë	476.4	42.3	432.8	39.2	469.5	41.2	447.1	40.3	464.6	41.3	469.6	41.1	492.4	41.9
Bono thesari	65.2	5.8	67.3	6.1	63.6	5.6	65.1	5.9	59.4	5.3	56.8	5.0	52.7	4.5
Obligacione	64.5	5.7	67.9	6.1	72.1	6.3	77.4	7.0	77.1	6.9	77.6	6.8	78.4	6.7
Fondet e investimeve	65.4	5.8	70.8	6.4	65.1	5.7	62.5	5.6	58.5	5.2	61.4	5.4	59.5	5.1
Fondet e pensioneve private vullnetare	1.2	0.1	1.3	0.1	1.6	0.1	1.8	0.2	2.2	0.2	2.3	0.2	2.6	0.2
Portofoli i individëve	1,127.00	100	1,105.20	100	1,139.10	100	1,110.60	100	1,124.60	100	1,143.10	100	1,176.44	100

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe AMF.
Shënim: Vlerat me yll i përkasin tremujorit të tretë 2019 sipas raportimeve më të fundit.

*HAPËSIRË INFORMUESE 1. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE**

Vrojtimi i referohet zhvillimeve në gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 dhe pritjeve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Në vrojtim kanë marrë pjesë rreth 89% e familjeve të kampionit të përzgjedhur, prej të cilave 53% banojnë në zonat urbane dhe 47% në zonat rurale të vendit. Për përzgjedhjen e kampionit, kryerjen e vrojtimit në terren dhe kontrollin e cilësisë së tij, angazhohet Instituti i Statistikave.

Numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Për të dyja periudhat, kjo rënie ka ardhur nga të tre kategoritë e të punësuarve (në sektorin shtetëror, privat dhe të vetëpunësuar).

Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe i shpenzimeve të familjeve ka rezultuar në rënie gjatë periudhës. Gjithsesi, rënia e shpenzimeve ka qenë disi më e theksuar se rënia e të ardhurave, duke sjellë një përmirësim të lehtë të balancës financiare (të ardhura-shpenzime) të familjeve.

Rreth 24% e familjeve të përgjigjura deklarojnë së kanë të paktën një hua për të paguar, të siguruar nga burime të ndryshme. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe ka shënuar një rënie të lehtë (me 1.8 pp) krahasuar me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit. Për këto familje, indeksi i të ardhurave është rritur gjatë periudhës, ndërsa indeksi i shpenzimeve ka qenë në rënie, duke rezultuar në përmirësim të balancës financiare (të ardhura – shpenzime).

Totali i tepricës së raportuar të huasë rezulton në rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe me një vit më parë. Rreth 73% e kësaj teprice është siguruar nga burime formale (68% nga bankat dhe 5% nga institucione financiare jobanka) dhe rreth 27% nga burime joformale (si 'persona fizikë', 'hua në formë malli' etj.). Kjo strukturë është zhvendosur me 3 pp në favor të huamarrjes formale në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Në përbërjen sipas monedhës, rezulton se 71% e tepricës është në lekë dhe 14% në valutë (kryesisht euro).

Pesha e huamarrjes me qëllim blerje/riparim prone ka shënuar rritje në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 36% e tepricës së huasë deklarohet për blerjen/riparimin e një prone, 36% për 'zhvillimin e një biznesi' dhe vetëm 7% për 'konsum'. Ndërkohë që pesha e tepricës së huasë të përdorur për blerje/riparim prone është rritur krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe një vit më parë, pesha e huasë për biznes ka rezultuar në rënie në terma vjetorë.

Familjet huamarrëse raportojnë mosndryshim të kështit të huasë gjatë periudhës dhe përmirësim të aftësisë së tyre paguese. Rreth 68% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë përmirësim krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Për gjashtëmujorin e ardhshëm (gjysma e parë e vitit 2020), shumica e familjeve (rreth 75% e tyre) nuk presin ndryshim të aftësisë paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të përgjigjeve tregon pritje më të dobëta.

Mundësia për të marrë hua gjatë pjesës së parë të vitit 2020 vlerësohet në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë, duke sinjalizuar një rigjallërim të kërkesës për huamarrje të familjeve.

* *Për më shumë informacion mbi këtë vrojtim, mund të konsultoni: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Analiza_dhe_studime/Vrojtime/Vrojtim_mbi_Gjendjen_Financiare_dhe_Huamarrjen_e_Familjeve_ne_Shqiperi.html*

Borxhi i familjeve shqiptare mbetet në nivele të kontrolluara dhe rigjallërimi i kërkesës për huamarrje të re përbën një zhvillim pozitiv.

Ngarkesa me borxh e familjeve mbetet në nivele relativisht të përshtatshme dhe shfaq prirje rënëse. Nga vrojtimi rezulton se rreth 24% e familjeve shqiptare të vrojtuara kanë të paktën një borxh për të paguar. Kjo peshë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe ka shënuar një rënie të lehtë ndaj një viti më parë, por mbetet 4 pp nën mesataren historike të vrojtimit (që prej vitit 2010). Bazuar në ecurinë e indekseve të të ardhurave dhe shpenzimeve të huamarrësve, konstatohet se gjatë periudhës të ardhurat kanë qenë në rritje ndërsa shpenzimet në rënie, duke sjellë një përmirësim të balancës financiare të familjeve.

Grafik 8. Ecuria e huamarrjes së familjeve (në % ndaj totalit të familjeve të përgjigjura)



Grafik 9. Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse (2010=100)



Kërkesa për huamarrje e familjeve ka dhënë sinjale rigjallërimi. Rreth 40% e të përgjigjurve deklarojnë se e konsiderojnë mundësinë për të marrë/rimarrë një hua të re në gjashtëmujorin e ardhshëm dhe kjo peshë është rritur krahasuar me dy vrojtimet e kaluara. Rrjedhimisht "Indeksi i mundësisë për të marrë një hua të re" ka rezultuar me rritje dhe mbi vlerën e mesatares afatgjatë të tij. Nga huamarrësit që deklarojnë se planifikojnë të marrin hua, rezulton se rreth 63% e tyre janë "huamarrës të rinj", pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit. Kjo peshë është rritur në terma 6-mujorë dhe vjetorë (përkatësisht me 4 pp), në mbështetje të pritshmërive për huamarrje të re.

Grafik 10. Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 11. Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3.3 BIZNESET/NDËRMARRJET

Borxhi i ndërmarrjeve vlerësohet në nivele të përballueshme, në terma të kapitalit dhe të ardhurave. Pritshmëritë më optimiste për huamarrje të re në afat të shkurtër përfaqësojnë një zhvillim pozitiv.

Ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve vlerësohet në nivele të përballueshme dhe në rënie përgjatë vitit, më e theksuar kjo për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vlera totale e huasë rezultoi afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit për 78% të ndërmarrjeve huamarrëse dhe e barabartë ose më e madhe për 22% të tyre. Raporti hua/kapital ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e mëdha, ku 23% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh rezulton më e shprehur tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të tregtisë.

Tabelë 4. Pesha e ndërmarrjeve me vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali sipas sektorëve

	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MI 2018	22.4%	19.8%	15.2%	20.2%
6MII 2018	20.7%	14.9%	15.0%	29.6%
6MI 2019	26.8%	18.5%	18.3%	28.8%
6MII 2019	20.4%	28.0%	13.4%	26.5%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (67%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të tyre dhe ky tregues shfaq rënie krahasuar me vrojtimin paraardhës (4.2 pp). Barra e pagesës së huasë duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku numri i ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë tejkalon 20% të të ardhurave, zë 52% të totalit të grupit[19]; ndërsa, për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, kjo peshë shënon respektivisht

[19] *Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: "20-50% të të ardhurave","50-80% të të ardhurave" dhe "mbi 80% të të ardhurave".*

33% dhe 29%. Të pyetura nëse pagesa e huasë ka ndryshuar gjatë periudhës, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 94% e ndërmarrjeve të vogla, 92% e ndërmarrjeve të mesme dhe 93% e ndërmarrjeve të mëdha), pohojnë që ky shpenzim ka mbetur i pandryshuar. Përgjigjet e pjesës tjetër kanë rezultuar në balanca neto pozitive për ndërmarrjet e vogla dhe mëdha, duke treguar rritje të këtij shpenzimi, ndërkohë që paraqitet negative për ndërmarrjet e mesme.

Grafik 12. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, nga përgjigjet e ndërmarrjeve gjykohet se kërkesa për kredi jep sinjale rigjallërimi. Rreth 48% e ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se nuk ka asnjë mundësi që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme. Krahasuar me vrojtimin e kaluar, kjo peshë ka rënë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por është rritur për ato të mëdha.

Grafik 14. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të kredimarrjes në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Indeksi i planifikimit të kredimarrjes bankare në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, vihet re një rritje e peshës së ndërmarrjeve të vogla që pohojnë se ka pak mundësi të marrin një kredi në gjysmën e parë të vitit 2020, ndërkohë që është rritur pesha e ndërmarrjeve të mesme që shprehen se ka shumë mundësi që diçka e tillë të ndodhë. Gjithashtu, të gjitha grupet e ndërmarrjeve, por veçanërisht ato të mesme dhe të mëdha, kanë shënuar një rritje për alternativën "është e sigurt", duke u paraqitur më optimistë në planifikimin e huamarrjes. Kjo ecuri mund të sinjalizojë një rritje të kërkesës për kredi në afatin e shkurtër.

HAPËSIRË INFORMUESE 2. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE

Vrojtimi i dytë i referohet zhvillimeve në gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve në gjashtëmujorin e dytë 2019 dhe pritjeve për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Për këtë vrojtim u përdor një kampion prej rreth 1360 ndërmarrjesh të madhësive të ndryshme, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Nga këto, 1111 ndërmarrje ose 82% e totalit morën pjesë në vrojtim duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit.

Gjatë periudhës, ndërmarrjet e vrojtuara raportojnë se konkurrenca dhe gjetja e tregut mbeten sfidat kryesore për aktivitetin e tyre. Rëndësia e tyre vlerësohet disi në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Elementet që kanë shfaqur rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve për periudhën janë kostot e financimit dhe disponueshmëria e stafit të kualifikuar.

Ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar gjatë periudhës vlerësohen në rritje për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla, por në përmirësim krahasuar me dy vrojtimet e kaluara. Të tre grupet e ndërmarrjeve duket se kanë bërë përpjekje pozitive për zgjerim të veprimtarisë së tyre, më e shprehur kjo tek ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha. Pritshmëritë e të gjitha ndërmarrjeve mbeten pozitive lidhur me shitjet, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë, por ato paraqiten më pak optimiste në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.

Më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se e kanë financuar veprimtarinë e tyre nëpërmjet shitjeve. Mbështetja vetëm në këtë burim ka rënë për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vazhdon të zërë një peshë të konsiderueshme dhe të zgjeruar gjatë periudhës për të gjitha llojet e ndërmarrjeve.

Rreth 37% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura (410 ndërmarrje) deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rënie me 1.6 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 5.2 pp krahasuar me një vit më parë.

Burimet formale të huamarrjes (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 91% e ndërmarrjeve huamarrëse të përgjigjura, në rënie me 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm. Ndër to, rreth 86% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar si burim i vetëm huamarrjeje. Huamarrja e mbështetur vetëm në burime informale është pohuar nga rreth 4% e ndërmarrjeve. Kombinimi i burimeve formale dhe atyre informale është përdorur nga 5% e ndërmarrjeve.

Huamarrja e ndërmarrjeve përdoret kryesisht për kryerjen e investimeve afatgjata (rreth 45% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe për të përballuar shpenzimet korrente (30% e ndërmarrjeve të përgjigjura). Gjatë periudhës, huamarrja e ndërmarrjeve kryhet vetëm në monedhën vendase për 57% të ndërmarrjeve të vogla, 56% të ndërmarrjeve të mesme dhe 36% të ndërmarrjeve të mëdha, ndërsa pjesa tjetër është në valutë dhe/ose e kombinuar. Huamarrja në valutë, kryesisht në euro, rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (54% e tyre), duke tejkaluar monedhën vendase, dhe më pak tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (përkatësisht 35% dhe 38% e tyre).

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve e konsideron të përshtatshëm nivelin aktual të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është më e ulët për ndërmarrjet e vogla dhe lehtësisht më e ulët për ato të mëdha, ndërkohë që është rritur për ato të mesme.

Procesi i huamarrjes nga bankat vijon të vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", në zbutje krahasuar me periudhën e kaluar për ndërmarrjet e mëdha, por në rritje për ato të vogla. Rëndësia e marrëdhënies me bankat vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme", por disi në rënie tek të tre grupet e ndërmarrjeve, më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të vogla.

Në mbështetje të pritshmërive pozitive për huamarrje të re vijnë dhe rezultatet e analizës së numrit të aplikimeve për kredi dhe normës së refuzimit të tyre nga sektori bankar. Përkundrejt një kërkese të lartë, kryesisht nga sektori i "individëve", oferta e sektorit bankar duket më pak mbështetëse. Kjo reflektohet në numrin më të lartë të refuzimeve, krahasuar me numrin e refuzimeve për "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe për "ndërmarrjet e tjera". Gjithsesi, analiza sipas strukturës evidenton një sjellje të ndryshme të bankave vendase kundrejt atyre të huaja. Një informacion më i detajuar mbi ecurinë e aplikimeve për kredi dhe refuzimet përkatëse paraqitet në hapësirën informuese 3.

HAPËSIRË INFORMUESE 3. ECURIA E NUMRIT TË APLIKIMEVE PËR KREDI DHE ANALIZA E NORMËS SË REFUZIMIT NGA BANKAT NË VEND GJATË 6MII-2019

Gjatë periudhës, bankat raportojnë se kanë marrë në shqyrtim gjithsej 68,751 aplikime për kredi, ku rreth 7% i përkasin sektorit të "ndërmarrjeve" (2,959 aplikime nga "ndërmarrje të vogla dhe të mesme" - në vijim, NVM - dhe 2,149 aplikime nga "ndërmarrje të tjera"'), dhe 93% i përkasin sektorit të "individëve" (63,643 aplikime). Kjo strukturë është zhvendosur në favor të klientëve "individë" krahasuar me dy periudhat paraardhëse.*

*Numri total i aplikimeve është rritur me rreth 36% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, të ardhura tërësisht nga segmenti i "individëve" (rritje gjashtëmujore me rreth 41%). Ndërkohë, segmenti i "ndërmarrjeve" në total nuk ka pasur ndryshim (pjesa e "NVM-ve" ka shënuar rënie me rreth 3%, ndërsa "ndërmarrjet e tjera" kanë shënuar rritje me 4%). Në terma vjetorë, numri total i aplikimeve të marra në shqyrtim ka shënuar rritje me 39%, të ardhura kryesisht nga segmenti i "individëve" (në rritje me 43%) dhe më pak nga segmenti i "ndërmarrjeve" (në rritje totale me rreth 5%)**.*

Në totalin e aplikimeve të marra në shqyrtim, rezulton se rreth 14% e tyre janë refuzuar nga bankat dhe kjo normë ka vijuar prirjen rritëse të konstatuar që pas 6-mujorit të dytë 2017, por me ritëm më të ngadalësuar. Rritja e normës së refuzimit gjatë periudhës, duket se ka vijuar të mbetet në drejtim të segmentit të "individëve", ndërkohë që për "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe "ndërmarrjet e tjera", kjo normë është ulur ndjeshëm.

Grafik 16. Ecuria e numrit të aplikimeve të shqyrtuara dhe norma e refuzimit të kredive



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke e analizuar normën e refuzimit të bankave të ndara sipas origjinës së kapitalit në banka vendase dhe të huaja, rezulton se gjatë viteve të fundit, kjo normë për bankat vendase ka qenë vazhdimisht më e ulët krahasuar me bankat e huaja. Për periudhën në analizë, duket se prirja për kreditim e bankave vendase dhe atyre të huaja ka vijuar të ecë në drejtime të kundërta. Kështu, norma totale e refuzimit të aplikimeve për kredi nga bankat e huaja ka vijuar të rritet duke rezultuar në nivelin 19.2% (nga 18.7% e rezultuar një 6-mujor më parë), ndërsa për bankat vendase kjo normë ka rënë në 5.6% (nga 7% në 6-mujorin e kaluar).

Grafik 17. Norma e refuzimit të kredive



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas segmenteve të klientelës, bankat e huaja kanë mbetur më refuzuese ndaj aplikimeve për kredi të "individëve", dhe më pranuese ndaj segmentit të ndërmarrjeve ('NMV"' dhe "ndërmarrjeve të tjera"). Nga ana tjetër, norma e refuzimit të bankave vendase ka rënë gjatë periudhës kundrejt segmentit të "individëve" dhe "ndërmarrjeve të tjera", dhe është rritur disi kundrejt ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në përgjithësi, nga analiza e mësipërme mund të arrihet në përfundimin se ecuria e numrit të aplikimeve të shqyrtuara nga bankat, tregon për një kërkesë për kredi në rritje nga sektori i "individëve" dhe një kërkesë ende të moderuar nga sektori i "bizneseve". Bankat mbeten përgjithësisht hezituese kundrejt kreditimit të individëve, ndërkohë që preferenca e tyre për të kredituar "ndërmarrjet e mëdha" ka vijuar të rritet gjatë vitit 2019.

* *Në këtë grup përfshihen kryesisht ndërmarrjet e mëdha dhe çdo lloj ndërmarrjeje tjetër që nuk klasifikohet si "ndërmarrje e vogël dhe e mesme".*

** *Përkatësisht, rritje vjetore me 1% nga "ndërmarrjet e vogla dhe të mesme" dhe rritje vjetore me rreth 10% nga "ndërmarrjet e tjera".*

3. TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE

3.1 TREGJET

TREGU PRIMAR I LETRAVE ME VLERË

Norma mesatare e interesit të borxhit të brendshëm shënoi rritje në gjysmën e dytë të vitit 2019. Kjo normë u ngjit në 2.4%, rreth 0.6 pp më e lartë ndaj minimumit historik të arritur gjatë gjashtëmujorit të parë (1.8%), por e krahasueshme me normën mesatare të së njëjtës periudhë të një viti më parë. Emetimi i borxhit të brendshëm në lekë ishte rreth 130 miliardë lekë, ose 25% më pak krahasuar me emetimin e gjashtëmujorit të kaluar, por në vlerë të përafërt me atë të një viti më parë. Karakteristikë e viteve të fundit është përqendrimi i emetimeve gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit.

Borxhi afatshkurtër vijon të mbizotërojë në strukturën e borxhit të brendshëm në lekë me 63% të totalit, megjithatë kjo peshë ka ardhur gradualisht në rënie.

Ndonëse, në përgjithësi oferta e investitorëve ka qenë më e lartë se kërkesa e Qeverisë për huamarrje, norma mesatare e interesit të borxhit të brendshëm është rritur gjatë periudhës. Kundrejt një viti më parë, niveli i normës mesatare të interesit të borxhit, nuk shfaq ndryshime të rëndësishme. Emetimet e borxhit afatshkurtër vijojnë të përbëjnë pjesën kryesore të borxhit, por pesha e tyre ka ardhur në rënie.

Grafik 18. Ecuria e normës mesatare të interesit të letrave me vlerë të borxhit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 19. Përbërja e borxhit të brendshëm të emetuar gjatë periudhës 2015-2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli mesatar i normës së interesit për titujt afatshkurtër të borxhit shënoi nivelin 2.0%, me rritje në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë[20]. Ecuria e normës mesatare të interesit u ndikua nga rritja me 0.7 pp e normës mesatare të bonove të thesarit 12-mujore, të cilat aktualisht përfaqësojnë të gjithë borxhin afatshkurtër. Emetimi i bonove të thesarit ishte 82 miliardë lekë, ose 30% më pak se në pjesën e parë të vitit, por në të njëjtin nivel me vitin e kaluar. Gjatë periudhës,

[20] *Përkatësisht 1.3% dhe 1.7%.*

oferta për investim në tituj afatshkurtër ka qenë e njëjtë ose më e lartë se kërkesa e qeverisë për huamarrje. Norma e interesit për maturitetin 12-mujor u rrit nga 1.7% deri në 2.3% gjatë tremujorit të tretë, por rritja e vazhdueshme e ofertës për investim ka ndikuar në uljen graduale të normës gjatë tremujorit të fundit të vitit dhe rikthimin e saj në nivelin 1.7%.

Grafik 20. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 21. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6MII-2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e normës mesatare të interesit është vërejtur edhe për tituj afatgjatë të borxhit të qeverisë. Norma për tituj afatgjatë arriti në 3.1% nga 2.8% gjatë gjysmës së parë të vitit. Të gjithë tituj afatgjatë, me përjashtim të maturitetit 10-vjeçar[21], kanë shënuar rritje në normat mesatare të interesit dhe rritja e regjistruar ka qenë nga 0.04 deri në 0.7 pikë përqindjeje. Vëllimi i emetuar ishte rreth 48 miliardë lekë, ose 13% më pak se në pjesën e parë të vitit, por në nivel të krahasueshëm me vitin e mëparshëm.

Grafik 22. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 23. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6MII-2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[21] *Rënie me 0.2 pikë përqindje e normës mesatare të interesit.*

Rreth 60% e vëllimit të obligacioneve të emetuara përbëhen nga obligacionet me afat maturimi 2- dhe 5-vjeçar me normë interesi të fiksuar. Në përgjithësi, oferta për investim në tituj afatgjatë ka qenë më e lartë sesa kërkesa për huamarrje nga qeveria, dhe kjo ecuri është shoqëruar me një prirje në rënie të normave të interesit gjatë tremujorit të fundit të vitit.

TREGU SEKONDAR I LETRAVE ME VLERË

Gjatë periudhës, aktiviteti në tregun sekondar të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë shënoi rënie në vlerë dhe në numër transaksionesh. Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë afatshkurtër dhe afatgjatë, që u tregtuan në tregun sekondar me pakicë ishte rreth 3 miliardë lekë, ose 33% më pak krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit dhe 27% më pak kundrejt vitit të kaluar. Numri i transaksioneve ishte 1,120, ose 11% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorin paraardhës. Ndikimin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rënia në vëllimin dhe numrin e letrave afatgjata me përkatësisht 70% dhe 40% ndaj vlerave përkatëse të gjashtëmujorit të parë të vitit.

Aktiviteti në tregun sekondar të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë shënoi rënie në vlerë dhe në numër transaksionesh.

Investitorët vijojnë të shfaqin preferencë për t'i mbajtur letrat me vlerë deri në maturim.

Në transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë mbizotërojnë transaksionet në bono thesari, që zënë rreth 70% të vëllimit të tregtuar. Megjithëse numri i transaksioneve ka ardhur në rënie krahasuar me gjashtëmujorin dhe vitin e kaluar[22], vëllimi i tregtuar u rrit lehtë ndaj gjashtëmujorit paraardhës, por qëndroi në nivele të përafërta me ato të gjysmës së dytë të vitit të kaluar. Investitorët në tregun sekondar me pakicë vijojnë të shfaqin preferencë për t'i mbajtur letrat me vlerë deri në maturim (vetëm rreth 30% e tyre tregtohen).

Grafik 24. Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 25. Numri i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Zhvilluesit e tregut (*market makers*) kanë vijuar kuotimet ditore të titujve *benchmark* (obligacione referencë me maturitet 3- dhe 5-vjeçar), por vëllimi dhe numri i

[22] *Përkatësisht me 7% dhe 8% më pak.*

transaksioneve regjistrojnë vlera më të ulëta krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me vitin e mëparshëm. Kuotimi me bazë ditore i titujve referencë mundëson llogaritjen e kurbës së *yield*-it, që shërben si referencë për titujt e tjerë të borxhit në treg dhe rrit transparencën duke dhënë informacion në kohë reale për çmimin e letrave me vlerë afatgjatë. Kurba e yield-it e harkuar dhe në rritje sinjalizon për një situatë ekonomike normale në të cilën obligacionet me maturitet më afatgjatë kanë *yield* më të lartë nga ato me maturitet më të shkurtër.

Grafik 26. Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar sipas titujve të tregtueshëm



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 27. Nivelet e *yield*-it (YTM) në datën 31.12.2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGU NDËRBANKAR

Aktiviteti në tregun ndërbankar regjistron tkurrje dhe normat e interesit luhaten pranë nivelit të normës bazë.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit, vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar është tkurrur, ndërsa normat e interesit janë luhatur pranë nivelit të normës bazë të interesit, të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Tregu ndërbankar vijon të mbizotërohet nga transaksionet 1-javore (64% e vëllimit të huamarrjes ndërbankare), ndjekur nga transaksionet 1-ditore (22%). Në krahasim me gjysmën e parë të vitit, vëllimi i transaksioneve shënoi rënie për shkak të tkurrjes në vëllimin e transaksioneve 1-ditore dhe 1-javore. Ndërkohë, pas një periudhe të gjatë mungese, janë rishfaqur në treg transaksionet 1-mujore. Vëllimi i tyre ishte sa 10% e vëllimit të përgjithshëm të transaksioneve. Bankat kanë kryer dhe transaksione me maturitet 2-ditor apo 3-ditor, por me vëllime më të vogla, krahasuar me llojet e tjera. Normat e interesit kanë qëndruar pranë nivelit të normës bazë të interesit prej 1%.

TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Kurset e këmbimit Lek/Euro dhe Lek/USD gjatë gjysmës së dytë të vitit kanë ruajtur prirjet e regjistruara gjatë gjysmës së parë të vitit, duke ndjekur njëkohësisht ecurinë e kursit Euro/USD në tregjet ndërkombëtare. Gjatë vitit 2019, në tregun vendas është vënë re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj euros (me 1%) dhe një nënçmim i tij ndaj dollarit amerikan (me 1.4%). Në dhjetor 2019, vlerat mesatare të kursit të këmbimit të Euros dhe dollarit amerikan ishin përkatësisht 122.2 lek/njësi dhe 109.9 lekë/njësi. Kundrejt muajit qershor 2019, këto vlera tregojnë një nënçmim të lehtë të lekut.

Në tregun e këmbimeve valutore, luhatshmëria e kursit të këmbimit të lekut ka qenë përgjithësisht e ulët. Ajo ka reflektuar kryesisht zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

Grafik 28. Normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 29. Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në tregun e pasurive të paluajtshme, treguesit sinjalizojnë rritje të kërkesës dhe ofertës gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019. Në tërësi, kërkesa është mbështetur nga rritja e kredisë së individëve për blerje pasurish të paluajtshme, e favorizuar nga normat e ulëta të interesit dhe lehtësimi i kushteve të bankave për këtë lloj kredie. Për rritje të kërkesës sinjalizojnë edhe raportimet e agjentëve të tregtimit të pasurive të paluajtshme që tregojnë për rënie të numrit të pronave të pashitura dhe rritje të atyre të shitura. Oferta në tregun e pasurive të paluajtshme vijon të mbështetet nga kredia për ndërtim, e cila ka ruajtur nivelet e dy periudhave paraardhëse. Të dhënat për numrin e lejeve të ndërtimit dhe madhësinë e sipërfaqeve tregojnë që interesi për ndërtime të reja vijon të jetë i lartë.

Në tregun e pasurive të paluajtshme, të dhënat e mbledhura nga vrojtimi dhe tregues të kredisë bankare për ndërtim dhe pasuri të paluajtshme, flasin për ecuri të mirë të veprimtarisë dhe mbështesin rritjen e indeksit të çmimit të banesave. Pritshmëritë e agjentëve mbeten pozitive për periudhën e ardhshme.

Për periudhën, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme kanë raportuar çmime shitjeje më të larta ndaj gjashtëmujorit të kaluar. Çmimet e banesave të llogaritura sipas Indeksit Fischer[23] për shitjet e kryera gjatë periudhës, janë rritur

[23] *Indeksi ndërtohet mbi bazën e informacionit të raportuar nga shoqëritë e ndërtimit dhe agjentët që operojnë në tregun e pasurive të paluajtshme.*

me 13.8% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 33.5% në krahasim me periudhën bazë (viti 2013). Për shitjet e realizuara në zonën e Tiranës, që përfshin qendrën, periferinë dhe zonat jashtë qytetit, indeksi regjistroi një rritje prej 14.9% ndaj periudhës paraardhëse dhe 34.7% ndaj periudhës bazë.

Grafik 30. Ecuria e Indeksit Fischer të Çmimit të Banesave në rang vendi dhe për Tiranën



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 31. Cilësia e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Agjentët mbeten relativisht optimistë për zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme dhe përgjithësisht situata në këtë treg vlerësohet e qëndrueshme. Për periudhën e ardhshme, agjentët presin numër të njëjtë pronash të reja që do të regjistrohen për shitje dhe rritje të çmimeve të pronave të paluajtshme.

Të dhënat e sektorit bankar për periudhën tregojnë një nivel në rritje të tepricës së kredisë për pasuri të paluajtshme dhe përmirësim të cilësisë së saj gjatë periudhës dhe kundrejt një viti më parë. Stoku i kredisë për blerje pasurish të paluajtshme nga sektori i individëve shënoi rreth 120 miliardë lekë në fund të vitit 2019 dhe ishte rreth 6% më i lartë ndaj fundit të vitit 2018. Ecuria e kësaj kredie është favorizuar edhe nga norma interesi disi më të ulëta për këtë kategori kredie. Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie ra në 4.4%, nga rreth 5.5% një vit më parë. Teprica e kredisë për ndërtim ruajti nivele të përafërta me ato të fundit të gjashtëmujorit të parë dhe të fundit të vitit të kaluar. Pesha e kredisë për ndërtim zë 14% të tepricës së kredisë së bizneseve, duke mbajtur nivele thuajse të pandryshuara gjatë dy viteve të fundit.

Në fund të periudhës, stoku i kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme shënoi rritje mbështetur kryesisht nga ecuria e kredive të kolateralizuara në monedhën vendase. Brenda kësaj ndarjeje, 62% e stokut mbahet nga sektori i individëve dhe pjesa tjetër nga sektori i bizneseve.

HAPËSIRË INFORMUESE 4. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR 6M II-2019

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës nga ana e agjentëve në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme. Subjektet e zgjedhura janë agjentë imobiliarë dhe shoqëri ndërtimi shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar.

Vlerësimi i përgjithshëm. Vlerësimi i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut nuk ka treguar ndryshime të rëndësishme në krahasim me periudhën e kaluar. Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve rezultoi [-2.2]% dhe tregon se numri i agjentëve që kanë dhënë përgjigje pozitive (më mirë) ka qenë thuajse i njëjtë me numrin e atyre që janë përgjigjur "më keq", ndërkohë që rreth 60% e përgjigjeve ishin neutrale – "pa ndryshim". Kjo vlerë e balancës, edhe pse me vlerë të vogël negative, gjatë viteve të fundit është ngushtuar ndjeshëm në krahasim me mesataren afatgjatë prej rreth [-20.7]%. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje gjatë periudhës rezultoi, siç pritej, pozitiv në vlerën 13.4%, në linjë me ecurinë afatgjatë.

Ecuria e çmimeve dhe e shitjeve. Në fund të periudhës, Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi shënoi rritje me 33.5% në krahasim me nivelin e periudhës bazë (viti 2013) dhe rritje me 13.8% ndaj gjashtëmujorit të mëparshëm. Vëllimet e shitjeve kanë rënë lehtë vetëm në zonat qendrore të Tiranës, dhe janë rritur në të gjithë zonat e tjera të kryeqytetit dhe në rang vendi. Indeksi i Çmimit për Tiranën u rrit me 34.7% ndaj periudhës bazë dhe me 14.9% ndaj periudhës paraardhëse. Çmimet mesatare raportohen të rritura ndjeshëm në të gjithë vendin, por kanë qenë relativisht të qëndrueshme në qytetet bregdetare. Në Tiranë, ato u rritën me 15.3% në qendër, rreth 25% në zonat jashtë qytetit dhe shumë pak në zonat periferike. Në zonat e tjera**, çmimet u rritën gjithashtu me 15.4% ndaj periudhës paraardhëse. Kjo ecuri mund të reflektojë efektin e krijuar pas tërmetit të nëntorit 2019, ku kërkesa për shtëpi të ulëta, kryesisht jashtë Tiranës, raportohet e rritur.*

Numri i banesave të regjistruara. Agjentët raportojnë numër më të ulët banesash të reja të regjistruara në librat e tyre. Balanca neto e atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre, ishte rreth [-11.5]%, duke treguar ndryshime të vogla nga periudha e kaluar. Numri i pronave të pashitura, si për banesat, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjashtëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes. Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi raportohet të jetë mesatarisht 10.3 muaj dhe shënoi një rritje të lehtë ndaj gjashtëmujorit të kaluar. Për Tiranën, subjektet e intervistuara kanë raportuar një kohë mesatare shitjeje prej 9.2 muajsh ose 2 muaj më të shkurtër se ajo e raportuar në gjashtëmujorin e kaluar. Për zonën e bregdetit, koha e shitjes është rritur nga 8.3 muaj në rreth 10.3 muaj dhe për zonat e tjera, koha e shitjes u rrit nga 9.2 muaj në 11.3 muaj.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare. Sipas agjentëve, rreth 65% e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Kjo shifër shënon rritje në krahasim me vlerën prej 46% të raportuar në periudhën paraardhëse.

Pritjet për të ardhmen. Agjentët kanë pritje pozitive për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe janë optimistë për periudhën më afatgjatë (deri në dy vjet). Numri i pronave që pritet të regjistrohen për shitje gjatë periudhës në vazhdim, pritet të mos ketë ndryshime të rëndësishme (balanca neto rezultoi [-2.3]%). Agjentët presin rritje të çmimeve të pronave të paluajtshme. Balanca neto ishte pozitive për banesat (16%) dhe pronat tregtare (15.8%), duke reflektuar optimizëm nga ana e agjentëve. Kjo balancë ka shënuar vlera pozitive në nivele të ngjashme me vlerat aktuale prej disa gjashtëmujorësh.

Kërkesa dhe çmimi i qirasë. Shumica e përgjigjeve nga agjentët raportojnë kërkesë konstante për qiramarrje për periudhën, si për banesa, ashtu edhe për prona tregtare. Në të njëjtën linjë, çmimet e qirasë raportohen të pandryshuara nga të intervistuarit. Nevojitet të theksohet që këto përgjigje janë të përqendruara në zonën e kryeqytetit.

* *Rritja në Indeksin e Çmimit për Tiranën dhe për të gjithë territorin ndryshon nga rritja në çmimet mesatare pasi Indeksi i Çmimit merr parasysh edhe raportin 'vëllim shitjesh gjatë periudhës bazë'/'vëllim shitjesh gjatë periudhës referencë'. Periudha bazë (viti 2013) është karakterizuar nga vëllime të larta dhe çmime të ulëta shitjeje në krahasim me periudhën aktuale. Për këtë arsye, rritja në Indeksin e Çmimit është më e ulët në krahasim me rritjen në çmimin mesatar të thjeshtë, që nuk merr parasysh vëllimet e shitjeve.*

** *"Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së Bregdetit.*

3.2 SISTEMET E PAGESAVE

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhën vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet.

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhën vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan, gjatë periudhës, 61,643 pagesa me një vlerë prej 5,026 miliardë lekësh. Numri dhe vlera e transaksioneve kanë regjistruar një rënie prej përkatësisht 4% dhe 7% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit. Paralelisht, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës, janë kleruar 370,856 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 172,000 lekësh. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje si në numër, ashtu edhe në vlerë, përkatësisht me gati 11%.

Grafik 32. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH gjatë vitit 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përdorimi i instrumenteve të pagesave ka regjistruar një rritje të konsiderueshme gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019. Gjatë kësaj periudhe janë kryer rreth 10.3 milionë pagesa me një vlerë totale prej 2,374 miliardë lekësh. Në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit, numri i transaksioneve u rrit me 23%, ndërsa vlera e tyre u rrit me 11%. Transfertat e kreditit vijojnë të mbizotërojnë në instrumentet e pagesave, por pesha e këtij instrumenti ka rënë diktuar nga rënia në numër dhe në vlerë e këtyre instrumenteve në formën letër. Nga ana tjetër, është regjistruar një rritje e numrit dhe vlerës së transfertave të kreditit në formën joletër (internet banking, mobile banking) si dhe një rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera me karta.

Grafik 33. Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë (6M II 2014-2019)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4. SISTEMI FINANCIAR

Pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së është rritur. Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë sektori bankar. Treguesit e performancës së sistemit financiar në terma të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira.

Pesha e totalit të aktiveve të sistemit financiar[24] ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u rrit në 107% nga 104.4% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, por nuk ndryshoi ndaj nivelit të një viti më parë. Aktiviteti i sektorit bankar dhe i institucioneve financiare jobanka mbështeti rritjen e aktiveve të sistemit financiar, ndërsa aktivet e fondeve të investimeve shënuan tkurrje.

Gjatë periudhës, pesha e sektorit bankar ndaj PBB-së u rrit me 2.5 pp, në 95.5%, ndërsa pesha e sektorit jobankar u rrit me 0.3 pp, në 11.7%. Treguesit e performancës së sistemit financiar duke përfshirë ata të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit e të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira.

Tabelë 5. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite

Autoriteti Licensues dhe Mbikëqyrës	Sistemi financiar	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	88.1	92.1	94.8	97.6	97.3	100.5	99.4	96.0	95.5
	Institucione jobanka	2.7	2.7	2.7	3.0	2.9	3.0	3.1	3.5	4.2
	SHKK dhe Unioni	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.6	0.6	0.6	0.7
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.5	1.6	1.7	1.9	2.1	2.1	2.1	2.1	2.2
	Fondet e pensionit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2
	Fonde investimi		1.2	3.9	4.8	5.0	4.7	5.0	4.5	4.3
Ndërmjetësimi financiar		93.1	98.6	103.8	108.2	108.0	111.0	110.3	106.9	107.2

Grafik 34. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

[24] *Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar (institucione financiare jobanka, shoqëritë e kursim- kreditit, shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit dhe fondet e investimit). Baza e të dhënave për shoqëritë e sigurimit i përket T3-2019, ndërsa për segmentet e tjera fundit të vitit 2019.*

4.1 SEKTORI BANKAR

4.1.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN BANKAR

Gjatë periudhës, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 4%, ndërsa kundrejt një viti më parë rritja e aktiveve është rreth 1.5%. Vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 52 miliardë lekë gjatë periudhës duke arritur në rreth 1,476 miliardë lekë. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë zgjerimi i investimeve në tituj me rreth 38 miliardë lekë dhe pakësimi i fondeve rezervë me rreth 10 miliardë lekë. Aktiviteti kreditues dhe ai ndërbankar ndikuan pozitivisht në ecurinë e aktivit si rrjedhojë e zgjerimit të huasë afatgjatë dhe depozitave në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare.

Depozitat dhe fondet e veta mbeten burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e kufizuar dhe shënon rënie të mëtejshme. Efekti pakësues i vlerësimit të kursit të këmbimit, është ulur ndjeshëm.

Tabelë 6. Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, dhjetor 2019

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor, %	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor, %
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	31.9	-0.9	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	6.0	9.7
II. Veprime me klientët (Kredia)	38.9	-0.8	II. Veprime me klientët (Depozita)	80.6	1.1
Nga e cila: për sektorin publik	2.1	8.2	Nga të cilat: të sektorit publik	1.9	1.3
Nga e cila: për sektorin privat	36.8	-1.3	Nga të cilat: të sektorit privat	78.8	1.1
III. Veprimet me letrat me vlerë	27.4	5.1	III. Veprimet me letrat me vlerë	0.2	-63.6
IV. Fonde rezervë të krijuara	-1.9	-33.9	IV. Detyrime të tjera	0.9	-7.5
V. Të tjera*	3.8	-5.6	V. Burimet e përhershme	12.1	4.0
			Nga të cilat: Borxhi i varur	1.0	3.5
			Nga të cilat: Kapitali aksioner	10.5	4.2
Totali i aktiveve	100	1.5	Totali i pasiveve	100	1.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.
** Tek zëri "Të tjera" në bilanc i referohemi: "Mjeteve të tjera", "Mjeteve të qëndrueshme" dhe "Interesave të përllogaritura".*

Gjatë periudhës, efekti statistikor i kursit të këmbimit në vlerat e bilancit valutor të bankave ka rënë ndjeshëm krahasuar me dy gjashtëmujorët e mëparshëm, por ka vijuar të ndikojë në rënien e vlerave të raportuara për veprimet në valutë. Aktivet dhe pasivet në valutë të sektorit bankar përbënin përkatësisht 53% dhe 51% të totalit të bilancit, me rritje të lehtë në krahasim me gjashtëmujorin e parë. Në anën e aktivit, kursi i këmbimit ka ndikuar në të njëjtën masë aktivitetet kryesore të bankave, ndërsa në anën e pasivit, pothuajse i gjithë efekti statistikor i kursit të këmbimit (prej -2 miliardë lekësh) është reflektuar në kundërvlerën në lekë të depozitave në valutë.

Grafik 35. Efekti i kursit të këmbimit në ecurinë e zërave kryesorë të aktivit (majtas) dhe pasivit (djathtas), kundërvlera në lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat dhe fondet e veta vijojnë të përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar, duke zënë mbi 90% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë nuk ka shënuar ndryshime të dukshme gjatë periudhës. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet e kufizuar dhe ka shënuar rënie të mëtejshme gjatë periudhës. Detyrimet ndaj jorezidentëve në formën e depozitave dhe titujve të blerë/shitur me repo kanë vijuar të pakësohen. Në të njëjtën kohë, është evidentuar rritje e vendosjeve në formën e depozitave ndërbankare në subjektet jorezidente dhe investimeve në tituj, gjë që ka ndikuar në zgjerimin e pozicionit kreditor neto të sektorit bankar. Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 24% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet zinin më pak se 3% të totalit të bilancit. Pozicioni kreditor neto u zgjerua si në terma absolutë, ashtu dhe relativë, duke arritur në rreth 21.3% të totalit të bilancit nga 20% një periudhë më parë.

Grafik 36. Struktura e detyrimeve jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 37. Pozicioni neto me jorezidentët



*Vija e zezë vertikale (grafiku djathtas) pasqyron periudhën e transformimit të degës së BKT në filial.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.1.1 Kapitalizimi i veprimtarisë

Sektori bankar vijon të karakterizohet nga nivele të larta të treguesve të kapitalizimit dhe në nivel bankash individuale, asnjë bankë e sektorit nuk rezulton me normë mjaftueshmërie nën minimumin rregullator prej 12%. Në fund të vitit 2019, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 18.3%, nga 18.5% në qershor 2019 dhe 18.7% një vit më parë.

Bankat e klasifikuara si me rëndësi sistemike dhe bankat me kapital evropian kanë nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Rënia e numrit të bankave nga 14 në gjysmën e parë të vitit 2019, në 12 në fund të vitit, u reflektua në ndryshime në shpërndarjen e normave të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas intervaleve të caktuara. Aktualisht numërohen 9 banka nga 12 të tilla me një normë mjaftueshmërie mbi 15% dhe gjithashtu evidentohet rritje e peshës së bankave me normë të mjaftueshmërisë të kapitalit në intervalet 18%-20% dhe mbi 20%.

Rritja më e shpejtë e aktiveve me rrezik në krahasim me rritjen e kapitalit rregullator, ka ndikuar në rënien e lehtë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat me rëndësi sistemike, si grup, paraqesin tregues të lartë të kapitalizimit të veprimtarisë. Ecuria e treguesit të levës financiare konfirmon që kapitalizimi i sektorit paraqitet në nivele të kënaqshme.

Grafik 38. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 39. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në ecurinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, efekti negativ i rritjes së aktiveve të peshuara me rrezik ishte më i madh në krahasim me efektin pozitiv të rritjes së kapitalit rregullator. Gjatë periudhës, kapitali rregullator u rrit lehtë në nivelin 143 miliardë lekë, duke dhënë një efekt në rritje prej 0.2 p.p në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ecuria e tij u mbështet nga rritja e rezervave dhe fitimit të pashpërndarë dhe nga ecuria pozitive e rezultatit financiar. Këta faktorë së bashku, zbutën efektin e ndryshimeve strukturore në pronësitë e bankave, i cili rezultoi në një rënie të lehtë të kapitalit të paguar. Nga ana tjetër, aktivet e peshuara me rrezik arritën në rreth 790 miliardë lekë, ose 20 miliardë lekë më shumë ndaj qershorit 2019, si rezultat i rritjes së ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare (korporatave). Rritja e këtij treguesi dha një kontribut në rënie prej 0.5 p.p. në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Grafik 40. Kontributi i zërave të mjaftueshmërisë së kapitalit (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 41. Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit sipas instrumenteve përbërëse (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e aktiveve të peshuara me rrezik sipas rreziqeve nuk ka ndryshuar dhe vijon të mbizotërohet nga aktivet e peshuara për rrezikun e kredisë (88%). Aktivet e peshuara për rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional u zgjeruan me përkatësisht 5 miliardë lekë dhe 2 miliardë lekë në krahasim me një gjashtëmujor më parë, por ruajtën peshat e tyre në totalin e aktiveve të peshuara me rrezik, prej përkatësisht 2% dhe 10%.

Në krahasim me dy gjashtëmujorët paraardhës nuk janë raportuar ndryshime të ndjeshme në shpërndarjen e aktiveve të peshuara për rrezikun e kredisë, si për sektorin në tërësi, ashtu edhe për bankat e grupuara sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit. Bankat e klasifikuara me rëndësi sistemike paraqesin ekspozim të lartë për kredinë ndaj shoqërive tregtare (korporatave), kredinë me probleme dhe kredinë ndaj institucioneve të tjera të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Bankat e tjera (josistemike) paraqesin ekspozim edhe ndaj pasurive të paluajtshme (kolateral), përveç ekspozimit ndaj kredisë dhënë korporatave. Sipas origjinës së kapitalit, bankat me kapital evropian kanë ekspozim më të lartë për klasat "kredi për korporata dhe kredi me probleme" dhe "portofoli më pakicë (retail)", ndërsa bankat me kapital vendas krahas ekspozimeve të sipërpërmendura paraqesin ndjeshmëri ndaj portofoleve të klasifikuara me rrezik më të lartë dhe të pambuluara nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Grafik 42. Shpërndarja e aktiveve të sektorit bankar sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 43. Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i përshtatshëm i levës financiare gjë që konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë të kapitalizimit. Treguesi i levës financiare[25] në dhjetor 2019 ishte 9.6 herë, duke treguar rënie krahasuar me fundin e vitit 2018, dhe i pandryshuar kundrejt gjysmës së parë të vitit. Prirja në rënie në terma vjetorë e levës financiare reflekton rritjen më të shpejtë të kapitalit aksioner në raport me ecurinë e aktivit. Në nivel banke, vlerat e treguesit kanë ardhur duke iu afruar vlerës së mesit, çka përbën një zhvillim pozitiv për strukturën e financimit të sektorit bankar.

Grafik 44. Ecuria e levës financiare sipas përbërësve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 45. Shpërndarja e levës financiare në nivel banke



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[25] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksioner.*

4.1.1.2 Rezultati financiar

Sektori bankar zgjeroi rezultatin financiar pozitiv të veprimtarisë gjatë vitit 2019, duke u pasqyruar në vlera në rritje të treguesve të rentabilitetit. Kontributin pozitiv kryesor e dha fitimi nga instrumentet financiare.
Tkurrja e vazhdueshme e rezultatit neto nga interesat, ka qenë dhe kontribuuesi kryesor në ngushtimin e mëtejshëm të marzhit neto nga interesat.

Sektori bankar e mbylli vitin 2019 me një rezultat financiar pozitiv prej rreth 20 miliardë lekësh. Ky rezultat ishte rreth 1.5 miliardë lekë më i lartë se një vit më parë. Faktori me ndikimin kryesor në rritjen e rezultatit financiar ishte fitimi nga instrumentet financiare. Të ardhurat neto nga interesat e klientëve – burimi kryesor i të ardhurave të sektorit bankar - vijuan të pakësohen, ndërsa shpenzimet e përgjithshme për provigjione u rritën. Rritja në fitimin e sektorit është pasqyruar edhe në rritjen e treguesve të rentabilitetit të sektorit bankar, ku kthimi nga aktivet (RoA) u rrit në 1.4% nga 1.3%, ndërsa kthimi mbi kapitalin (RoE) arriti në 13.5% nga 13%, një vit më parë.

Rezultati neto nga interesat ra me 4.8%, në 41.7 miliardë lekë, me kontribut të përbashkët nga rënia e shpenzimeve për interesa dhe e të ardhurave prej tyre. Të ardhurat nga interesat u pakësuan në një masë dukshëm më të lartë (rreth 3 miliardë lekë) se shpenzimet për interesa. Pavarësisht se të ardhurat nga interesat kanë rënë për të gjithë zërat, rënia është përqendruar tek interesat nga klientët, ndërsa në anën e shpenzimeve rënia është regjistruar si në interesat për depozitat, ashtu edhe në interesat e paguara për letrat me vlerë.

Grafik 46. Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 47. ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Rënia në rezultatin neto nga interesat është reflektuar në rënien e marzhit neto nga interesat në nivelin 3.4%, nga 3.7% një vit më parë. Rënia ka ardhur jo vetëm si pasojë e pakësimit të të ardhurave nga interesi, por edhe për shkak të rritjes së emëruesit: aktiveve mesatare që sjellin të ardhura. Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera shënuan rritje të lartë, me rreth 14 miliardë lekë, dhe kaluan në vlerë pozitive për shkak të kthimit në një fitim prej rreth 2 miliardë lekësh të humbjeve të vitit të kaluar. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë u raportuan të pandryshuara.

Shpenzimet në formën e provigjioneve ishin 7 miliardë lekë më të larta se një vit më parë, duke ndikuar në tkurrjen e rezultatit financiar. Zëri "Provigjione për mjete të tjera financiare", ndryshe nga një vit më parë që përmirësoi fitimin e sektorit me një vlerë rimarrjesh prej rreth 9 miliardë lekësh, gjatë vitit 2019 luajti një rol të papërfillshëm. Nga ana tjetër, shpenzimet për humbjet e mundshme nga kreditë u pakësuan ndjeshëm në 0.2 miliardë lekë nga 2.3 miliardë lekë të regjistruara gjatë vitit 2018, duke dhënë një efekt pozitiv në rezultatin neto të sektorit bankar. Pesha e aktiveve të bankave që regjistruan humbje financiare ndaj aktiveve të sektorit bankar ishte rreth 4%.

Grafik 48. Marzhi neto nga interesi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 49. Treguesit e përfitueshmërisë

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostot e veprimtarisë u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave në fund të vitit ishte rreth 60%, dhe shënoi rënie të ndjeshme në krahasim me një vit më parë, kur ky raport iu afrua nivelit 80%. Në rënien e treguesit ka kontribuar rritja e fortë e të ardhurave bruto, që pasqyron rritjen e të ardhurave nga veprimtaritë e tjera. Shpenzimet e veprimtarisë, brenda të cilave shpenzimet e personelit dhe ato operacionale mbajnë peshën kryesore, kanë ruajtur nivele të krahasueshme me ato të vitit 2018. Gjatë viteve të fundit, vërehet një përmirësim në shpërndarjen e bankave sipas vlerave të këtij treguesi. Gjatë periudhës 2012-2015, pesha mesatare e aktiveve të bankave që e kishin këtë raport mbi 80% ishte rreth 30%, ndërsa për periudhën 2016-2019 kjo vlerë ka rënë në 20%.

Eficienca e burimeve është përmirësuar kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave bruto dhe kontrollit të shpenzimeve të veprimtarisë.

Grafik 50. Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 51. Shpërndarja e bankave sipas raportit shpenzime/të ardhura (% ndaj totalit të aktiveve)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 5. AKTIVITETI I BANKAVE NË LEKË DHE VALUTË

Në bilancin e sektorit bankar, aktivet dhe pasivet në valutë zënë rreth 50% të vlerave të përgjithshme, por pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve tregon që sektori bankar gjatë dy viteve të fundit ka gjeneruar një fitim dukshëm më të lartë nga aktiviteti në valutë në krahasim me aktivitetin në lekë. Kështu, në vitin 2018, nga fitimi prej 18 miliardë lekësh, rreth 11 miliardë erdhën nga aktiviteti në valutë. Për vitin 2019, aktiviteti në lekë gjeneroi një fitim prej 5 miliardë lekësh, ndërsa ai në valutë një fitim prej rreth 15 miliardë lekësh. Nga një analizë më e thelluar e të ardhurave dhe shpenzimeve vërehet që, pavarësisht se aktiviteti në lekë gjeneron rreth 1.5 deri në 2 herë më shumë të ardhura nga aktiviteti në valutë, aktiviteti në valutë i siguron sektorit bankar një fitim më të lartë për shkak të vlerës mjaft më të ulët të shpenzimeve operacionale dhe atyre për personelin në krahasim me aktivitetin në lekë.

Tabelë 7. Të ardhurat dhe shpenzimet kryesore të sektorit bankar sipas valutave për vitet 2018-2019

Mld lekë	2018		2019		
	Lekë	Valutë	Lekë	Valutë	Valutë/Total (%)
Interesa nga klientët	16	15	17	13	43
Interesa nga letrat me vlerë	14	4	14	4	24
Gjoba dhe komisione	6	5	6	5	41
Të tjera	4	-9	3	3	52
Të ardhura	40	16	40	24	38
Interesa paguar klientëve	5	1	5	1	16
Shpenzime për personelin	10	1	11	1	6
Shpenzime operacionale	15	7	15	7	32
Shpenzime të tjera	3	-6	4	1	16
Shpenzime	33	4	35	9	21
Rezultati financiar	7	11	5	15	75

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në anën e të ardhurave, interesat e arkëtuara nga klientët përfaqësojnë burimin kryesor të të ardhurave si për aktivitetin në lekë, ashtu edhe për atë në valutë, por të ardhurat nga interesat në lekë janë disi më të larta nga ato në valutë për shkak të diferencës pozitive të normave të interesit midis monedhës vendase dhe monedhave të huaja. Të ardhurat nga gjobat dhe komisionet për lekun dhe për valutën kanë vlera të krahasueshme dhe nuk kanë shënuar ndryshime përgjatë periudhës 2018 - 2019. Investimet në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare përfaqësojnë një burim të vazhdueshëm dhe të konsiderueshëm fitimi për sektorin bankar dhe të ardhurat nga ky investim në lekë, janë dukshëm më të larta nga të ardhurat nga interesat në letra me vlerë të emetuara nga subjekte rezidente ose jorezidente të denominuara në monedhë të huaj.

Grafik 52. Struktura e të ardhurave në lekë dhe valutë sipas zërave kryesorë (viti 2019)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Diferenca midis shpenzimeve për interesa paguar klientëve në lekë dhe në valutë është e krahasueshme me diferencën përkatëse në të ardhurat e mbledhura nga interesat nga klientët (rreth 4 miliardë lekë). Por ndërkohë që për aktivitetin në lekë, raporti interesa të paguara ndaj interesave të marra nga klientët është rreth 30%, për aktivitetin në valutë ky raport është më pak se 10%. Kjo ecuri tregon që eficienca e sektorit bankar në ndërmjetësimin financiar në valutë është më e lartë në krahasim me ndërmjetësimin financiar në monedhën vendase. Në të njëjtën kohë, shpenzimet për personelin dhe shpenzimet operacionale ndaj totalit të të ardhurave vlerësohen në rreth 30% për aktivitetin në valutë dhe në mbi 65% për aktivitetin në lekë. Kjo diferencë shpjegohet me faktin që pagat dhe shpenzimet e tjera operacionale të bankave në lekë janë shumë më të larta sesa ato që kryhen në valutë. Nga ana tjetër, aktiviteti në valutë karakterizohet nga një shkallë më e lartë paparashikueshmërie e lidhur me efektin e kursit të këmbimit në investimet në mjete financiare dhe me ecurinë e provigjioneve për investimet në instrumente financiare dhe në kredi, veçanërisht në kushtet kur kredia e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit vijon të zërë një vend të rëndësishëm në tepricën e kredisë në valutë dhe të kredisë së përgjithshme të dhënë nga sektori bankar.

Grafik 53. Të ardhurat dhe shpenzimet totale dhe për interesat sipas valutave (viti 2019)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, zgjerimi i tepricës së kredisë, u ndikua kryesisht nga rritja e kredisë së re. Në terma vjetorë, rritja e kredisë do të ishte më e lartë nëse do të përjashtohej efekti i kursit të këmbimit dhe i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave.

4.1.1.3 Kredia

Në fund të periudhës, teprica e kredisë së sektorit bankar u zgjerua në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, përkatësisht me 2.5% dhe me 4.8%, duke u ngjitur në nivelin prej rreth 576 miliardë lekë[26]. Ecuria e kredisë u ndikua kryesisht nga rritja e fluksit të kredisë së re. Zhvillime pozitive janë vënë re edhe në cilësinë e portofolit, ku stoku i kredive me probleme në bilancet e bankave ra ndjeshëm gjatë periudhës.[27] Ecuria më e mirë është regjistruar për kredinë me maturitet afatgjatë, kredinë në monedhën vendase dhe për bizneset, ndërkohë që kredia në valutë ka vijuar të tkurret. Edhe në zhvillimet vjetore të kredisë, ndikimin kryesor në rritjen e saj e dhanë zgjerimi në klasat performuese të kredisë për bizneset, kredisë në lekë dhe asaj me maturitet afatgjatë.

Tabelë 8. Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës

		Vlera (mld lekë)	Pesha ndaj totalit të kredisë (%)		Ndryshimi (%)	
	Periudha	12/2019	12/2018	12/2019	Gjashtëmujor	Vjetor
Sipas monedhës	Kredi në Lek	281	46	49	6.5	10.0
	Kredi në valutë	295	54	51	-1.1	0.3
Sipas subjektit	Sektori publik	30	5	5	9.1	8.7
	Biznese	359	63	62	1.7	3.7
	Individë	187	32	32	3.0	6.5
Sipas afatit	Afatshkurtër	163	29	28	2.0	2.2
	Afatmesme	95	17	17	0.4	-0.9
	Afatgjatë	317	53	55	3.4	8.1
	Stoku i kredisë	576	100	100	2.5	4.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

[26] *Ritmet pozitive të rritjes së tepricës së kredisë janë llogaritur duke përjashtuar efektin statistikor të thyerjes strukturore në sektorin bankar.*

[27] *Për një informacion më të detajuar, lutem referojuni analizës mbi rrezikun e kredisë në seksionin përkatës.*

Grafik 54. Ndryshimi 6-mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 55. Ecuria e kredisë sipas sektorëve, kontribut në pp, ndryshime gjashtëmujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbiçmimi i lehtë i lekut ka dhënë një efekt pakësues prej rreth 3.4 miliardë lekësh në kundërvlerën në lekë të kredisë në valutë gjatë vitit. Kontributi kryesor në këtë efekt pakësues ka ardhur nga mbiçmimi i lekut ndaj euros. Në përgjithësi, në terma vjetorë[28], vlerësohet që efekti pakësues i mbiçmimit të lekut për kredinë në valutë dhe për kredinë në total ka qenë përkatësisht 1.1 p.p dhe 0.5 p.p.

Grafik 56. Ecuria e kredisë totale pa efektin e kursit dhe fshirjeve (majtas) dhe e kredisë në valutë pa efektin e kursit (djathtas), ndryshime vjetore, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, bankat kanë vijuar procesin e largimit të kredive të humbura nga bilancet. Ndryshimet rregullative të miratuara gjatë vitit 2019, ndikuan në rritjen e fluksit të fshirjeve, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019. Vlera e kredive të fshira gjatë 12 muajve të fundit ishte 8.4 miliardë lekë, ku 7.4 miliardë lekë u realizuan gjatë gjysmës së dytë të vitit. Stoku i kredive të fshira

[28] *Përjashtuar efektin statistikor të ndryshimit strukturor në sektorin bankar.*

gjatë vitit 2019, përbën rreth 17% të tepricës së përgjithshme të kredive me probleme të raportuar nga bankat në fund të dhjetorit 2019. Nëse këto fshirje nuk do të ishin realizuar gjatë vitit, rritja vjetore e stokut të kredisë do të ishte 6.4% (nga 4.8%). Duke përjashtuar njëkohësisht efektin e kursit të këmbimit dhe atë të fshirjeve, rritja vjetore e kredisë do të regjistronte vlerën prej 6.9%.

Zgjerimi i kredisë për rezidentët erdhi me kontribut të përbashkët nga kredia për individët dhe bizneset, kryesisht në monedhën vendase. Bizneset rezidente, që zënë dhe peshën kryesore në portofol, raportojnë zgjerim të kredisë për herë të parë që prej vitit 2014. Kredia duket se është drejtuar tek sektorët me performancë më të mirë.

KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – BIZNESI

Kredia për subjektet rezidente u zgjerua me 3% gjatë periudhës. Kjo kredi zë rreth 96% të totalit të kredisë. Mbi 60% e kredisë për subjektet rezidente mbahet nga sektori i biznesit. Kredia për këtë sektor është zgjeruar me rreth 8 miliardë lekë dhe në fund të periudhës arriti në rreth 336 miliardë lekë. Rritja në këtë kategori ka ardhur nga rritja në kredinë për pasuri të paluajtshme dhe kredinë për qëllime afatshkurtra (siç janë kredia për kapital qarkullues dhe ajo overdraft). Kredia për investime në pasuri të paluajtshme zë peshën kryesore (rreth 27%) të tepricës së kredisë për bizneset, dhe gjatë periudhës është zgjeruar me 5%.

Grafik 57. Ecuria e kredisë për bizneset rezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përgjatë vitit, kredia për bizneset rezidente u zgjerua me 5.7%. Ky është viti i parë, që prej vitit 2014, gjatë të cilit bizneset raportojnë rritje vjetore të stokut të kredisë. Kontributin në këtë ecuri pozitive e dhanë zgjerimi i shpejtë i kredisë për investime në pasuri të paluajtshme (+14%) dhe i asaj për kapital qarkullues (+37%). Gjatë vitit 2019, sektori bankar dha rreth 50% më shumë kredi të re për investime në pasuri të paluajtshme krahasuar me një vit më parë, dhe kjo rritje ka dhënë ndikimin kryesor në ndryshimin vjetor të stokut të kredisë për këtë kategori.

Gjatë viteve të fundit janë vërejtur ndryshime në strukturën e kredisë për bizneset. Për kreditë për qëllime "overdraft-i" dhe "blerje pajisjesh", është vënë re një zhvendosje e kredisë nga monedha e huaj, në atë vendase29. Njëherazi, peshat e kredive "overdraft" dhe "blerje pajisjesh" në totalin e kredisë për bizneset, kanë ardhur në rënie. Këto kredi zënë përkatësisht 25% dhe 26% të kredisë për bizneset, nga 28% dhe 30% që shënonin dy vite më parë. Ndërkohë, peshat e kredive për "kapital qarkullues" dhe për "pasuri të paluajtshme" janë rritur gjatë dy viteve të fundit, ndikuar nga rritja me rreth 10% dhe 6% e portofoleve në valutë.

[29] *Ndikuar nga tkurrja e shpejtë e kredisë në monedhë të huaj.*

Grafik 58. Ecuria vjetore e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës, (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e kredisë sipas madhësisë së aktivitetit, evidenton një rritje në peshën e biznesit të mesëm, përkundër rënies në peshën e biznesit të vogël. Biznesi i madh nuk regjistron ndryshime thelbësore[30]. Ndërkohë, analiza sipas afatit tregon se biznesi i mesëm dhe ai i madh kanë rritur peshën e kredisë afatshkurtër, ndërsa biznesi i vogël ka zgjeruar lehtë kredinë afatgjatë[31].

Grafik 59. Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

30 *Këto vlera shënonin përkatësisht: 50.8% (Biznesi i madh); 23.0% (Biznesi i mesëm) dhe 26.2% (Biznesi i vogël) në dhjetor 2018; ndërsa në qershor 2019, ato ishin përkatësisht: 51.9%; 23.1%; dhe 25.0%.*

31 *Në terma vjetorë, biznesi i vogël ka rritur peshën e kredisë afatmesme dhe afatgjatë, ndërsa biznesi i mesëm dhe ai i madh kanë rritur peshën e kredisë afatshkurtër.*

HAPËSIRË INFORMUESE 6. STRUKTURA DHE EFICIENCA E KREDISË SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

Kredia e dhënë nga bankat për bizneset vendase përfaqëson një pjesë të rëndësishme të portofolit të përgjithshëm të kredisë, edhe pse pesha e saj ka rënë nga mbi 80% në vitin 2002 në rreth 60% në fund të vitit 2019. Vitet 2003-2006 u karakterizuan nga një rritje shumë e shpejtë në portofolin e kredisë për bizneset vendase. Ecuria pozitive, edhe pse me ritme më të ulëta, vijoi deri në fund të vitit 2013. Më tej, ecuria e kredisë për bizneset paraqitet negative (me tkurrje) për gjashtë vite radhazi. Ndërsa vitin e fundit, vërejmë rimëkëmbje të kësaj kredie, ku rritja vjetore regjistroi nivelin 5.8%, në dhjetor 2019.

Grafik 60. Ecuria vjetore e kredisë për bizneset vendase



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktualisht, kredia për bizneset vendase zë peshë relativisht të ulët në prodhimin e brendshëm bruto (rreth 20%), krahasuar me vendet e BE-së. Pothuajse gjysma e borxhit të ndërmarrjeve është në formën e kredisë nga sektori bankar. Pjesa tjetër financohet nga letrat me vlerë të ndërmarrjeve dhe kredi nga burime të tjera. Politikat akomoduese të ndërmarra nga bankat qendrore, të cilat kanë ndikuar në rënien e normave të interesit për kredinë, duket të kenë dhënë efekt edhe në kredimarrjen e bizneseve dy vitet e fundit. Pesha e kredisë së marrë nga bankat, në totalin e borxhit të ndërmarrjeve, është rritur në nivelin 48% në dhjetor 2019 (nga 45% në vitin 2017). Rënia e shpejtë në raportin kredi/investime për bizneset që prej vitit 2010, reflekton rritjen relativisht më të shpejtë të investimeve në krahasim me rritjen e kredisë. Gjatë kësaj periudhe, bizneset kanë zgjeruar në mënyrë të ndjeshme investimet e tyre, duke ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit. Gjatë vitit 2019, raporti kredi/investime është rritur si pasojë e rritjes vjetore të kredisë për bizneset vendase. Huatë për bizneset vendase janë sa një e pesta e totalit të aktiveve të sektorit bankar. Pavarësisht rritjes së regjistruar gjatë vitit 2019, pesha e kredisë për bizneset ndaj totalit të aktiveve, mbetet larg nivelit maksimal prej 35% të regjistruar në vitin 2010.

Grafik 61. Kredia për bizneset vendase 2002-2019



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Analiza në vijim trajton performancën e sektorëve të prodhimit të matur sipas disa treguesve makroekonomikë për vitet 2018-2019, si dhe ecurinë dhe cilësinë e kredisë bankare, duke u fokusuar në lidhjen midis produktivitetit sektorial dhe eficiencës së kredisë. Në analizë trajtohen gjithashtu karakteristikat e rrezikut të sektorëve huamarrës dhe ndikimi i huamarrësve me potencial të lartë rreziku në ecurinë e përgjithshme të kredisë.

Në zgjerimin vjetor të kredisë për bizneset, gjatë vitit 2019, vërehet mbizotërimi i sektorit të energjisë. Ndërkohë që ky sektor është përgjegjës për rreth 40% të zgjerimit prej 18 miliardë lekësh në kredinë për bizneset gjatë vitit, kontributi i tij në rritjen ekonomike ishte negativ. Edhe pse duket sikur rritja e kredisë nuk është shoqëruar me rritje të prodhimit në këtë sektor, vlen të theksohet se një pjesë e konsiderueshme e kredisë së re për sektorin gjatë vitit, është dhënë për qëllime investimi dhe ndikimi i kredisë për investime në rritjen ekonomike materializohet pas një periudhe më të gjatë kohore në krahasim me kredinë për kapital qarkullues apo për blerje pajisjesh. Në tërësi, sektori i energjisë paraqet nivel të ulët të rrezikut që buron nga kredia, intensitet të ulët të kredisë dhe një nivel përfitueshmërie dukshëm mbi mesataren e sektorëve të tjerë. Raporti i kredive me probleme për këtë sektor është rreth 6%, duke qenë sa rreth ½ e raportit të kredive me probleme për bizneset (11.3%). Nga ana tjetër, vetëm 36% e investimeve të sektorit të energjisë janë financuar nëpërmjet kredisë bankare.*

Sektorë të cilët kontribuan në rritjen vjetore të kredisë dhe, në të njëjtën kohë, dhanë kontribut pozitiv në rritjen ekonomike gjatë vitit 2019 janë: shërbimet, tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor.

Tregtia mban peshën kryesore në totalin e kredisë dhënë bizneseve dhe kontributi i saj në rritjen vjetore të kredisë ishte i moderuar (rreth 7%). Ky sektor dha, në të njëjtën kohë, kontributin kryesor në rritjen vjetore të PBB-së (rreth 30%), dhe karakterizohet nga intensitet i lartë i kredisë, produktivitet i lartë, përfitueshmëri nën mesataren e sektorëve të tjerë dhe rrezik të moderuar dhe në rënie të vazhdueshme të portofolit të kredisë.

Rreth 60% e shtesës vjetore në kredinë për bizneset lidhet me sektorë të ekonomisë, për të cilët produktiviteti (raporti "shitje neto ndaj numrit të punonjësve") është më i lartë, krahasuar me sektorët e tjerë. Një tregues i rëndësishëm, i cili ka korrelacion pozitiv me aftësinë e një kompanie për të shlyer detyrimet, është përfitueshmëria. Treguesit e përfitueshmërisë së bizneseve janë pesha që zë fitimi në xhiron vjetore të kompanisë dhe pesha që zë fitimi në borxh. Mbi 90% e rritjes vjetore të kredisë, është kontribut i sektorëve që raportojnë nivelet më të larta të përfitueshmërisë. Në përgjithësi, kreditimi i sektorëve me përfitueshmëri të lartë ofron mbështetje si për rritjen ekonomike, ashtu edhe për stabilitetin financiar, falë mbështetjes së agjentëve ekonomikë me kapacitete të mira paguese.

Së fundi, analizojmë treguesin kryesor të lidhur drejtpërdrejt me rrezikun e kredisë. Cilësia e kredisë është përmirësuar për tetë prej dhjetë sektorëve të ekonomisë dhe niveli i përgjithshëm i raportit të kredive me probleme (RKP) ra në nivelin 11.3%, nga 15.7% një vit më parë. Sektorët me nivel të RKP-së mbi atë mesatar, dhanë kontribut të vogël në rritjen vjetore të kredisë gjatë vitit 2019. Industria përpunuese është sektori me nivelin më të lartë të raportit të kredive me probleme. Megjithatë, cilësia e kredisë për këtë sektor është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të fundit. Në të njëjtën kohë, ky sektor karakterizohet nga niveli i lartë i përfitueshmërisë.

Tabelë 9. Ecuria e kredisë për bizneset dhe treguesit ekonomikë sipas sektorëve të prodhimit

	Kredi për biznese			Vlera e shtuar		Intensiteti i kredisë*	Perfitueshmëria*		Produktiviteti*	Treguesi i rrezikut te kredisë		
	rritja vjetore 2018-2019 (ne %)	kontributi në rritjen vjetore të kredisë për bizneset (2019)	pesha në kredinë totale të bizneseve, në % (2019)	rritja reale vjetore, në % (09/2018-09/2019)	kontributi në rritjen vjetore	kredi ndaj investimeve (ne %)	fitimi ndaj shitjeve neto (në %)	fitim ndaj borxhit (në %)	shitje neto ndaj numrit të punonjësve	pesha e kredive të humbura në tepricën e kredive me probleme	ndryshimi vjetor i kredive me probleme (%)	RKP % (2019)
Bujqësi, pyje dhe peshkim	(10.2)	(0.2)	1.5	1.2	0.3	n/a	n/a	n/a	n/a	45.8	(29.4)	5.3
Industria nxjerrëse	18.9	0.5	3.0	(0.3)	(0.0)	46	14	123	6.7	3.6	(13.6)	2.3
Industria përpunuese	(5.3)	(0.8)	14.4	5.0	0.4	152	9	44	2.4	19.5	(7.8)	21.3
Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull, ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave	38.4	2.4	8.3	(1.9)	(0.1)	36	13	100	7.0	42.3	(33.5)	5.8
Ndërtimi	(0.8)	(0.1)	13.5	1.4	0.2	117	11	60	5.7	24.4	(45.8)	9.5
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve	1.0	0.4	35.6	5.2	0.6	268	6	46	7.9	44.6	(23.5)	12.5
Transporti dhe magazinimi	63.5	1.2	2.8	5.2	0.2	38	10	267	4.1	19.0	31.6	6.4
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	17.8	0.8	4.8	5.2	0.1	178	7	31	1.1	30.9	10.5	17.0
Të tjera (shërbime)	10.9	1.7	16.0	3.5	1.3	199	12	59	2.1	30.1	(43.6)	5.4
Të gjitha industritë së bashku	5.8	5.8	100.0	3.1	3.1	133	8	58	4.2	32.7	(23.9)	11.3

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.
**Llogaritjet janë bërë me të dhënat e fundit të vitit 2018.*

Si konkluzion, gjatë vitit 2019, bankat kredituan më së shumti sektorët e ekonomisë me përfitueshmëri më të lartë, produktivitet të lartë dhe nivel të ulët të raportit të kredive me probleme. Njëkohësisht, sektorët e ekonomisë të cilët u kredituan më së shumti si: energjia, industria nxjerrëse dhe transporti, raportojnë nivelet më të larta të investimeve në raport me vlerën e kredisë. Kjo lidhet ngushtë me një eficiencë në rritje të financimit të ekonomisë nga sektori bankar vitin e fundit.

** Të dhënat i referohen rritjes vjetore deri në T3-2019.*

KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – INDIVIDËT DHE SEKTORI PUBLIK

Kredia për individët rezidentë u zgjerua me 3% gjatë periudhës dhe me 6.5% kundrejt një viti më parë, ku kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë rritja e kredisë në lekë, kredia për pasuri të paluajtshme dhe kredia për konsum të mallrave jo të qëndrueshme. Këto dy të fundit, zënë përkatësisht 63% dhe 17% të kredisë për individët. Teprica e kredisë për pasuri të paluajtshme u rrit me rreth 3.6% dhe arriti në 117 miliardë lekë. Gjatë periudhës 2015-2018 është vënë re rritje e vazhdueshme e kredisë për individët nga njëra anë, dhe rënie e kredisë për bizneset nga ana tjetër. Kjo ecuri ka sjellë ndryshime në strukturën e kredisë sipas sektorëve, në favor të kredisë për individët. Kredia për individët, në dhjetor 2019, zinte 34% të tepricës së kredisë, nga 27% në vitin 2015.

Grafik 62. Ecuria e kredisë për individët rezidentë sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për sektorin publik zë një peshë shumë të ulët në totalin e kredive (5%), kundrejt peshës së lartë të kredisë për sektorin privat (biznes dhe individë). Megjithatë, vitin e fundit është vënë re një zgjerim me rreth 9% në stokun e kredive për këtë sektor.

KREDIA PËR SUBJEKTET JOREZIDENTE

Gjatë periudhës, kredia për subjektet jorezidente ka shënuar rënie. Në dhjetor 2019, kredia për jorezidentët ishte rreth 23 miliardë lekë dhe zinte 4% të tepricës së kredisë së sektorit bankar, nga 4.5% në fund të gjashtëmujorit paraardhës. Sipas sektorit, afatit dhe monedhës, rënia më e madhe është regjistruar në kredinë për bizneset, kredinë në monedhë të huaj dhe kredinë afatmesme, të cilat janë kategoritë me peshën më të madhe në stokun e kredisë për subjektet jorezidente.

Grafik 63. Kredia për rezidentët dhe jorezidentët (majtas); dhe kredia për jorezidentët sipas afatit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

Pavarësisht tkurrjes për të tretin gjashtëmujor radhazi në vlerat e kredisë së pambrojtur në valutë, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, kërkon monitorim të vazhdueshëm.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, i pasqyruar në peshën e kredisë në valutë të pambrojtur nga ndryshimet e pafavorshme në kursin e këmbimit (kredia e pambrojtur në valutë), vijon të mbetet në nivele relativisht të larta, dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm. Kredia e pambrojtur në valutë ra me 3% gjatë periudhës dhe ka vijuar të tkurret për të tretin gjashtëmujor radhazi. Rënia vjetore ishte 5% dhe tkurrja është regjistruar në kredinë e pambrojtur për bizneset dhe për sektorin e qeverisë. Ndërkohë, individët raportojnë zgjerim të lehtë në stokun e kredive të pambrojtura në valutë gjatë vitit. Pesha e kredisë së pambrojtur ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë është tkurrur lehtë gjatë periudhës, me 1.4 p.p, në nivelin 23%, ndërsa pesha e saj ndaj portofolit të kredisë në valutë zbriti me 1 pp, në 45%.

HAPËSIRË INFORMUESE 7. SEKTORI BANKAR DHE KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

*Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, kredia e pambrojtur në valutë ra me 5 miliardë lekë, në nivelin 132 miliardë lekë, kryesisht për shkak të tkurrjes së kredisë së pambrojtur në monedhën evropiane*4 (me 4.6%), ndërkohë që kredia e pambrojtur në USD ka regjistruar rritje të lehtë.*

Kredia për bizneset përbën 68% të tepricës së kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndërsa kredia për individët dhe ajo për qeverinë zënë përkatësisht 28% dhe 4%. Tkurrja e tepricës së kredisë së pambrojtur lidhet me rënien me 7% të kredisë së pambrojtur për bizneset. Kredia e pambrojtur për individët gjatë periudhës shënoi rritje me rreth 7%, ndërsa ajo për qeverinë mbeti e pandryshuar. Në terma vjetorë, kredia e pambrojtur në valutë u tkurr me 5.3%, si pasojë e rënies në kredinë për bizneset dhe në kredinë në monedhën Euro.

Grafik 64. Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 65. Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas qëllimit të përdorimit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas qëllimit të përdorimit, kredia e pambrojtur e dhënë për investime në pasuri të paluajtshme vijon të mbajë peshën kryesore (rreth 51%) të totalit të kredisë së pambrojtur në valutë, pasuar nga kredia për tregti (me 29%). Pjesa tjetër e kredisë së pambrojtur në valutë është dhënë për zhvillim biznesi, konsum dhe qëllime të tjera. Kontributin kryesor në ecurinë e tepricës së kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit gjatë periudhës e dhanë rënia e kredisë së pambrojtur për "investime në pasuri të paluajtshme" dhe për "zhvillim biznesi", të cilat ranë me 7% dhe 16%. Kredia e pambrojtur në valutë për "tregti" ishte e vetmja kategori e kredisë së pambrojtur që shënoi rritje gjatë periudhës, me 8%.

Grafik 66. Ecuria gjashtëmujore e kredisë së pambrojtur në valutë (kontributi sipas sektorëve)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 67. Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme është dhënë për blerje të pasurive të paluajtshme rezidenciale, atyre tregtare dhe për blerje toke. Peshën kryesore të saj e zë kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme rezidenciale dhënë individëve (46%), e cila u zgjerua lehtë gjatë periudhës.

Kredia për pasuri të paluajtshme rezidenciale dhënë bizneseve dhe ajo për pasuri të paluajtshme tregtare kanë shënuar rënie gjatë gjysmës së dytë të vitit, duke ndikuar në pothuajse të njëjtën masë rënien e tepricës së kredisë së pambrojtur për periudhën. Mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ka dhënë një efekt negativ jo material në vlerën e raportuar të kredisë së pambrojtur në valutë. Në mungesë të mbiçmimit të kursit të këmbimit të monedhës vendase, kredia e pambrojtur në valutë do të ishte tkurrur me 2.9% nga 3.4% gjatë periudhës.

* *Teprica e kredisë në euro për të cilën të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, zë 87% të tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë.*

KREDIA E RE

Në rritjen e kredisë së re ka kontribuar kryesisht kredia për bizneset, dhe brenda saj, ajo me afat të gjatë. Kredia e re u zgjerua për të tri monedhat kryesore, por preferenca e kredisë dhënë individëve ka qenë në Lek.

Kredia e re e dhënë gjatë periudhës shënoi rreth 130 miliardë lekë, duke u rritur me gati 12% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, por duke qenë rreth 3% më e ulët se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zgjerimi në fluksin e kredisë së re gjatë periudhës ka ardhur kryesisht nga rritja e kredisë për sektorin e bizneseve (rreth 14%), brenda të cilës ndikimin kryesor e dha rritja e kredisë afatgjatë. Për sektorin e individëve, kredia e re u zgjerua me 7% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Ritmi më i ulët i rritjes së saj krahasuar me kredinë për bizneset dhe pesha e ulët ndaj totalit të kredisë, bënë që dhe kontributi i saj në ecurinë e kredisë së re të ishte i ulët. Kredia e re për individët shkoi kryesisht për blerje banesash. Sipas monedhës, kredia e re ka shënuar zgjerim për të tri monedhat kryesore. Rreth 60% e vlerës së kredisë së re ishte në Lek.

Grafik 68. Kredia e re për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës[32] shënoi rënie në nivelin 5.5%, dhe rënia është regjistruar për të gjitha llojet e kredisë. Norma mesatare e peshuar e kredive të reja gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit ishte rreth 0.2 pp më e ulët sesa ajo e regjistruar në gjysmën e parë të vitit. Rënia më e fortë në normën mesatare të interesit është regjistruar në normat e interesit për kredinë e re në Usd dhe në ato për kredinë e re për bizneset.

Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja regjistron një prirje rënëse gjatë vitit.

Sipas grupeve të kredive, norma e interesit për kredinë e re në Lek dhe kredinë e re për individë, shfaqin nivelet më të larta.

Të klasifikuara sipas monedhës, norma e interesit për kreditë e reja në Lek vijon të shënojë nivele më të larta se dy monedhat e tjera (Euro dhe Usd), por kjo normë interesi ka shfaqur një prirje të dallueshme rënëse gjatë gjithë vitit. Në dhjetor 2019, norma e interesit të kredive të reja në lek shënoi 6.4%, nga 6.9% në fillim të vitit. Norma e interesit për kredinë e re për individët vijon të mbetet më e lartë në krahasim me atë të kredisë për bizneset. Në dhjetor 2019, kjo normë shënoi nivelin më të lartë të regjistruar gjatë vitit me rreth 6.3%, ndikuar nga ecuria e normës së interesit për kreditë konsumatore. Norma mesatare e kredive të reja për sektorin e biznesit ka vijuar të luhatet rreth një vlere mesatare prej 5% gjatë gjithë vitit.

Grafik 69. Ecuria e normës së peshuar të interesit për kreditë e reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[32] *E llogaritur si mesatare gjashtëmujore.*

Grafik 70. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas monedhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 71. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas subjektit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.1.4 Depozitat

Rritja e depozitave ka qenë e fortë gjatë periudhës, e mbështetur kryesisht nga depozitat pa afat, për individët dhe në valutë. Pesha e depozitave pa afat është zgjeruar.

Në fund të vitit 2019, niveli i depozitave në sektorin bankar shënoi 1,193 miliardë lekë, me një rritje prej 50 miliardë lekësh (ose 4.1%) gjatë periudhës dhe 60 miliardë lekësh (ose 5.4%) kundrejt një viti më parë[33]. Rritja më e fortë e depozitave gjatë periudhës, por edhe në tërësi gjatë vitit, është mbështetur nga rritja e depozitave pa afat dhe llogarive rrjedhëse, rritja e depozitave të individëve dhe rritja e depozitave në valutë. Rritja në depozitat në lekë ka vijuar, por ritmi i rritjes së tyre ishte më i ulët në krahasim me depozitat në valutë. Efekti statistikor i kursit të këmbimit gjatë gjysmës së dytë të vitit ka qenë negativ por në nivele mjaft të ulëta.

Tabelë 10. Të dhëna mbi ecurinë e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës

		Mld lekë	% ndaj totalit	Ndryshimi në %		Kontributi në normën e rritjes (p.p.)	
		12/19	12/19	Gjashtë-mujor	Vjetor	Gjashtë-mujor	Vjetor
Sipas afatit	Llogari rrjedhëse	412	35	6.6	8.2	2.2	2.8
	Depozita pa afat	149	13	15.1	25.9	1.7	2.7
	Depozita me afat	614	51	0.2	(0.3)	0.1	(0.2)
Sipas subjektit	Sektori publik	27	2	3.9	13.8	0.1	0.3
	Biznese	163	14	4.6	4.0	0.6	0.5
	Individë	1,003	84	4.1	5.4	3.4	4.5
Sipas monedhës	Depozita në Lek	579	49	3.1	5.1	1.5	2.5
	Depozita në valutë	614	51	5.2	5.6	2.6	2.9
	Stoku i depozitave	1,193	100	4.1	5.4	4.1	5.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

[33] *Vlera e depozitave ka përjashtuar efektin e thyerjes strukturore.*

Grafik 72. Ecuria e depozitave sipas afatit (në mld lekë, majtas) dhe kontributi në ndryshimin vjetor (në pp, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019, depozitat pa afat dhe llogaritë rrjedhëse kanë dhënë kontribut pozitiv në ecurinë e depozitave, ndërsa depozitat me afat kanë vijuar të regjistrojnë norma negative ndryshimesh vjetore. Depozitat pa afat dhe llogaritë rrjedhëse u zgjeruan me përkatësisht 26% dhe 8% në terma vjetorë, ndërkohë që rënia e depozitave me afat ka shfaqur shenja ngadalësimi.

Që nga mesi i vitit 2016, depozitat pa afat të individëve kanë dhënë një kontribut të qëndrueshëm dhe pothuajse konstant (prej 2 p.p.) në rritjen e përgjithshme të depozitave, ndërsa kontributi i llogarive rrjedhëse ka qenë më i madh, por më pak i qëndrueshëm. Në krahasim me pesë vjet më parë, pesha e depozitave me afat ndaj stokut të përgjithshëm të depozitave ka rënë në rreth 50% nga rreth 70%, ndërkohë që llogaritë rrjedhëse kanë rritur peshën e tyre nga 20% në rreth 35% të stokut të përgjithshëm të depozitave.

Grafik 73. Depozita në lekë dhe valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 74. Ndryshimi vjetor i kursit të këmbimit dhe i depozitave në lekë, euro dhe në valuta të tjera



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mjedisi me norma të ulëta interesi vijon të mbështesë preferencën e klientëve për depozita pa afat dhe llogari rrjedhëse ndaj depozitave me afat, dhe kjo preferencë është më e theksuar për kursimet në monedhë të huaj. Depozitat me afat të mbajtura kryesisht nga sektori i individëve kanë peshën kryesore në depozitat në lekë (rreth 60%), por zënë më pak se 45% të depozitave të përgjithshme në valutë. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat të marra së bashku zotërojnë rreth 40% të depozitave në Lek, 54% të depozitave në valutë dhe 47% të totalit të depozitave. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në valutë, të mbajtura kryesisht në monedhën Euro, kanë arritur në 28% të totalit të depozitave.

Sektori i individëve zotëron mbi 80% të depozitave të përgjithshme dhe ka vijuar t'i zgjerojë depozitat e tij në sektorin bankar. Rritja e depozitave të individëve është mbështetur nga zgjerimi i depozitave pa afat në valutë dhe i llogarive rrjedhëse në lekë. Në të njëjtën kohë, depozitat me afat në valutë të individëve, që zënë rreth 23% të totalit të depozitave, kanë vijuar të tkurren në terma vjetorë, por kanë ruajtur një nivel pothuajse të pandryshuar gjatë gjysmës së dytë të vitit.

Grafik 75. Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 76. Përbërja e rritjes së depozitave sipas afatit, sektorëve dhe valutës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat e interesit për depozitat me afat në monedhat Lek dhe Euro shënuan përkatësisht 0.7% dhe 0.1% në fund të vitit dhe u janë rikthyer niveleve të fillimit të periudhës, pas një rritjeje të lehtë gjatë gjashtëmujorit të dytë. Depozitat e reja kanë ruajtur sjelljen sezonale duke shënuar vlerat më të larta gjatë muajit gusht, por për të dyja monedhat vërehet një prirje rënëse në krahasim me ecurinë e raportuar gjatë viteve 2016-2018. Sasia e depozitave të reja me afat të raportuara gjatë vitit 2019 ishte rreth 8% më e vogël në krahasim me depozitat e reja në vitin 2018 dhe rënia më e fortë (rreth 13%) është regjistruar në depozitat e reja me afat në monedhën vendase, ndërkohë që edhe depozitat me afat në Euro ishin rreth 6% më pak në krahasim me fluksin e vitit 2018.

Grafik 77. Flukset dhe norma mesatare e interesit për depozitat e reja me afat në lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 78. Flukset dhe norma mesatare e interesit për depozitat e reja me afat në euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.2 RREZIQET E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT BANKAR

4.1.2.1 Rreziku i kredisë

Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së portofolit të kredisë ishte kontribut i përbashkët i fshirjes, shlyerjes dhe ristrukturimit të kredive me probleme. Përmirësimi i cilësisë së kredisë ishte më i dukshëm në kredinë për biznese, kredinë në valutë dhe kredinë afatgjatë.

Për herë të parë në dekadën e fundit, raporti i kredive me probleme (RKP) ra në nivel njëshifror, duke arritur në 8.4% në dhjetor 2019, nga 11.2% në qershor 2019. Stoku i kredive me probleme u ul në 48 miliardë lekë[34], rreth 24% më pak në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, me kontribut nga fshirja e kredive, shlyerja dhe ristrukturimi i tyre. Fshirja e kredive të humbura nga bilancet e bankave u intensifikua gjatë gjysmës së dytë të vitit[35], ndikuar kryesisht nga ndryshimet rregullative të ndërmarra nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Përmirësimi në cilësinë e kredisë është vërejtur kryesisht në portofolin e kredisë për biznese, kredisë në valutë dhe kredisë me afate më të gjata maturimi. Ecuria në kohë e cilësisë së portofolit të kredisë do të monitorohet në vazhdimësi nga Banka e Shqipërisë, veçanërisht në kushtet e një ndikimi të mundshëm nga pasojat e tërmetit të nëntorit 2019, dhe më tej nga pandemia e koronavirusit.

Gjatë periudhës, përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë u shoqërua edhe me përmirësim të strukturës së kredive me probleme, duke u reflektuar, së bashku, në një mbulim më të ulët të tyre me provigjione. Në fund të vitit, raporti

[34] *Stoku i kredive me probleme që janë shlyer gjatë gjashtëmujorit të dytë është pothuajse dyfishuar, krahasuar me gjysmën e parë të vitit, duke përbërë burimin kryesor të rënies së stokut të kredive me probleme.*

[35] *Gjatë vitit 2019 janë fshirë rreth 8.4 miliardë lekë kredi të humbura, të përfaqësuara kryesisht nga kreditë e bizneseve në valutë. Fluksi i fshirjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave gjatë vitit 2019, është i njëjtë me flukset vjetore të raportuara gjatë dy viteve paraardhëse. Gjithsej, që nga fillimi i procesit të fshirjes (janar 2015), janë fshirë 65 miliardë lekë kredi të humbura.*

i mbulimit me provigjione zbriti ne 59.4% nga përkatësisht 62% që shënonte në muajin qershor 2019.

Grafik 79. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 80. Kontributi në ndryshimin vjetor të stokut të kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 81. Struktura e kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahasuar me një vit më parë, raporti i kredive me probleme ra me 3 p.p dhe rënia reflekton kryesisht tkurrjen në stokun e kredive me probleme. Vitet e fundit është vënë re një zhvendosje e peshës midis klasave të kredive me probleme, nga klasa "e humbur" drejt atyre me rrezik më të ulët. Pesha e kredive të humbura në stokun e kredive me probleme ka rënë në 36%, nga 48% një vit më parë dhe nga 60% në mes të vitit 2017. Kjo ecuri reflekton kryesisht fshirjen e kredive të humbura, shlyerjen e kredive të prapambetura dhe ristrukturimin e një pjese të tyre. Gjatë 12 muajve të fundit, në stokun e kredive me probleme është vënë re një rritje më e shpejtë e peshës së kredive "të dyshimta" me 10 pp, në nivelin 33%.

Për të gjitha ndarjet sipas afatit, subjektit dhe monedhës, është vënë re një përmirësim i konsiderueshëm në cilësinë e aktiveve gjatë vitit 2019. Cilësia e kredisë paraqitet më e dobët për kredinë për bizneset, kredinë në valutë dhe kredinë me afat të mesëm maturimi, megjithatë këto janë edhe ndarjet për të cilat është vënë re rënia më e fortë në stokun e kredive me probleme.

Grafik 82. Raporti i kredive me probleme sipas sektorit, monedhës dhe afatit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për kredinë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit, cilësia është përmirësuar ndjeshëm ndaj një viti më parë dhe gjatë periudhës, me kontribut kryesor nga zvogëlimi i stokut të kredive me probleme. RKP-ja për këtë lloj kredie shënoi 7.6% në fund të periudhës, diktuar kryesisht nga ecuria e kredisë së pambrojtur për blerje pasurish të paluajtshme, në monedhën evropiane.

Sipas qëllimit të përdorimit, gjatë periudhës, RKP-ja u ul:

- për kredinë e pambrojtur të dhënë për blerje pasurish të paluajtshme në 8.7%, nga 12.8%;
- për kredinë për zhvillim biznesi në 8.7%, nga 13%;
- për tregti në 7.2%, nga 10.3%; dhe
- për konsum – e cila ka dhe raportin më të ulët të kredive me probleme – në 4.2%, nga 4.9%.

Grafik 83. RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 84. RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për portofolin e kredisë së dhënë për jorezidentët, i cili është përgjysmuar për shkak të thyerjes strukturore, cilësia e kredisë mbeti e pandryshuar gjatë periudhës dhe raporti i kredive me probleme shënoi nivelin prej 2.6%. Stoku i kredive me probleme për këtë kategori është i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë midis kredive të humbura dhe kredive të dyshimta. Pothuajse i gjithë stoku i kredive me probleme për subjektet jorezidente mbahet nga bizneset dhe këto kredi janë lëvruar në monedhën evropiane.

Gjatë periudhës, masa e mbulimit të kredive me probleme me fonde rezervë ra me 2.6 p.p në 59%, duke reflektuar rënien më të madhe në fondet rezervë në krahasim me rënien në stokun e kredive me probleme. Për shkak të koeficientit të lartë të peshimit, një rënie e caktuar në stokun e kredive të humbura brenda portofolit të kredive me probleme, reflektohet në një rënie më të madhe në stokun e fondeve rezervë për kredinë. Gjatë periudhës, kontributin kryesor në rënien e ndjeshme në stokun e fondeve rezervë e dha tkurrja e konsiderueshme në tepricën e kredive të humbura.

Grafik 85. Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 86. Ndryshimi vjetor i stokut të kredive me probleme dhe RKP për subjektet jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë

Mbulimi me kapital i kredive me probleme neto[36] u zgjerua në 7.3 herë nga 5.9 herë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit. Ky zgjerim reflektoi rënien e shpejtë në kredinë me probleme neto[37]. Në dhjetor 2019, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë shënoi 3.4% duke qenë, rreth 0.9 p.p. më pak sesa raporti i muajit qershor 2019.

Një ndër zhvillimet më pozitive të periudhës ishte rritja e mëtejshme e raportit të mbulimit të kredisë me kolateral. Në fund të dhjetorit 2019, ky tregues shënoi nivelin më të lartë në shtatë vitet e fundit (rreth 80%). Krahasuar me periudhën paraardhëse, raporti i mbulimit me kolateral[38]

[36] *Kreditë me probleme pas zbritjes së provigjioneve.*

[37] *Si rrjedhojë e tkurrjes së tepricës së kredive me probleme neto me gati 18% dhe zgjerimit të kapitalit rregullator me rreth 1.2%, raporti "kredi me probleme neto/kapitalit rregullator" ra në 14% nga 17% që shënonte në qershor 2019.*

[38] *Kolateral në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), para në dorë etj.*

të kredive u zgjerua me rreth 2.7 p.p. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë peshën kryesore, rreth 66% të kredisë së kolateralizuar dhe 53% të tepricës së kredisë. Teprica e kredisë së pakolateralizuar është tkurrur me rreth 10% gjatë periudhës.

Cilësia e kredisë së kolateralizuar e përcaktuar nga ecuria e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme është përmirësuar gjatë periudhës. RKP-ja për kredinë e kolateralizuar shënoi 7.5% në fund të vitit, nga rreth 10.5% një vit më parë. Rënia në stokun e kredive me probleme për kredinë e kolateralizuar ka nisur që prej vitit 2016. Në krahasim me fundin e vitit 2018, raporti i kredive me probleme për kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme tregtare shënoi rënien më të shpejtë, me rreth 5.8 p.p në nivelin 8.1%. Ky është niveli më i ulët i raportuar gjatë dhjetë viteve të fundit. Cilësia e kredisë paraqitet në përmirësim të vazhdueshëm edhe për kreditë e tjera të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, duke regjistruar nivelet më të ulëta të raportit të kredive me probleme që prej vitit 2013. Kredia e kolateralizuar me para në dorë vijon të mbajë nivelin më të ulët të raportit të kredive me probleme (0.5%). Edhe cilësia e kredisë së pakolateralizuar ka shënuar përmirësim në krahasim me fundin e periudhës paraardhëse dhe në krahasim me një vit më parë. Megjithatë, kjo lloj kredie mban nivelin më të lartë të raportit të kredive me probleme (12.4%).

Grafik 87. Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme, sipas llojit të kolateralit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.2.2 Rreziku i likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar ka vijuar të ruajë nivele të mira. Treguesit e likuiditetit në lekë dhe valutë kanë vlera mjaft më të larta në krahasim me nivelet minimale rregullative. Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar mbeten depozitat, të cilat mbulojnë mbi dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në fund të vitit 2019, raporti "hua/depozita" shënoi 48.3%, vlerë kjo lehtësisht më e ulët nga ajo e një viti më parë. Ky raport shënon 48.5%

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar ka vijuar të ruajë nivele të mira dhe mbetet ndjeshëm mbi limitet rregullative. Prania e bollshme e aktiveve likuide zbut sinjalet e rrezikut që vijnë nga vlerat negative në hendekun e maturimit mes aktiveve dhe pasiveve në afatin e shkurtër.

për monedhën vendase dhe 48% për valutën. Raporti "hua/depozita" për monedhën Lek është më i lartë se vlerat e gjashtëmujorit të parë 2019 dhe të vitit të kaluar, ndërsa i njëjti raport për valutën tregon rënie kundrejt të dyja periudhave. Gjatë vitit 2019, kredia në monedhën vendase është rritur me ritëm më të lartë sesa baza e depozitave. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019, kredia në valutë ka shënuar rënie të lehtë, ndërkohë që depozitat në valutë janë zgjeruar me rreth 5%. Këto zhvillime kanë rezultuar në rënien e treguesit në monedhë të huaj nga 51% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, në 48% në fund të vitit.

Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta, duke reflektuar hapësirën që ekziston për rritjen e aktivitetit kreditues. Në fund të muajit dhjetor 2019, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar ishte rreth 36% ose rreth 1 pp më i lartë ndaj fundit të një gjashtëmujori më parë. Kjo ecuri reflekton rritjen më të shpejtë të aktiveve likuide në bilancet e bankave në krahasim me zgjerimin e totalit të aktiveve. Ecuria e raportit të aktiveve likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra shënoi gjithashtu rritje me 2 pp, duke arritur në nivelin 49%. Pavarësisht se bankat po operojnë në kushtet e një likuiditeti të bollshëm, hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur, në raport me totalin e aktiveve në afatin e shkurtër, vijon të mbetet në nivele të larta.

Hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur[39] për periudhën deri në 3 muaj, është ngushtuar lehtë gjatë periudhës. Hendeku i përgjithshëm[40] vijon të jetë pozitiv dhe është ngushtuar gjithashtu, ndaj fundit të muajit qershor 2019, nga 6% në 5% të aktiveve të sektorit bankar.

Grafik 88. Tregues të likuiditetit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 89. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve



Burimi: Banka e Shqipërisë

[39] *I llogaritur si raport i "diferencës midis aktiveve dhe pasiveve/totalit të aktiveve", për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.*

[40] *Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.*

Nga ana tjetër, hendeku mes aktiveve dhe detyrimeve për periudhën 3 muaj – 1 vit, gjatë periudhës, u zgjerua me rreth 30% dhe arriti në 6% të totalit të aktiveve nga 5% gjashtë muaj më parë. Vlerat negative, tregojnë përgjithësisht një karakteristikë të pranuar të veprimtarisë bankare, ku afati mesatar i investimeve (tituj, depozita, kredi) është më i gjatë se afati mesatar i detyrimeve që i financojnë këto investime (depozitat nga publiku). Në rastin e Shqipërisë, prania e aktiveve likuide në vlera të larta, shërben për të zbutur sinjalet që përcjell mospërputhja në bilanc sipas afateve të maturimit.

Grafik 90. Maturimi mesatar i mbetur



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës është vërejtur një zgjerim në diferencën midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve. Në fund të muajit dhjetor 2019, kjo diferencë ishte rreth 21.4 muaj, nga 20.3 muaj në qershor. Maturiteti i mbetur i depozitave, të cilat përfaqësojnë kategorinë më të rëndësishme të detyrimeve, është rritur në 8.3 muaj nga 7.6 muaj. Maturiteti i mbetur i kredisë u rrit gjithashtu në 46.5 muaj nga 45.6 muaj, duke reflektuar dhe prirjen e bankave për të kredituar në periudha më afatgjata. Ndryshe nga gjashtëmujorët e kaluar, sektori bankar nuk raportoi përdorim të linjave të financimit nga grupet zotëruese.

4.1.2.3 Rreziqet e tregut

RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Nivelet e pozicionit të hapur neto në valutë tregojnë për një ekspozim në rritje, por gjithsesi të kufizuar ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilanc të luhatjeve të kursit të këmbimit. Si treguesi i agreguar për të gjitha bankat, ashtu edhe treguesi për grupet e bankave sipas madhësisë, ka vlera shumë më të ulëta në krahasim me vlerën prej 30% të kapitalit rregullator të përcaktuar si kufi i sipërm nga rregullorja përkatëse.

Pozicioni i hapur neto në valutë i sektorit bankar, pavarësisht një prirjeje rritëse, mbetet në nivele të kufizuara dhe ndjeshëm nën limitin rregullativ.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit është zvogëluar, me kontribut kryesor nga grupi i bankave me rëndësi sistemike.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit, pozicioni i hapur në valutë u rrit me rreth 3 pp duke arritur në 7.4% të kapitalit rregullator. Në krahasim me një vit më parë, treguesi ishte rreth 0.3 pp më i ulët. Ecuria e treguesit diktohet nga grupi i bankave sistemike, të cilat kanë ruajtur pozicion të hapur valutor "në blerje". Ky pozicion ishte sa 10% e kapitalit rregullator, një vlerë kjo më e lartë nga niveli prej 7% i fundit të periudhës paraardhëse, por më i ulët nga niveli 11% i fundit të vitit të kaluar. Grupi i bankave të tjera (josistemike) paraqet një ekspozim më të ulët ndaj kursit të këmbimit, me një pozicion neto të hapur valutor "në blerje" më të vogël se 2% e kapitalit rregullator. Gjatë gjysmës së parë të vitit, bankat josistemike regjistruan një pozicion neto "në shitje" sa 3% e kapitalit të tyre rregullator.

Grafik 91. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin dhe grupet



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit është zvogëluar në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Në fund të periudhës, treguesi i mospërputhjes valutore[41] për të gjitha monedhat ishte sa 16% e totalit të aktiveve, nga 17% dhe 18% në fund të gjashtëmujorit të parë 2019 dhe në fund të vitit 2018. Aktivet dhe pasivet në valutë shënuan të njëjtën normë rritjeje (rreth 6%), por ndikimin kryesor në rënien e treguesit e ka dhënë rritja e aktiveve të bankave. Për shkak të peshës së konsiderueshme në bilancin dhe aktivitetin e bankave në krahasim me monedhat e tjera, monedha evropiane ka një kontribut dhe korrelacion shumë më të lartë me indeksin e përgjithshëm. Megjithatë kontributin kryesor në rënien e vlerës së indeksit gjatë periudhës e ka dhënë rënia me 0.5 pp e indeksit për dollarin amerikan në nivelin 0.1%. Indeksi për Euron ra lehtë gjatë periudhës dhe shënoi 16% në fund të vitit. Në fund të vitit të kaluar, vlerat e indekseve për Euron dhe USD ishin përkatësisht 17.5% dhe 0.8%.

Grafik 92. Ecuria e komponentëve të indeksit për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 93. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupeve, në ecurinë e indeksit të mospërputhjes valutore, gjatë periudhës, ka ndikuar rënia në vlerat e indekseve për grupin e bankave sistemike. Grupi i bankave sistemike regjistron vlera më të ulëta të indeksit në krahasim me grupin e bankave josistemike. Në fund të periudhës, indeksi total për bankat sistemike ishte sa 10% e aktiveve të grupit, nga 12% dhe 14% në fund të

[41] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të pasiveve në valutë të sektorit bankar, me aktivet në valutë të netuar me kredinë në valutë për rezidentët. Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Metodologjia e llogaritjes së treguesit të mospërputhjes është publikuar në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

gjashtëmujorit të parë 2019 dhe të fundit të vitit të kaluar. Kontributi kryesor ka ardhur nga rënia e indeksit në monedhën evropiane me 0.7 pp në rreth 11%. Bankat e tjera tregojnë një ekspozim më të lartë ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit. Indeksi i mospërputhjes për këtë grup shënoi 29.1%, duke qenë rreth 0.5 dhe 1.5 pp më i lartë nga niveli i gjashtë muajve dhe një viti më parë. Kontributi kryesor ka ardhur nga rritja në masë të përafërt e indeksit të monedhës evropiane.

Grafik 94. Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 95. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të normës së interesit është rritur gjatë periudhës, por vijon të mbetet i kufizuar. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator të sektorit bankar qëndron në nivele të ulëta, rreth 3%, pranë nivelit të një viti më parë. Diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë interesi të fiksuar (FIR)[42] në fund të periudhës është zhvendosur në kahun pozitiv. Nga ana tjetër, pozicioni neto me normë interesi të ndryshueshme (VIR) shënoi rënie në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, por vijoi të mbajë kahun pozitiv të dy viteve të fundit.

Në kushtet kur pozicioni total neto është pozitiv, pra vëllimi i pretendimeve që arkëtojnë interesa është më i madh se detyrimet për të cilat paguhen interesa, sektori bankar do të ishte i ekspozuar ndaj një rënieje të menjëhershme të normave të interesit. Por, në kushtet kur mbulimi me kapital rregullator i këtyre pozicioneve mbetet i lartë dhe hapësira për ulje të mëtejshme të normave të interesit është objektivisht e kufizuar, kostot që mund t'i vijnë sektorit bankar për shkak të uljes së mëtejshme të normave të interesit, mund të përthithen lehtësisht.

Ndonëse në rritje, ekspozimit i sektorit bankar ndaj rrezikut të normës së interesit mbetet i kufizuar dhe në nivele të ulëta ndaj kapitalit rregullator, dhe është ndjeshëm nën limitin rregullativ.

Gjithsesi, sektori bankar paraqet një ndjeshmëri të shtuar ndaj luhatjeve të mundshme të normës së interesit për pozicionin neto në monedhën vendase dhe atë afatgjatë.

[42] *Pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit klasifikohen në pozicione me normë interesi fikse (FIR) dhe pozicione me normë interesi të ndryshueshme (VIR), sipas afatit dhe sipas monedhave.*

Sipas grupeve të bankave të klasifikuara në bazë të rëndësisë, grupi i bankave të tjera (josistemike) shfaq ekspozim më të lartë krahasuar me grupin e bankave sistemike. Pjesa e dytë e vitit 2019 u karakterizua nga një rritje e ekspozimit të bankave të tjera, pasi treguesi i ekspozimit arriti në nivelin më të lartë të viteve të fundit, rreth 4.5% të kapitalit rregullator. Bankat sistemike kanë zgjeruar ekspozimin e tyre me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, në nivelin prej 2.4% të kapitalit rregullator, por treguesi është në nivel të krahasueshëm me vitin e kaluar. Ecuria e treguesit për sektorin është diktuar nga grupi i bankave sistemike. Këto të fundit kanë ekspozim më të lartë në diferencën midis aktiveve dhe pasiveve me normë të ndryshueshme interesi (VIR) dhe ky pozicion është sa 1% e kapitalit rregullator. Për bankat e tjera, ekspozimi është më i lartë në aktivet dhe pasivet me normë të fiksuar interesi (FIR) dhe ky pozicion shënoi 5.4% të kapitalit rregullator në fund të periudhës.

Grafik 96. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 97. Ecuria sipas grupeve e pozicionit neto të peshuar ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhave, vlera e pozicionit total neto ndaj kapitalit rregullator, është ndikuar nga ngushtimi i pozicionit negativ në monedhën evropiane me 1.5 pp, në nivelin (-0.4%) e kapitalit rregullator. Pozicioni neto në euro ka vlera negative si për grupin e bankave sistemike (-0.2%), ashtu edhe për grupin e bankave të tjera (-0.9%). Ekspozimin më të madh ndaj luhatjes së normave të interesit, të dy grupet bankare e kanë për monedhën vendase, pozicioni në të cilën ishte sa rreth 3% e kapitalit rregullator. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, treguesi ka rënë me 0.5 pp, por qëndroi në të njëjtin nivel me atë të fundit të vitit të kaluar. Pozicioni në dollarë amerikanë është pozitiv për bankat sistemike dhe relativisht i qëndrueshëm në kohë, rreth 1% e kapitalit rregullator. Për grupin e bankave të tjera, ky ekspozim ka vlera shumë të vogla dhe negative.

Sipas afatit të maturimit, vlera e pozicionit total neto ndaj kapitalit rregullator është ndikuar nga zgjerimi i pozicionit për maturitetin afatgjatë. Në fund të periudhës, pozicioni neto i peshuar për maturitetin afatgjatë ishte sa 8% e kapitalit rregullator, në rritje ndaj gjashtëmujorit dhe vitit të kaluar[43]. Kontributin kryesor në këtë zhvillim e dha rritja me 3.7 miliardë lekë e pozicionit neto të peshuar në monedhën evropiane. Maturiteti afatmesëm vijon të mbajë pozicion negativ midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit. Ky tregues ishte sa 5% e kapitalit rregullator në fund të periudhës dhe u zgjerua me rreth 1 pp ndaj gjashtë muajve dhe ndaj një viti më parë. Hendeku afatshkurtër mban nivelin më të ulët të ekspozimit (0.1%) dhe nuk ka paraqitur ndryshime të konsiderueshme gjatë viteve të fundit.

Grafik 98. Hendeku sipas grupeve dhe monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 99. Pozicioni neto i peshuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rreziku i tërthortë ndaj ndryshimit të normave të interesit[44] ka shënuar rritje gjatë periudhës. Norma e peshuar e interesit të kredisë u rrit me 0.3 pp krahasuar me gjashtë muaj më parë, ndërsa norma e peshuar e depozitave nuk shënoi ndryshime të ndjeshme. Në krahasim me vlerën e fundit të gjashtëmujorit të parë të vitit, spread-i i përgjithshëm është zgjeruar me 0.4 pp. Për të tri monedhat është vënë re një zgjerim i spread-it, por kontributin kryesor në zgjerimin e spread-it të përgjithshëm e kanë dhënë normat e interesit në monedhën vendase. Në fund të vitit 2019, diferencat midis normave të interesit të kredive dhe depozitave të reja të sektorit bankar shënuan 5.7 pp për monedhën lek, 4.3 pp për monedhën evropiane dhe 3.4 pikë përqindje për dollarin amerikan.

[43] *Përkatësisht 5.8% dhe 7.2% e kapitalit rregullator.*

[44] *Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit, jep tek klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ tek aftësia paguese e huamarrësve të bankës kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i tërthortë).*

Grafik 100. Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave me afat dhe *spread*-i i normave të interesit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 101. Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në pp



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 8. TREGUES TË PËRQENDRIMIT PËR SEKTORIN BANKAR

Sektori bankar vendas vijon të mbetet një treg konkurrues në drejtim të aktiviteteve kryesore të ndërmjetësimit financiar, që janë pranimi i depozitave dhe dhënia e kredisë. Aktiviteti kreditues ka shkallën më të ulët të përqendrimit në krahasim me të gjitha aktivitetet e tjera të sektorit bankar, dhe treguesi i përqendrimit për këtë aktivitet ka ruajtur nivele të qëndrueshme dhe të ulëta gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të fundit. Treguesi i përqendrimit për tepricën e kredive me probleme regjistron nivele të krahasueshme me treguesin e përqendrimit për kredinë, por ka shfaqur luhatshmëri më të lartë, veçanërisht gjatë periudhës së krizës financiare dhe gjatë periudhave të ristrukturimeve brenda sektorit bankar. Edhe për aktivitetin e pranimit të depozitave sektori bankar paraqet një nivel të mirë konkurrence, por shkalla e përqendrimit është pak më e lartë në krahasim me aktivitetin kreditues, duke mbetur, megjithatë, nën kufirin e poshtëm të zonës që tregon konkurrencë të moderuar (1,500 – 2,500 pikë).

Grafik 102. Treguesi i përqendrimit (HHI) për aktivitetet kryesore të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit për të cilët shkalla e përqendrimit është veçanërisht e lartë janë aktivet dhe pasivet me jorezidentët, ndërsa për aktivitetin e bankave në tregun e letrave me vlerë dhe bonove të thesarit dhe për aktivin në valutë, treguesit e përqendrimit sinjalizojnë konkurrencë të moderuar. Shkalla e përqendrimit të detyrimeve ndaj jorezidentëve ka regjistruar vlera veçanërisht të larta gjatë viteve 2015-2018, por në fund të 2019-ës ka rënë në mënyrë të ndjeshme, duke zbritur në zonën që tregon treg konkurrues. Për aktivin me jorezidentët, që tregon pretendimet e bankave vendase ndaj subjekteve jorezidente (kredi për jorezidentët dhe depozita të mbajtura jashtë) dhe zë rreth 24% të totalit të aktivit, treguesi i përqendrimit mbetet i lartë, por ka rënë ndjeshëm nga viti 2018 në vitin 2019 si pasojë e ndryshimeve strukturore në sektorin bankar.*

Tabelë 11. Tregues të përqendrimit dhe lidhjes midis madhësisë së bankave dhe fitimit

	2015	2016	2017	2018	2019
Koeficienti ρ: Aktive/Rezultati neto	0.67	0.51	0.89	0.81	0.87
Koeficienti i korrelacionit: Aktive/Të ardhura nga interesat	0.99	0.99	0.99	0.99	0.98
Indeksi HHI: Total aktivesh	1,496	1,477	1,465	1,558	1,478
Numri i bankave	16	16	16	14	12

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Një analizë më komplekse e përqendrimit dhe eficiencës së institucioneve financiare trajton korrelacionin midis madhësisë së bankave dhe madhësisë së rezultatit financiar. Në përgjithësi, analizat e Bankës së Shqipërisë gjejnë që shkalla e proporcionalitetit midis shpërndarjes së fitimit dhe shpërndarjes së madhësisë është relativisht e lartë. Kjo do të thotë që në nivele mesatare dhe në kushte normale, fitimet e bankave janë në përpjesëtim të drejtë me madhësinë e tyre. Gjatë periudhës 2015-2019, korrelacioni linear midis peshës së bankave në totalin e aktiveve të sektorit dhe peshës së bankave në rezultatin neto nga interesat ka qenë më i fortë sesa korrelacioni i matur për vitet 2008- 2014. Edhe treguesi i Spearman-it (koeficienti ρ) që mat korrelacionin midis renditjeve për madhësinë e aktivit dhe për rezultatin neto** tregon që lidhja midis madhësisë së bankave dhe fitimit të tyre është pozitive, dhe që kjo lidhje ka qenë veçanërisht e fortë nga viti 2017 e tutje. Në përgjithësi vlerësohet që sektori bankar vendas është konkurrues dhe paraqet përqendrim të ulët për treguesit kryesorë të bilancit dhe aktivitetit. Në të njëjtën kohë, shpërndarja e fitimit midis bankave është në përpjesëtim të drejtë me madhësinë e tyre dhe lidhja midis dy treguesve ka ardhur duke u forcuar me uljen e numrit të bankave dhe konsolidimin e sektorit bankar gjatë 2-3 viteve të fundit.*

Grafik 103. Lidhja midis madhësisë së bankave (aktivi i bankës/aktivet e sektorit, %) dhe të ardhurave neto nga interesat (të ardhura neto nga interesat për bankën/të ardhurat neto nga interesat për sektorin, %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

** Detyrimet ndaj jorezidentëve në fund të vitit 2019 zinin më pak se 3% të detyrimeve të përgjithshme të sektorit bankar.*
*** Sipas një renditjeje ideale, banka e parë për nga madhësia do të ishte banka e parë për nga rezultati financiar, banka e dytë e dyta e kështu me radhë. Formula për llogaritjen e koeficientit ρ mbështetet në shumën e diferencave midis dy renditjeve të ngritura në katror dhe numrit të subjekteve, që në këtë rast është numri i bankave.*

4.1.3 REZISTENCA E SEKTORIT BANKAR

Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar kryhen ushtrimet e provës së rezistencës, që vlerësojnë reagimin e treguesve bazë të veprimtarisë së sektorit bankar ndaj skenarëve të supozuar.

Këtë herë, ushtrimi nuk përmban modelin e mëparshëm të provës së rezistencës, por është fokusuar në vlerësimin e shkallës së ndërlidhjes midis bankave, dhe mes bankave dhe kredimarrësve më të mëdhenj të sektorit, si edhe në analizën e gjendjes së likuiditetit. Ky ndryshim është diktuar nga këta faktorë:

a) për fundin e vitit 2019, rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës vijojnë të tregojnë gjendjen e mirë të kapaciteteve financiare të sektorit bankar për përballimin e rreziqeve. Megjithatë, modeli ekzistues i ushtrimit të provës së rezistencës, i kalibruar ndaj rreziqeve konvencionale, ka nevojë të rishikohet dhe të rikalibrohet në kushtet e një ngjarjeje jokonvencionale, siç po përvijohet pandemia shëndetësore me të cilën po përballet aktualisht bota. Procesi i rikalibrimit të modelit në vetevete ndërlikohet nga fakti që vlerësimi i ndikimit të pandemisë mbi ekonominë, përmban aktualisht shumë të panjohura dhe një shkallë të lartë pasigurie. Për këtë arësye, procesi i rikalibrimit që do të kryhet nga Banka e Shqipërisë për modelet ekzistuese të ushtrimit të provës së rezistencës, do të kërkojë më shumë kohë, në mënyrë që vlerësimet që merren nga ushtrimi të jenë të mbështetura edhe nga gjykimi ekspert.

I njëjti proces është i nevojshëm të kryhet paralelisht edhe nga bankat për modelet apo analizat që ato përdorin në vlerësimin e kapaciteteve të tyre për matjen e rrezikut. Për këtë qëllim dhe duke iu referuar situatës aktuale, është e nevojshme që bankat:

- të rrisin përparësinë dhe frekuencën e realizimit të këtyre ushtrimeve, duke përshtatur natyrën, ashpërsinë dhe kompleksitetin e skenarëve;
- të vlerësojnë përshtatshmërinë e kapaciteteve që zotërojnë, për të përballuar goditjet eventuale që prodhojnë ata skenarë, jo vetëm në afatin e shkurtër por edhe në një afat më të gjatë;
- të sigurojnë një proces vendimmarrjeje sa më të shpejtë dhe efektiv, për t'i fuqizuar këto kapacitete. Fokusi duhet të jetë tek ndërmarrja e veprimeve që jo vetëm ruajnë, por edhe përmirësojnë më tej gjendjen e rezervave të kapitalit dhe të likuiditetit;
- të forcojnë komunikimin me Bankën e Shqipërisë, për analizimin e zhvillimeve dhe të rezultateve.

b) ndërlidhja vlerësohet si element strukturor në veprimtarinë financiare, dhe si i tillë, ajo jep një kontribut të qëndrueshëm në kohë dhe të rëndësishëm në përcjelljen e rrezikut. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka punuar për të ndërtuar modelet dhe vlerësuar shkallën e përhapjes së rreziqeve financiare në sektorin bankar dhe analizën e gjeni në vijim.

Ushtrimi për vlerësimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj goditjeve të likuiditetit kryhet një herë në vit, dhe ka qenë edhe më parë pjesë e raporteve të stabilitetit financiar për fundin e vitit.

4.1.3.1 Rreziku i përhapjes[45] dhe ndërlidhja financiare[46]

Kriza e fundit financiare globale, përveç ndikimit në rang ekonomie lokale, shfaqi dhe dimensionin e saj ndërkufitar. Ajo preku tregjet financiare ndërkombëtare, ku sektori bankar luajti një rol kyç në tejçimin e këtij fenomeni. Ndikimi negativ i këtyre goditjeve u shumëfishua përmes efektit që pati në performancën financiare të bilanceve të bankave - i ashtuquajturi "efekti i bilancit" (balance sheet effect) - duke shkaktuar humbje të konsiderueshme deri në falimentim bankash.

Ky fenomen nxiti një valë kërkimesh për të kuptuar më mirë burimet e rrezikut sistemik dhe përcaktuesit e mundshëm të krizave financiare, të orientuara në dy drejtime. I pari vë theksin mbi identifikimin e rreziqeve që akumulohen me kalimin e kohës dhe që monitorohen nëpërmjet "treguesve paraprirës" (leading indicators). Ndërsa, i dyti heton dimensionin ndërbankar të përhapjes së rreziqeve. Në rastin e krizave bankare, është thelbësore të vlerësohet jo vetëm mekanizmi i transmetimit të goditjeve ekonomike apo financiare, por edhe niveli i cenueshmërisë të sektorit bankar falë ndërlidhjeve të tij financiare, në trajtën e ekspozimeve të ndryshme vendase apo ndërkufitare.

Analiza e ndërlidhjes financiare dhe e rrezikut të përhapjes është pjesë e rëndësishme e stabilitetit financiar të një vendi dhe e vlerësimit të rrezikut sistemik të tij. Duke pasur në vëmendje rolin qendror që luan sektori bankar në ndërmjetësimin e fondeve për ekonominë reale, fokusi ynë është sektori bankar në vend. Ekspozimi i tij ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve - si mbajtës i drejtpërdrejtë apo si ndërmjetës i tyre - vlerësohet nëpërmjet ndërtimit të një "makro-rrjeti"[47]

---

[45] *Rreziku i përhapjes, si një nga llojet e rreziqeve sistemike, përkufizohet si rreziku ku vështirësitë financiare në një bankë të përhapen në banka të tjera, në vetë sistemin financiar apo më gjerë, në ekonominë reale në tërësi.*

[46] *Termi "ndërlidhje financiare" nënkupton në tërësi rrjetin e marrëdhënieve midis agjentëve financiarë, kryesisht në trajtën e ekspozimeve të kreditit, të titujve, të depozitave apo dhe të lidhjeve tregtare e marrëdhënieve të tjera të varësisë mes tyre. Ndërlidhja financiare konsiderohet si një mekanizëm i rëndësishëm në përcjelljen e rrezikut.*

[47] *Ndërtimi i makro-rrjetit është bërë bazuar në metodën Espinosa-Vega dhe Sole, (EVS), 2010. Për më shumë, konsultoni: Espinosa-Vega, Marco A. and Sole, Juan A., "Cross-Border Financial Surveillance: A Network Perspective" (April 2010). IMF Working Papers, Vol. 10/105.*

të ndërlidhjes financiare. Makro-rrjeti paraqet vizualisht një hartë të ekspozimeve në bilancin e bankave dhe drejtimin e përcjelljes së rreziqeve financiare që e shoqërojnë atë.

Më konkretisht, analiza e ndërlidhjes financiare mes bankave në vend dhe mundësisë së përcjelljes së rrezikut, është bërë duke u bazuar në të dhënat e:

- ekspozimeve të drejtpërdrejta në bilanc kundrejt një kampioni prej 5 kredimarrësish - më të mëdhenjtë në terma të kapitalit rregullator në secilën prej bankave individuale, bazuar në të dhënat e bilancit deri në nëntor 2019;
- ekspozimeve të drejtpërdrejta në bilanc të secilës bankë kundrejt gjithë bankave të tjera, bazuar në të dhënat deri në 23 dhjetor 2019.

Makro-rrjeti i mësipërm gjurmon implikimet që burojnë nga një ngjarje stresi në terma të kreditit dhe të financimit, mbi subjektet e përzgjedhura si pjesë e kampionit. Ngjarjet e stresit nga pikëpamja e kreditit analizohen përmes "dështimit" të njësisë ekonomike "A" dhe pasojës që kjo sjell ndaj njësisë ekonomike "B" (dhe subjekteve të tjera të kampionit), e cila ka pretendime kundrejt "A"-së. Ndërkohë, ngjarjet e stresit në terma të financimit analizohen përmes implikimeve të një "dështimi" të njësisë ekonomike "A" dhe si do të ndikojë ajo njësinë ekonomike "B" që ka detyrime ndaj "A"-së, të gjejë burime alternative financimi. Algoritmi gjurmon implikimet e dështimit nëpër disa faza, derisa të mos ketë më ngjarje të tilla.

Grafik 104. Ekspozimet e mëdha dhe ato ndërbankare, 2019



Shënim: Numrat nga 1-12 iu përkasin bankave dhe janë caktuar në mënyrë rastësore. Ndërsa numrat 13-17, pavarësisht se janë shënuar me emrin "banka", iu takojnë pesë kredimarrësve më të mëdhenj jofinanciarë; edhe këta numra janë vendosur në mënyrë rastësore.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

REZULTATET

Matrica në vijim paraqet një tablo të përmbledhur të ekspozimeve të secilës prej bankave të sektorit kundrejt 11 bankave të tjera dhe njëkohësisht ekspozimet në bilanc të secilës bankë kundrejt 5 kredimarrësve më të mëdhenj individualë.

Në makro-rrjetin e mësipërm, ndërlidhjet ndërmjet bankave apo midis bankave dhe kredimarrësve më të mëdhenj paraqiten nëpërmjet vijave me ngjyrë të gjelbër, trashësia e të cilave lidhet me nivelin e ndërlidhjes.
Niveli i ulët i ndërlidhjes reflektohet nga fakti se vetëm disa entitete duket të kenë lidhje relativisht më të forta me të tjerët, ndërkohë që pjesa tjetër e hartës shfaq një nivel ndërlidhjeje relativisht të ulët.

Bankat individuale e ndiejnë goditjen përgjatë fazave të ndryshme, bazuar në supozimin se në rast të një ngjarjeje stresi, humbjet e përjetuara do të

duhet të përthithen vetëm duke prekur kapitalin shtesë mbi minimumin e kërkuar rregullator, pra mbi nivelin minimal prej 12%. Theksojmë se, në terma të kapitalit rregullator, ekspozimet e mëdha dhe ato ndërbankare mbeten relativisht të ulëta.

Grafik 105. Analiza e makro-rrjetit të ekspozimeve dhe procesi i gjurmimit të goditjeve/dështimit

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun e mësipërm supozohen dy skenarë:

a. dështimi i njëkohshëm i 5 kredimarrësve më të mëdhenj. Në këtë skenar ekstrem, dështimi i tyre ndikon në sektorin bankar, përmes ndjeshmërisë më të madhe që paraqet një bankë e sektorit për shkak të ekspozimit të saj ndaj këtyre kredimarrësve. Në këtë rast, kapitali shtesë mbi atë rregullator është më i ulët se totali i ekspozimit të kësaj banke ndaj këtyre kredimarrësve. Në këtë skenar, humbja dhe goditja në kapitalin rregullator materializohen në një fazë të vetme.

b. dështimi i kredimarrësit më të madh. Në rastin e dështimit të këtij kredimarrësi, sërish ndikohet një bankë në kushtet kur ekspozimi i saj ndaj këtij kredimarrësi është i rëndësishëm dhe pesha e këtij ekspozimi në kapitalin shtesë të bankës është e madhe. Në këtë rast, efekti i kësaj goditjeje përcillet në dy faza, duke ndikuar edhe mbi një kredimarrës tjetër për shkak se pretendimet e bankës ndaj këtij kredimarrësi kapërcejnë kapitalin e kompanisë. Për këtë fazë të dytë supozohet që banka, në kushtet e stresit, intensifikon përpjekjet për mbledhjen

e pretendimit që ka ndaj kredimarrësit të dytë dhe ky i fundit e ka të pamundur të gjejë shpejt një bankë tjetër për të rifinancuar detyrimin ndaj bankës së stresuar, duke u detyruar të ristrukturojë veprimtarinë. Ushtrimi tregon që përcjellja e stresit tek kredimarrësit e tjerë, në këtë rast, është e parëndësishme.

Përmbledhja e rezultateve të analizës së makro-rrjetit ilustrohet nëpërmjet dy indekseve, atij të përhapjes dhe atij të ndjeshmërisë. Konkretisht, "indeksi i përhapjes" identifikon ndikimin (në përqindje) mbi kapitalin shtesë të sektorit bankar ose mbi kapitalin aksioner të entiteteve jobankare, në rastin e dështimit të njërit prej entiteteve (bankë ose entitet jobankë); ndërsa, "indeksi i ndjeshmërisë" identifikon masën mesatare në përqindje me të cilën ndikohet kapitali i secilit entitet në rast dështimi të entiteteve të tjera në mënyrë individuale.

Grafik 106. Analiza e përcjelljes së rrezikut (efekti 'kaskadë')



**Indeksi i përhapjes paraqet raportin midis humbjes totale në shtesën e kapitalit të kampionit ndaj totalit të kapitalit të tyre shtesë, pa përfshirë entitetin e dështuar.*

***Indeksi i ndjeshmërisë paraqet mesatarizimin e humbjeve të çdo entiteti në terma të kapitalit shtesë të tij, në rast dështimi të të gjitha entiteteve të tjera në kampion, në mënyrë individuale.*

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga paraqitja grafike, rezulton që indekset e përhapjes dhe të ndjeshmërisë tregojnë përcjellje të rrezikut relativisht të ulët. Aktualisht vlerësohet që banka me indeksin më të lartë të përhapjes (banka 3), shkakton humbjen më të madhe të kapitalit të entiteteve në rast dështimi të saj (16%). Nga ana tjetër, indeksi i ndjeshmërisë paraqitet më i lartë për bankën 9, e cila pëson një goditje mesatare në shtesën e kapitalit të saj prej rreth 30%.

Duke u fokusuar tek ekspozimet ndërbankare, rezulton që aktualisht ato vlerësohen të jenë të vogla në krahasim me nivelet e kapitalizimit të bankave. Për secilën nga bankat, ekspozimi i përgjithshëm bruto ndaj pjesës tjetër të bankave, është më i vogël se kapitali rregullator që ka. Për këtë arsye, asnjë dështim i vetëm i një banke vendase nuk do të shkaktonte dështimin e një banke tjetër dhe si pasojë, asnjë "efekt kaskadë" nuk do të ndodhte në këtë kampion përfaqësues.

4.1.3.2 Ushtrimi i provës së rezistencës së likuiditetit

Prova e rezistencës së likuiditetit ka për qëllim të vlerësojë aftësinë e bankave individuale dhe të sektorit bankar në përgjithësi për t'iu bërë ballë goditjeve ekstreme, por të mundshme, në financimin e veprimtarisë së tyre. Këto prova synojnë të evidentojnë dobësi apo mangësi të sektorit dhe bankave të veçanta në monedha, instrumente dhe horizonte të caktuara kohore; të vlerësojnë gatishmërinë e bankave për të përballuar skenarë ekstremë të mungesës së likuiditetit; si edhe të ndihmojnë autoritetin mbikëqyrës për ndërmarrjen e politikave të posaçme që adresojnë menaxhimin e likuiditetit, duke përfshirë masat që synojnë uljen e ekspozimeve ose krijimin e rezervave specifike.

Rezultatet e ushtrimit të provës së likuditetit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit vlerësohet e fortë dhe më e mirë në krahasim me një vit më parë.

Prova e rezistencës së likuiditetit realizohet sipas përqasjes "nga lart – poshtë" me të dhëna të raportuara nga bankat një herë në vit në fund të vitit. Ushtrimi përdor të dhëna mbi flukset e parashikuara hyrëse dhe dalëse të parasë sipas instrumenteve kryesore dhe për një horizont kohor të përbërë nga 8 shporta maturimi që mbulojnë intervalin nga "deri në 1 ditë" deri në "mbi 1 dhe deri në 2 vjet". Prova kryhet për monedhat Lek, Euro dhe USD dhe mbështetet në kushtin që tepricat e likuiditetit në një monedhë nuk mund të përdoren për të plotësuar mungesën e likuiditetit në monedhat e tjera, për shkak të probabilitetit të zhvlerësimit të shpejtë të kursit të këmbimit gjatë krizave të likuiditetit. Në situata reale, ky nuk është një element kufizues.

Për llogaritjen e hendekut të likuiditetit përdoren koeficientë të përcaktuar për tërheqjet e burimeve të financimit (të depozitave) dhe për riinvestimin e aktiveve (kredive) sipas të gjitha shportave të maturimit. Për burimet e financimit, koeficienti tregon vetëm atë pjesë të shumës së detyrimeve që maturohet në shportën përkatëse, e cila do të tërhiqet dhe nuk do të riinvestohet nga klienti. Për hyrjet e parasë, koeficientët e riinvestimit nënkuptojnë atë pjesë të shumës së të drejtave që maturohen në shportën përkatëse, e cila do të konvertohet në fluks hyrës parash dhe nuk do të riinvestohet nga banka.

Një bankë konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara, që shiten me marzhe reduktuese të përcaktuara nga ushtrimi, bien deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

REZULTATET

Rezultatet e ushtrimit tregojnë se rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme të likuiditetit sipas të dhënave të muajit nëntor 2019, për horizontin kohor deri në 2 vjet, vlerësohet e fortë dhe paraqitet më e mirë në krahasim me një vit më parë.

Në përmirësimin e rezistencës së sektorit bankar ka ndikuar rritja e konsiderueshme (me rreth 20%) e aktiveve likuide të zgjeruara (kapacitete kundërpeshuese),

ndërkohë që hyrjet dhe daljet e pritura të parasë për të tri monedhat dhe diferenca midis tyre kanë mbetur pothuajse të pandryshuara në krahasim me një vit më parë. Diferenca midis hyrjeve dhe daljeve vijon të mbetet negative, dhe vlerat më të larta negative regjistrohen në shportat 'deri në 1 ditë', '1 deri në 2 muaj' dhe '6 deri në 12 muaj', ndërkohë që për shportën '1-2 vjet' hyrjet e pritura kanë vlerë më të madhe sesa daljet.

Rezistenca e sektorit bankar ndaj goditjeve të likuiditetit varion sipas monedhës. Aftësia e sektorit bankar për të përballuar goditje të likuiditetit vlerësohet si 'shumë e mirë' për monedhat Lek dhe USD dhe 'e mirë' për monedhën Euro. Diferenca e thjeshtë midis hyrjeve dhe daljeve në monedhën Lek është përgjithësisht më e lartë në krahasim me atë në Euro, por aktivet likuide të zgjeruara të bankave në Lek janë rreth 2 herë më të larta në krahasim me ato në Euro. Për aktivitetin në USD që zë vetëm më pak se 10% të hyrjeve dhe daljeve të përgjithshme të parasë, diferenca midis hyrjeve dhe daljeve është pozitive dhe rezistenca e të gjitha bankave është mjaft e mirë.

Numri i bankave që vijojnë të regjistrojnë hendek negativ likuiditeti në krahasim me një vit më parë nuk ka ndryshuar për monedhat Lek dhe USD, dhe ka rënë lehtë për monedhën Euro, ndërkohë që vlera maksimale e hendekut të likuiditetit në raport me aktivet e sektorit bankar lëviz nga 0% (Lek dhe USD) në 3% (Euro). Por përdorimi i aktiveve likuide të zgjeruara ndihmon në mbylljen e hendekut të likuiditetit.

Në krahasim me një vit më parë, forcimi i rezistencës në monedhën Lek lidhet me rritjen e vëllimit të aktiveve likuide të zgjeruara, që mund të likuidohen për të plotësuar hendekun (si kapacitete kundërpeshuese). Nga ana tjetër, përmirësimi në monedhën Euro lidhet jo vetëm me rritjen e kapaciteteve kundërpeshuese, por edhe me përmirësimin e pritur në hyrjet dhe daljet e parasë që pasqyrojnë kryesisht hyrjet nga kreditë dhe daljet nga depozitat.

4.2 SEKTORI JOBANKAR

4.2.3 ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN JOBANKAR

4.2.3.2 Institucione të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë

IFJB-të kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre në vijim të rritjes së ndërmjetësimit në aktivitetin kreditues. Rezultati financiar pozitiv ka ardhur në rritje dhe ka ndikuar në nivelin e kënaqshëm të kapitalizimit të veprimtarisë.

Gjithsesi, cilësia e portofolit duhet monitoruar në kushtet kur kreditë me probleme regjistrojnë vlera më të larta se niveli i sektorit bankar.

Gjatë periudhës, institucionet financiare jobanka (IFJB) kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre në sajë të ecurisë pozitive të aktivitetit kreditues dhe investimeve në formën e llogarive rrjedhëse në banka. Në fund të vitit 2019, sistemi financiar përmbante 32 IFJB me një total aktivesh prej 65 miliardë lekësh. Bilanci i tyre ishte 9% dhe 23% më i lartë krahasuar me qershorin 2019 dhe me fundin e një viti më parë. Kapitali vendas mbizotëron me 80% totalin e kapitalit aksioner të IFJB-ve, ku peshën kryesore e zënë IFJB-të që kryejnë aktivitet kreditues, ndjekur nga ato që kryejnë pagesa dhe transferta. IFJB-të janë më aktive në financimin

me hua të aktiviteteve të shërbimit (rreth 30%) dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë (16%). IFJB-të e mbyllën vitin 2019 me një rezultat financiar pozitiv (rreth 3 miliardë lekë) dhe më të lartë krahasuar me një vit më parë. Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet në nivele të kënaqshme. Cilësia e portofolit të kredisë shënoi një rënie të lehtë, pasi raporti i kredive me probleme në fund të vitit arriti në 10% nga 9% dhe 9.5% një gjashtëmujor dhe një vit më parë.

Grafik 107. Struktura e IFJB-ve sipas llojit të aktivitetit që kryejnë, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 108. Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Veprimtaria e shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) shënoi zgjerim në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, mbështetur nga rritja e kredisë neto (veprimet me anëtarët) dhe rritja e investimeve në formën e llogarive rrjedhëse pranë sektorit bankar. Rezultati financiar i SHKK-ve ishte pozitiv dhe shënoi përmirësim në krahasim me një vit më parë, kur ky segment i sistemit financiar nuk raportoi fitim. Kreditë neto për anëtarët dhe investimet në banka përfaqësojnë zërat kryesorë të aktiveve të këtyre institucioneve. Sektori me financimin më të madh nga veprimet me anëtarët është sektori i bujqësisë, i ndjekur nga aktivitetet e shërbimit. Cilësia e portofolit të kredisë shënoi përmirësim të mëtejshëm dhe raporti i kredive me probleme në fund të vitit u ul në 4.7% nga rreth 5.0% që shënonte përkatësisht një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Në fund të vitit 2019, në Shqipëri tregu numëronte 14 shoqëri kursim-krediti dhe 1 union.

Aktiviteti i SHKK-ve rezultoi pozitiv në terma të kreditimit dhe të rezultatit financiar të periudhës. Përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë ka vijuar, duke u reflektuar në vlera më të ulëta të kredive me probleme.

Grafik 109. Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik. 110 Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, dhjetor 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2.3.3 Institucione të mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Aktiviteti i institucioneve të mbikëqyrura nga AMF reflekton ecuri më të luhatshme. Përkundër zgjerimit në terma të aktiveve dhe të numrit të subjekteve të licencuara në shoqëritë e sigurimit dhe të fondeve të pensioneve private suplementare, vërehet një tkurrje e aktivitetit në fondet e investimit.

Aktiviteti i shoqërive të sigurimit ka shënuar rritje gjatë periudhës, mbështetur nga rritja e provigjioneve teknike, aksioneve dhe depozitave me afat në banka. Në tregun vendas operojnë 12 shoqëri sigurimi të licencuara që kryejnë aktivitet të sigurimit të jetës (4 shoqëri) dhe jojetës (8 shoqëri). Aktivet e këtyre institucioneve[48] shënuan rritje vjetore prej 4% dhe arritën në 34 miliardë lekë. Investimet në banka vijojnë të zënë peshën kryesore (rreth 32%) në bilancin e shoqërive të sigurimit. Primet e shkruara bruto[49] u zgjeruan me rreth 4% në terma vjetorë, me kontribut kryesor nga primet e jojetës (92%), që përfaqësojnë dhe burimin kryesor të financimit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit.

Aktiviteti i fondeve të investimit[50] u tkurr gjatë periudhës si rezultat i pakësimit të investimeve në letrat me vlerë të qeverisë në formën e bonove të thesarit dhe depozitave në banka. Vlera neto e aktiveve u ul në 67 miliardë lekë nga 69 miliardë lekë në fund të muajit qershor 2019. Në sistemin financiar shqiptar numërohen 5 fonde investimi aktive dhe një fond i ri i licencuar në tetor 2019, që pritet të raportojë aktivitetin e tij në fushën e investimeve kolektive. Tregu i fondeve të investimit është një treg me përqendrim relativisht të lartë, ku dy nga fondet e investimit zotërojnë rreth 80% të totalit të aktiveve neto të fondeve. Aktivet e fondeve të investimit investohen kryesisht në obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të cilat ofrojnë kthim më të lartë, në krahasim me investimet alternative.

[48] *Bilanci i shoqërive të sigurimit i përket T3-2019.*
[49] *AMF, Buletini Statistikor, Viti 2019. Publikuar në 28 janar 2020.*
[50] *AMF, "Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive", 31 dhjetor 2019, publikuar më 24 janar 2020.*

Grafik 111. Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 112. Pesha në treg e fondeve të investimeve sipas vlerës neto të aktiveve, dhjetor 2019



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Fondet e Pensioneve Private Suplementare[51] kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre gjatë periudhës. Në sistemin financiar shqiptar numërohen 3 fonde pensioni aktive dhe një fond i ri i licencuar në tetor 2019, që pritet të raportojë aktivitetin e tij në fushën e pensioneve private vullnetare. Aktivet e këtyre fondeve në fund të vitit 2019 arritën në rreth 3 miliardë lekë, ose 13.5% më shumë se niveli i aktiveve në fund të gjashtëmujorit paraardhës. Aktiviteti i fondeve të pensionit mbizotërohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë.

Aktiviteti i Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE) gjatë periudhës ka konsistuar në transaksionet me titujt e borxhit të qeverisë. Bursa numëron 4 anëtarë, që janë banka dhe një shoqëri komisionere. Sipas të dhënave statistikore të bursës, gjatë vitit 2019[52], vlera e obligacioneve të tregtuara ishte rreth 2 miliardë lekë dhe e bonove të thesarit rreth 0.3 miliardë lekë. Në instrumentet e tregtuara në bursë si në numër dhe vlerë mbizotërojnë transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

4.2.4 NDËRLIDHJA E SISTEMIT FINANCIAR

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar në vend është i kufizuar dhe nuk ka shënuar ndryshime gjatë vitit të fundit. Në krahun e aktivit të bankave, ky ekspozim përfaqësohet kryesisht nga huatë akorduar institucioneve financiare jobankare, të cilat përfaqësojnë vetëm 1% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Në krahun e detyrimeve të bankave, ekspozimi është në formën e fondeve të mbledhura prej bankave (llogarive të ndryshme, depozita me apo pa afat), dhe zë rreth 2% të vlerës së aktiveve të sektorit bankar. Ky raport ka shënuar një rritje të lehtë gjatë viteve të fundit, por konsiderohet si shumë i ulët në krahasim

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar në vend mbetet i kufizuar dhe pa ndryshime gjatë vitit. Ndërsa, ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe në rritje gjatë periudhës.

[51] *AMF, Raporti Statistikor "Tregu i Pensioneve Private Vullnetare", 31 dhjetor 2019, publikuar më 26 shkurt 2020.*

[52] *AMF, Periodiku mujor nr.130, dhjetor 2019.*

me nivelet kufi të aplikuara nga Banka e Shqipërisë për të monitoruar rrezikun e ekspozimit dhe përqendrimit të aktivitetit midis segmenteve të ndryshme të sistemit financiar.

Grafik 113. Investimet e sektorit jobankar në banka dhe letrat me vlerë të qeverisë në raport me totalin e aktiveve të sektorit jobankar, pesha në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 114. Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në sektorin bankar ndaj totalit të aktiveve të tyre (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe ekspozimi ka ardhur duke u rritur gjatë periudhës. Në total, ky ekspozim në fund të tremujorit të tretë ishte sa 21% e aktiveve të sektorit financiar jobankar, nga 19% në fund të vitit 2018. Shoqëritë e sigurimit dhe institucionet financiare jobanka (IFJB) kanë ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar, pasi vendosjet e tyre në formën e depozitave dhe instrumenteve të kapitalit në banka përbëjnë përkatësisht 33% dhe 22% të aktiveve përkatëse. Për shoqëritë e kursim-kreditit është vërejtur një rritje e ekspozimit dhe njëkohësisht ndjeshmërisë ndaj zhvillimeve në sektorin bankar, duke qenë se këto subjekte kanë rritur depozitat në sektorin bankar. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë në kuadrin e vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike dhe monitorimit të përmbushjes së objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.

5. POLITIKAT MAKROPRUDENCIALE DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE

5.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË VENDET E BE-SË DHE RAJON[53]

Analiza në vijim paraqet rreziqet kryesore të identifikuara në raportet e stabilitetit financiar dhe instrumentet e politikave makroprudenciale të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe në Rajon. Për këtë qëllim, janë analizuar një sërë raportesh të vlerësimit të rreziqeve, të përgatitura nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), Bordi Evropian për Rrezikun Sistemik (ESRB), Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Organizata Ndërkombëtare e Komisionit të Letrave me Vlerë (IOSCO), etj. Raportet e shqyrtuara datojnë nga viti 2018 deri në gjysmën e parë të vitit 2019. Përvoja e tyre shërben në pasurimin dhe zbatimin e politikave e instrumenteve përkatëse në Bankën e Shqipërisë.

5.1.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Gjatë periudhës vërehet se rreziqet kryesore nuk shfaqin ndryshime thelbësore kundrejt vitit të kaluar. Gjithsesi, evidentohet se rreziku që buron nga veprimtaria e sektorit financiar jobankar (*shadow banking*) ka ardhur në rritje, ndaj dhe Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka rekomanduar ndërmarrjen e masave të posaçme për monitorimin e këtij rreziku. Rreziqet e identifikuara janë të ndërlidhura mes tyre dhe përshkallëzimi i rritjes së njërit prej tyre do të shkaktonte "reaksion zinxhir" edhe në pjesën tjetër.

Nga ky këndvështrim, rreziqet kryesore të identifikuara nga vendet e BE-së, janë si në vijim:

I. rritje e papritur dhe jo homogjene e primit të rrezikut, e ndikuar nga reagimi i tregjeve ndaj pasigurive politike në vendet e BE-së;
II. shqetësim për qëndrueshmërinë e nivelit të borxhit, nxitur nga zgjerimi i aktivitetit ekonomik në vendet e BE-së;
III. zvogëlim i kapaciteteve ndërmjetësuese të sektorit bankar, si rezultat i niveleve të ulëta në përfitueshmërinë nga aktiviteti, çka përbën një rrezik të shtuar për stabilitetin financiar të Eurozonës;
IV. rritje e ndërmarrjes së rrezikut nga sektori financiar jobankar, shoqëruar me rritje të rreziqeve në terma të likuiditetit dhe të kreditit në portofolin e tyre të investimeve.

[53] *Për qëllime të kësaj analize, në vendet e Rajonit janë përfshirë edhe Italia e Greqia, në kuadër të ekspozimeve të sektorit bankar shqiptar ndaj tyre.*

Për sa i përket masave makroprudenciale të ndërmarra nga vendet anëtare të BE-së, vërehet një rritje e konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të tyre në harkun kohor njëvjeçar. Shumica e masave të ndërmarra janë të një natyre shtrënguese dhe kryesisht adresojnë rreziqet ciklike. Instrumentet makroprudenciale të përdorura më shpesh janë kryesisht instrumentet me bazë kapitalin, në përmbushje të kërkesave rregullatore të Direktivës Evropiane për Kërkesat e Kapitalit (2013/36/EU – CRD IV). Masa tjetër më e zbatuar ka të bëjë me vendosjen e niveleve tavan për raportin "shërbimi i borxhit/të ardhura" (*debt service–to-income, DSTI*), me qëllim kryesisht kufizimin e huamarrjes tek individët/familjet. Një paraqitje e përmbledhur e këtyre masave paraqitet në vijim.

Grafik 115. Masat kryesore të ndërmarra në vendet e BE-së, sipas llojit



Burimi: ESRB.

Lista e vendeve më aktive në zbatimin e instrumenteve makroprudenciale kryesohet nga vendet nordike dhe vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore si: Republika Çeke, Hungaria, Danimarka, Sllovakia, Finlanda dhe Suedia.

Grafik 116. Numri i masave të ndërmarra nga vendet anëtare të BE-së



Burimi: ESRB.

5.1.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË RAJON

Rreziqet e identifikuara nga vendet e Rajonit nuk paraqesin ndryshime përgjatë harkut kohor njëvjeçar. Vlen të theksohet fakti se rreziqet janë tejet të ngjashme me ato të identifikuara nga Banka e Shqipërisë, për shkak të ngjashmërisë së karakteristikave ekonomike mes vendeve. Disa prej rreziqeve kryesore të identifikuara janë:

I. rreziku ndaj kursit të këmbimit;
II. niveli i ulët i fitimeve në sistemin financiar shoqëruar me nivele relativisht të larta të kredive me probleme;
III. nivele të larta të borxhit publik, edhe pse në rënie të lehtë kohët e fundit;
IV. niveli i lartë i përqendrimit të ekspozimeve në disa sektorë të ekonomisë, duke ndikuar në këtë mënyrë nivelin aktual të kredive me probleme.

Ndër vendet e Rajonit që nuk janë pjesë e BE-së, vërehet se Serbia dhe Maqedonia e Veriut janë më aktive në lidhje me aktivizimin e kërkesave për kapital shtesë për qëllime makroprudenciale. Në këto vende, instrumentet e përdorura më shpesh lidhen me administrimin e rreziqeve sistemike të natyrës strukturore.

Grafik 117. Instrumentet makroprudenciale me bazë kapitalin sipas vendeve të rajonit



Burimi: Faqet zyrtare të bankave qendrore të vendeve të shqyrtuara.

5.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË SHQIPËRI

5.2.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE NË SHQIPËRI

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritete të tjera, kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar. Si pjesë e këtij kontributi, Banka e Shqipërisë harton dhe

zbaton politikën makroprudenciale, e cila analizon e vlerëson rrezikun sistemik dhe zbaton masat për parandalimin e zbutjen e tij, në dy drejtime:

I. parandalon akumulimin e rreziqeve në sistemin financiar, dhe
II. forcon rezistencën e sistemit financiar.

Nga pikëpamja e parandalimit të akumulimit të rreziqeve, Banka e Shqipërisë harton analiza që synojnë identifikimin e zhbalancave financiare bazuar në monitorimin e ngushtë të performancës së treguesve që reflektojnë akumulimin e rreziqeve, me fokus kryesor në sektorin bankar. Banka e Shqipërisë ka identifikuar tashmë një grup të plotë treguesish makroprudencialë[54] në përputhje të plotë me rekomandimet e Bordit Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB), të cilët grupohen në katër objektiva[55], sipas Tabelës 12.

Tabela 12. Objektivat e ndërmjetëm dhe disa prej treguesve kryesorë

Objektivi i ndërmjetëm	Treguesit
• Zbutja dhe parandalimi i rritjes së shpejtë të kreditimit dhe të borxhmarrjes	• Rritja vjetore e vëllimit të kredisë; • Nivelet e ngarkesës me borxh të sektorit privat; • Raporti "kredi ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto" dhe gap-i; • Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme; • Treguesit LTV, DTI, financimi me borxh i bankave.
• Zbutja dhe parandalimi i mospërputhjeve të tepërta në maturime dhe i mungesës së likuiditetit në treg	• Raporti "kredi ndaj depozitave"; • Struktura e detyrimeve dhe shpërndarja e maturiteteve; • Mbështetja në financimin në treg dhe në bankën qendrore; • Struktura e aktiveve likuide dhe pesha në totalin e aktiveve; • Raporti i mbulimit të likuiditetit; • Raporti i financimit të qëndrueshëm neto; • Ushtrimi i provës së rezistencës për rrezikun e likuiditetit.
• Kufizimi i përqendrimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekspozimeve	Përqendrimi i ekspozimeve sipas sektorëve, subjekteve, vendeve, monedhave dhe maturiteteve
• Kufizimi i sipërmarrjes së tepërt të rrezikut nga institucionet financiare me rëndësi sistemike	• Raporti i aktiveve të bankave ndaj PBB-së; • Vëllimi i depozitave dhe aktiveve; • Pretendime dhe detyrime ndaj institucioneve të tjera financiare; • Tregues të tjerë që shfaqin madhësinë, ndërlidhjen, zëvendësueshmërinë, kompleksitetin dhe aktivitetin ndërkufitar të bankave.

Burimi: Strategjia e Politikës Makroprudenciale, Banka e Shqipërisë.

Nga analiza e treguesve të mësipërm vërehet se në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019, sektori bankar ka vijuar të ruajë një nivel të mirë kapitalizimi dhe likuiditeti, të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat afatshkurtra. Ndër çështjet kryesore që kërkojnë vëmendje vazhdon të jetë nxitja e kredidhënies për bizneset, zgjerimi i hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve sipas maturitetit të mbetur, si dhe reduktimi i përdorimit të monedhës së huaj në ekonominë vendase. Një vështrim më i detajuar sipas secilit objektiv, jepet në vijim:

[54] *Për secilin objektiv janë përzgjedhur treguesit që sinjalizojnë më mirë rrezikun sistemik rreth të cilit është ndërtuar objektivi. Monitorimi i sinjaleve të rrezikut që kap secili prej tyre bëhet duke krahasuar vlerën aktuale dhe ecurinë në kohë të treguesit ndaj një vlere kritike, tejkalimi i të cilës mund të sinjalizojë akumulim të rrezikut.*

[55] *Për më shumë, lutem konsultoni dokumentin 'Strategjia e Politikës Makroprudenciale", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.37, datë 2.8.2017: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Strategjia_makroprudenciale/*

Objektivi I. Ngushtimi i hendekut negativ të kredisë për ekonominë ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB) sinjalizon një përmirësim të kreditimit në vend, ndikuar më së shumti nga portofoli i kredisë për biznesin. Gjithashtu, raporti i levës financiare pasqyron një përmirësim përgjatë vitit, çka konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë kapitalizimi të sektorit bankar.

Objektivi II. Aktivet likuide kanë vijuar të jenë në nivele të larta, duke u rritur më tej në nivelin 36% të totalit të aktiveve, ose 1 pp më shumë se në fund të gjashtëmujorit të kaluar. Nga ana tjetër, vërehet një zgjerim i mëtejshëm i hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve për maturitetet afatshkurtra. Gjithashtu, spread-i i kursit të këmbimit për monedhën euro në tregun ndërbankar ka vijuar prirjen rritëse edhe gjatë këtij gjashtëmujori.

Objektivi III. Ekspozimet e bankave sipas sektorëve të ekonomisë kanë njohur rënie këtë gjashtëmujor[56], ndërsa kreditë për prona të paluajtshme regjistruan rritje. Nga ana tjetër, kreditë e pambrojtura në valutë e ekspozojnë sektorin bankar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, veçanërisht ndaj monedhës së përbashkët evropiane. Analiza sipas aktivitetit ekonomik, evidenton përqendrimin e kredisë kryesisht në sektorin e tregtisë, atë të ndërtimit dhe në industrinë përpunuese, duke e ekspozuar sektorin ndaj goditjeve të mundshme në këta sektorë. Përdorimi i valutës mbetet i lartë, duke u shoqëruar me efekte negative mbi kanalet e transmetimit të politikës monetare dhe mbi administrimin e likuiditetit në valutë. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash konkrete për të stimuluar përdorimin e monedhës vendase, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017.

Objektivi IV. Totali i aktiveve të sektorit bankar në terma të PBB-së arriti në nivelin rreth 96%. Referuar indeksit Herfindal për nivelin e përqendrimit të rëndësisë sistemike, në fund të muajit dhjetor 2019 vërehet një rënie e përqendrimit. Njëkohësisht, detyrimet jorezidente kanë shënuar rënie të konsiderueshme krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe një vit më parë, ndikuar kryesisht nga efekti i thyerjes në të dhënat statistikore, në vijim të ndryshimeve strukturore në sektorin bankar gjatë vitit 2019.

5.2.2 MASAT MAKROPRUDENCIALE NË SHQIPËRI

Nga pikëpamja e forcimit të rezistencës së sektorit bankar, Banka e Shqipërisë ka hartuar kuadrin rregullativ përkatës dhe është duke kalibruar instrumentet e nevojshme makroprudenciale për këtë qëllim.

Miratimi i rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit"[57], mundësoi operacionalizimin dhe zbatimin e shtesave të kapitalit si instrumente të politikës

[56] *Për monitorimin e përqendrimit të ekspozimeve në nivel sistemi është përdorur metoda e indeksit Herfindahl.*

[57] *Vendimi nr. 41, datë 5.6.2019 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Nr_41_2019_14799_7_14903.pdf*

makroprudenciale. Zbatimi i tyre synon forcimin e rezistencës së sektorit bankar në vend ndaj rreziqeve sistemike me natyrë ciklike dhe strukturore. Në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë ka publikuar me një periodicitet tremujor, duke filluar nga T2-2019, disa vendime të Guvernatorit[58], të cilat shpallin kërkesën për shtesën konservuese të kapitalit, për shtesën kundërciklike të kapitalit, si edhe listën e bankave me rëndësi sistemike dhe shtesat e kërkuara të kapitalit për secilën prej tyre. Për herë të parë, bankat do të raportojnë përmbushjen e kërkesave të mësipërme duke filluar nga fundi i T1-2020, por niveli i përmbushjes pritet të jetë i plotë në kushtet e niveleve të mira të kapitalizimit të veprimtarisë nga bankat. Në kuadër të ndikimit të pandemisë, do të vlerësohet në vijim mundësia e përdorimit në mënyrë kundërciklike e këtyre masave. Vendosja e shtesave makroprudenciale të kapitalit përfaqëson një arritje të rëndësishme në drejtim të përafrimit me standardin përkatës të Bashkimit Evropian të përcaktuar në legjislacionin e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës dhe me standardet përkatëse teknike të publikuara nga Autoriteti Bankar Evropian dhe Bordi Evropian i Rrezikut Sistemik.

Paralelisht, një vëmendje e shtuar i është kushtuar analizës për konceptimin e instrumenteve që parandalojnë rritjen e tepërt të kredisë dhe të borxhmarrjes, kryesisht nga sektori i individëve. Me rëndësi në këtë drejtim është analiza e zhvillimeve në kredinë për pasuri të paluajtshme dhe për konsum. Për këtë të fundit, në vijim jepet një analizë më e detajuar.

I. ZHVILLIMET NË KREDINË KONSUMATORE DHE RREZIQET PËR STABILITETIN FINANCIAR

Vitet e fundit, kredia konsumatore është rritur me një ritëm të shpejtë në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore, duke shënuar nivele të përafërta të rritjes me periudhën para krizës financiare të vitit 2008[59]. Një pjesë e vendeve kanë adresuar rrezikun e një rritjeje të tepërt të krediititit për këtë segment duke ndërmarrë masa të natyrës makroprudenciale. Këto masa synojnë kryesisht të kufizojnë peshën e shërbimit të kredisë ndaj të ardhurave të huamarrësve, p.sh., duke vendosur një nivel të sipërm (tavan) në raportin "vlerë e huasë/të ardhura" apo në raportin "shërbimi i borxhit/të ardhura", por mund të përfshijnë dhe kufizime të tjera, si: kufizime në kohëzgjatjen e kontratës së kredisë, në mënyrën e ripagimit të saj etj. Në këtë mënyrë, synohet të forcohet rezistenca e huamarrësve (duke ulur probabilitetin e dështimit) dhe të bankave (duke ulur madhësinë e humbjes në rast dështimi) përmes kufizimit të barrës së shërbimit të kredisë dhe rritjes së papërballueshme të borxhit.

Në Shqipëri, kredia konsumatore ka njohur një rritje të shpejtë në vitet 2005-2009, e lidhur kjo edhe me rritjen e shkallës së ndërmjetësimit financiar në vend që nisi nga një bazë relativisht e ulët. Menjëherë pas materializimit të

[58] *Mund të gjenden në lidhjen: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/*

[59] *Për më shumë detaje, konsultoni Buletinin Ekonomik të Bankës Qendrore Evropiane, nr. 7/2017 "Tendencat e fundit në kredinë konsumatore në vendet e Eurozonës."*

rreziqeve, që përkon edhe me krizën financiare, kredia konsumatore u tkurr duke ndjekur prirjen e përgjithshme të kreditimit në Shqipëri. Periudha kur rritja e kredisë konsumatore filloi të intensifikohet, përkon me fundin e vitit 2014 deri në gjysmën e parë të vitit 2018, periudhë në të cilën ajo dha kontributin kryesor në rritjen e kredisë për individë. Ndërsa, ritmi i rritjes së kredisë konsumatore u ngadalësua gjatë vitit 2019[60].

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj këtij segmenti është i ulët krahasuar me totalin e kredive dhënë sektorit privat: kreditë konsumatore përbëjnë 11.5% të kredisë dhënë sektorit jofinanciar privat dhe vetëm 4.2% të aktiveve në bilancin e bankave të sektorit. Po ashtu, pesha e kredive konsumatore ndaj totalit të kredisë dhënë individëve nuk ka njohur ndryshime të rëndësishme në ecuri, duke u luhatur në vlerat 23%-37%, dhe kjo peshë ka ardhur në rënie gjatë vitit të fundit duke shënuar 34% në fund të dhjetorit 2019.

Kontribut pozitiv në ecurinë e kredisë konsumatore ka dhënë edhe pjesa jobankare e sistemit financiar. Në këtë pjesë të sektorit, rritja e kredisë konsumatore ka qenë dyshifrore. Pavarësisht kësaj, teprica e kredisë konsumatore dhënë nga kjo pjesë e sistemit financiar në total përbën rreth 10% të kredisë konsumatore të dhënë nga sektori bankar.

Kreditë konsumatore janë tipikisht prociklike, pasi mbështesin konsumin. Ky prociklikalitet është evident për të dhënat e Shqipërisë, nëse do të shohim ecurinë e raportit të kredisë së re konsumatore ndaj konsumit të individëve. Në kushtet e rritjes ekonomike pozitive, kreditë e reja për konsum janë rritur më shumë se konsumi final i popullatës, dukuri kjo e shprehur më së shumti midis viteve 2014-2017. Gjatë kësaj periudhe, treguesi është rritur me përafërsisht 1 pikë përqindje.

Grafik 118. Disa tregues të kredisë konsumatore[61]



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Referuar vrojtimit të aktivitetit kreditues[62], rritja e kërkesës për kredinë konsumatore, ka qenë një faktor i rëndësishëm në rritjen e kredisë (vija e ndërprerë e verdhë në Grafikun 118). Nga ana tjetër, edhe bankat kanë lehtësuar standardet e kredidhënies për këtë segment, siç tregohet nga vlerat pozitive të indeksit të standardeve të kredidhënies për kredinë për konsum.

[60] *Ritmi vjetor i rritjes së kësaj kredie arriti në nivelin prej 6.9%.*

[61] *a) Treguesi i fluksit të kredisë konsumatore ndaj konsumit (boshti majtas); indeksi i kërkesës për kredi konsumatore dhe i standardeve të kredidhënies për kredinë konsumatore (boshti djathtas); b) Në boshtin djathtas të grafikut, vlera negative tregon që bankat kanë shtrënguar standardet e kredidhënies dhe anasjelltas. Po ashtu, vlera pozitive tregon rritje të kërkesës për kredi, ndërsa balanca negative tregon uljen e saj.*

[62] *Për më shumë detaje, konsultoni "Vrojtimin për aktivitetin kreditues", në lidhjen: https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/.*

Grafik 119. Kontributi i komponentëve në rritjen e kredisë konsumatore për rezidentët, sipas qëllimit të përdorimit (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Komponenti kryesor që ka kontribuar në luhatjet ciklike të kredisë konsumatore është kredia për konsumin e mallrave të qëndrueshme[63], një dukuri e hasur gjerësisht edhe në vende të tjera. Për Shqipërinë, ky kontribut është evident jo vetëm në tkurrjen e vitit 2009, por edhe në intensifikimin e rritjes së kredisë për konsum në vitet 2014-2017.

Në terma të kostos, vitet e fundit bankat kanë operuar në një mjedis me norma interesi historikisht më të ulëta. Por normat e interesit për kredinë konsumatore kanë qenë mesatarisht 1.4 pp më të larta gjatë vitit të fundit. Struktura e ndryshimit të normës së interesit në kredinë konsumatore, jepet në Grafikun 120, ku vërehet që pjesa mbizotëruese e kontratave të reja të kredive konsumatore (rreth 80%) kanë një normë interesi të pandryshuar.

Grafik 120. Norma mesatare e interesit për kredinë e re dhënë individëve (majtas) dhe struktura e periudhave të fiksimit fillestar të normës së interesit për kreditë e reja për konsum (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas përbërjes, kreditë për konsumin e mallrave jo të qëndrueshme[64] përfaqësojnë peshën më të madhe në kredinë konsumatore me 54% në fund të vitit 2019 dhe kjo peshë ka ardhur në rritje. Nga ana tjetër, kreditë "overdraft" zënë peshën më të vogël në stokun e kredisë konsumatore me 13% në fund të vitit 2019, dhe kjo peshë është tkurrur në ecuri. Duke qenë se kreditë konsumatore karakterizohen nga një principal më i vogël dhe maturime më të shkurtra se kreditë për blerje banesash, përbërja e tepricës së tyre në bilancin e bankave mund të ndryshojë më shpejt.

63 *Për shembull: makina, pajisje shtëpiake, pajisje elektronike etj.*

64 *Mallra që konsumohen tërësisht brenda një viti duke supozuar një përdorim fizik normal të tyre, si p.sh., produktet ushqimore, kancelaritë e zyrave, tekstile për veshje, pjesa më e madhe e shërbimeve duke përfshirë pushimet etj.*

Grafik 121. Përbërja e kredisë konsumatore sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe pesha e komponentëve në tre momente kohore*, (djathtas)



*Përkatësisht, T4-2009 që përkon me krizën financiare, 3 vite më parë dhe tremujori i fundit i vitit 2019.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhës, kreditë konsumatore në lekë mbizotërojnë në portofolin e bankave të sektorit. Në fund të vitit 2019, kredia konsumatore në valutë përbën 13.7% të kredisë konsumatore. Më shumë se gjysma e kredive konsumatore në valutë (rreth 58%) është e klasifikuar si e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, megjithatë këto të fundit zënë vetëm 8% të stokut të kredisë konsumatore. Rreziku që vjen prej luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, nga këndvështrimi i aftësisë paguese të huamarrësit, mbetet i kufizuar. Sipas cilësisë së kredisë, kredia konsumatore ka njohur historikisht nivele më të ulëta të kredive me probleme, pavarësisht natyrës së saj me rrezik më të lartë. Raporti i kredive konsumatore me probleme ka hyrë në një fazë rënëse që prej gjysmës së dytë të vitit 2013, duke shënuar vlerën më të ulët në fund të vitit 2019. Po ashtu, kontributi i kredive konsumatore në rritjen e stokut të kredive me probleme në total në bilancin e sektorit bankar ka qenë minimal.

Ashtu si në vendet e tjera të përmendura në krye të kësaj analize, edhe në Shqipëri ka pasur një prirje të zgjerimit të aktivitetit kreditues të të gjithë sistemit financiar drejt këtij segmenti, ku sektori bankar vijon të luajë rolin kryesor. Kërkesa për kredi, veçanërisht për konsumin e mallrave jo të qëndrueshme, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zgjerimin e kredisë konsumatore. Kreditë konsumatore kanë natyrë prociklike, me afate maturimi më të shpejta e norma interesi më të larta dhe në kushtet e përkeqësimit të situatës në tregun e punës ose në ciklin e ekonomisë në përgjithësi, rreziqet sistemike që burojnë prej tyre mund të materializohen. Megjithatë, në rastin e Shqipërisë, rreziqet që vijnë nga zgjerimi i kredisë konsumatore zbuten nga pesha e saj e ulët. Edhe pse niveli aktual i rrezikut mbetet i ulët dhe i kontrolluar, veprimet e politikës makroprudenciale duhet të jenë me vështrim nga e ardhmja, duke synuar të mos lejojnë akumulimin e rreziqeve që mund të çojnë në një situatë stresi në sistemin financiar.

SHTOJCË. TREGUESIT KRYESORË TË SHËNDETIT FINANCIAR

Në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Treguesit me bazë kapitalin													
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	17.08	17.23	16.17	15.40	15.56	16.17	17.96	16.84	15.72	16.01	17.03	18.66	18.28
Kapitali nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.01	16.31	15.27	14.52	14.30	14.57	14.88	13.79	13.45	14.10	15.53	17.42	17.06
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.62	8.57	9.57	9.40	8.69	8.57	8.37	8.58	9.53	9.73	10.17	10.15	10.45
Cilësia e aktiveve													
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.05	21.74	28.24	35.95	52.01	55.62	40.22	38.25	24.28	23.08	15.72	15.51	13.64
Huatë me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.36	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.80	18.22	18.27	13.23	11.08	8.37
Përfitueshmëria													
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.74	11.35	4.58	7.58	0.76	3.78	6.43	10.53	13.16	7.15	15.71	12.96	13.45
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.57	0.91	0.42	0.72	0.07	0.33	0.54	0.89	1.20	0.69	1.54	1.32	1.39
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit													
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.69	4.30	3.89	5.03	3.94	3.98	4.08	8.49	7.66	7.03	6.68	7.78	7.43
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të parë	1.80	4.54	4.12	5.33	4.29	4.41	4.92	10.37	8.95	8.00	7.34	8.35	7.96
Treguesit me bazë aktivet													
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.77	42.83	27.65	25.95	26.53	29.37	27.64	31.94	32.26	31.29	30.22	34.23	35.68
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	73.96	64.86	32.58	30.62	33.15	36.71	34.71	40.36	41.43	40.57	40.79	46.21	49.40
Depozita të klientëve ndaj totalit të huave	215.45	162.60	154.32	166.39	163.20	171.62	180.83	180.16	187.78	192.84	194.00	203.25	207.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.